



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**ARSYET E KTHIMIT NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**TË LIGJIT NR. 118/2020**

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008,  
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

**PJESË PËRBËRËSE TË DEKRETIT NR. 11797, DATË 22.10.2020**

**Tabela e lëndës:**

	<i>Faqe</i>
<b>I.</b> Hyrje.....	<b>3</b>
<b>II.</b> Mbi kontekstin e zhvillimeve politike e shoqërore në vend .....	<b>6</b>
<b>III.</b> Mungesa e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese prej 32 muajsh .....	<b>15</b>
<b>IV.</b> Kuvendi ka humbur tërësisht rolin e tij kushtetues të kontrollit të Qeverisë. Veprimtaria antikushtetuese e Kuvendit në procesin ligjberës gjatë kësaj legjislatore .....	<b>19</b>
<b>V.</b> 15 Kushtet e vendosura nga Këshilli Europian .....	<b>23</b>
<b>VI.</b> Rifillim i dialogut politik dhe konstituimi i Këshillit Politik si instrument i besueshëm dhe i pranueshëm nga aktorët vendas dhe institucionet ndërkombëtare .....	<b>25</b>
<b>VII.</b> Veprimet e Kryeministrit për prishjen e marrëveshjes së 5 qershorit .....	<b>29</b>
<b>VIII.</b> Caktimi i datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë dhe rregullat zgjedhore të aplikueshme .....	<b>36</b>
<b>IX.</b> Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor shkelin Marrëveshjen Politike të arritur. Këshilli Politik dhe rëndësia e dakordësisë që mori emrin “Marrëveshja e 5 Qershorit për Reformën Zgjedhore” .....	<b>39</b>
<b>X.</b> Reagimet pas ndryshimeve të njëanshme të 5 tetorit 2020 në Kodin Zgjedhor .....	<b>44</b>
<b>XI.</b> Ndryshimet e njëanshme të 5 Tetorit 2020 në Kodin Zgjedhor bien ndesh me parimet dhe standardet ndërkombëtare të miratuara ndër vite nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias dhe nuk respektojnë kërkesat e plotësimit të kushteve të Bashkimit Europian dhe Buntestagut Gjerman .....	<b>47</b>
<b>XII.</b> Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të realizuara në 5 tetor 2020, përmes Ligjit nr. 118/2020, bien ndesh me Kushtetutën, cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe të procesit të rregullt ligjor, si dhe krijojnë diskriminim të theksuar në jetën politike.....	<b>54</b>
<b>1.</b> Ligji nr.118/2020, përkeqëson pozitën e partive të vogla dhe shkakton diskriminim. Ndryshimi i pragut elektoral dhe zbalancimi i konvertimit të votave në mandate përfaqësuese në Kuvend .....	<b>54</b>
<b>2.</b> Mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë .....	<b>60</b>
<b>3.</b> Pengimi i koalicioneve parazgjedhore, duke imponuar listën shumëmemërore të përbashkët dhe deformimi i votës .....	<b>64</b>
<b>4.</b> Ndryshimet e bëra përmes nenit 8 të ligjit nr. 118/2020, janë parashikime që favorizojnë deputetë aktualë ilegjitimë, për votën e tyre të dhënë në 5 tetor për forcimin e pozitës së mazhorancës aktuale, dhe krijojnë vështirësi të panevojshme për partitë e tjera politike .....	<b>70</b>
<b>5.</b> Trajtim i pabarabartë në mënyrën e deklarimit të trajtimit të dhurimeve, huave dhe kredive, si një pengesë më shumë për koalicionet parazgjedhore .....	<b>71</b>
<b>6.</b> Synimi për të ndikuar në pavarësinë dhe paanësinë e Kolegjit Zgjedhor, për kapjen politike të tij .....	<b>72</b>
<b>XIII.</b> Ndryshimet në Kodin Zgjedhor përmes Ligjit nr.118/2020, nuk realizojnë zhvillimin e një procesi zgjedhor përmes listave tërësisht të hapura siç u premtua .....	<b>76</b>
<b>XIV.</b> Konkluzine dhe përfundime .....	<b>78</b>

## I. Hyrje

Kuvendi i Shqipërisë në datën **5 tetor 2020**, ka miratuar ligjin nr.118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në datën 6 tetor 2020, përmes shkresës me nr. prot. 2539, datë 6.10.2020, Kuvendi i ka përcjellë zyrtarisht Presidentit të Republikës ligjin nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, për shpallje.

Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencave të parashikuara në nenin 85, pika 1, të Kushtetutës, shqyrtoi përmbajtjen e dispozitave të ligjit nr. 118/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, dhe në përfundim të këtij shqyrtimi konstaton se këto ndërhyrje të njëanshme në Kodin Zgjedhor:

- Janë në kundërshtim të hapur me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe parimet themelore demokratike të mbrojtura prej saj;
- Këto ndryshime të rregullave zgjedhore, cenojnë parimet demokratike ndërkombëtare të realizimit të një procesit zgjedhor përmes zgjedhjeve të lira e të ndershme;
- Ndryshimet në Kodin Zgjedhor janë realizuar në mënyrë të njëanshme, pa konsensus gjithëpërfshirës dhe bien ndesh me frymën kushteve të vendosura nga Këshilli European në datë 25 Mars 2020 dhe plotësimin e 15-kushteve përpara zhvillimit të konferencës së parë ndër-qeveritare;
- Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor dëmtojnë rëndë klimën e bashkëpunimit midis forcave politike në vend, duke zëruar praktikisht besimin reciprok midis tyre;
- Këto ndryshime të njëanshme në Kodin Zgjedhor janë në kundërshtim flagrant me parimet dhe standartet evropiane të vendosura nga **Komisioni i Venecias** në **Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore**, si udhërrëfyesi i vetëm për vendet e Këshillit të Europës për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, të lira e të ndershme;
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor krijojnë një pozitë të pabarabartë, diskriminuese, duke rëndë ndesh si me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
- Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor të datës 5 Tetor, për shkak të pozitave diskriminuese që ato përmbajnë krijojnë një terren shumë polarizues në vend. Kjo pozitë rëndohet edhe më shumë para faktit që në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, çdo kundërshtim i këtyre dispozitave lidhur me antikushtetutshmërinë e tyre nuk mund të marrë së shpejti një përgjigje përfundimtare;
- Ndryshimet e njëanshme cenojnë kushtet e vendosura nga Bashkimi European, çka do të përkthehet me një tjetër vendim negativ për Shqipërinë, duke cenuar drejtpërdrejt ecurinë e procesit të integritimit evropian të vendit;

- Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor cenojnë frymën dhe themelin e dakordësisë së arritur në vend përmes Marrëveshjeve të forcave politike të datës 14 Janar dhe 5 Qershor 2020, të cilat kishin si qëllim të garantonin një minimum standardesh për zgjedhjet në Shqipëri;
- Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor përpiqen të krijojnë një ambient elektoral rregullash që favorizojnë mazhorancën qeverisëse ku përmes rregullave *ambigue* e të fshehura, ato do të ndikojnë në leximin real, të qartë dhe objektiv të vullnetit të sovranit në këtë proces zgjedhor;
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor, krijojnë rrezik që procesi para-elektoral, ai i fushatës elektorale, i votimit, numërit, dhe ai ankimor deri në nxjerrjen e rezultatit zgjedhor, të zhvillohet nën një klimë të polarizuar politike, antagoniste, të mungesës së besimit ndërmjet palëve, që rrjedhimisht mund të sjellin si pasojë cenimin e standardeve zgjedhore, prishjen e paqes sociale dhe mundësinë e rritjes së tensionit në jetën shoqërore në vend;
- Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor të datës **5 tetor 2020**, janë realizuar ndërkohë që Presidenti i Republikës **që prej datës 6 shtator 2020 me Dekretin nr. 11700**, ka caktuar datën e zgjedhjeve për Kuvendin, ditë e dielë, **datë 25 prill 2021**, duke prishur kështu rregullat e një procesi zgjedhor që tashmë ka filluar, në shkelje të parimeve demokratike;
- Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor, cenojnë parimin kushtetues të sigurisë juridike dhe bien ndesh me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë;
- Ndryshimet e njëanshme në Kodin Zgjedhor të datës **5 tetor 2020, cenojnë parimin e procesit të rregullt ligjor, si dhe të drejtën për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, e mbi të gjitha parimin e barazisë së votës.**

Për sa më sipër dhe siç do të trajtohet gjerësisht në vijim, **duke respektuar edhe kërkesën e grupit të Partive Popullore Europiane të shprehur përmes deputetit të Parlamentit Evropian zoti Michael Gahler<sup>1</sup>**, në përfundim të shqyrtimit të këtij ligji në mbështetje të nenit 85 pika 1, kam vendosur **kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 118/2020** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, si

<sup>1</sup> Z. Michael Gahler, përmes një statusi publik të bërë po në datën 5 Tetor 2020, fill pas votimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, është shprehur se: “By voting today to breach the EU brokered 5 June agreement with the opposition, the Albanian Prime Minister Edi Rama cast a dark shadow over next April’s general election which were supposed to be free and fair and better than the previous ones. By doing so Rama clearly hinders Albania’s EU integration. More precisely the breach of the 5 June agreement may very well postpone the first Intergovernmental Conference as the first step for the beginning of the real EU accession negotiations.

Albania deserves much better than that. We call on the Albanian President to send back today’s laws to Parliament. We call on PM Rama to reconsider his position for the sake of the European future of the Albanian people.”

Përkthimi në shqip i këtij statusi: “**Duke votuar sot për të shkelur marrëveshjen e ndërmjetësuar të BE-së në 5 qershor me opozitën, Kryeministri shqiptar Edi Rama hodhi një hije të errët mbi zgjedhjet e përgjithshme të Prillit të ardhshëm të cilat supozohej të ishin të lira dhe të drejta dhe më të mira se ato të mëparshme. Duke e bërë këtë Rama qartë pengon integritimin e Shqipërisë në BE. Më saktësisht shkelja e marrëveshjes së 5 qershorit mund të shtyjë shumë mirë Konferencën e parë Ndërqeveritare si hapin e parë për fillimin e negociatave reale të pranimit në BE.**

**Shqipëria meriton shumë më mirë se kaq. Ne i bëjmë thirrje Presidentit shqiptar të kthejë ligjet e sotme në Parlament. Ne i bëjmë thirrje Kryeministrit Rama të rishikojë pozicionin e tij për hir të së ardhmes evropiane të popullit shqiptar.”**

Ky status mund të gjendet në link-un:

<https://www.facebook.com/100007343383150/posts/2720338128220940/?extid=0&d=n>

një mundësi e fundit që mazhoranca qeverisëse e Partisë Socialiste, të reflektojë e të tërhiqet nga sjellja dhe veprimet anti-demokratike që mund të favorizojnë Partinë Socialiste në procesin zgjedhor të 25 prillit 2021, por që do të dëmtojnë rëndë Shqipërinë, qytetarët e saj dhe të ardhmen europiane të tyre.

\* \* \* \* \*

## II. Mbi kontekstin e zhvillimeve politike e shoqërore në vend

Përpara se të kaloj në vlerësimin e detajuar të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, vlerësoj si shumë të domosdoshme të evidentoj në këtë arsyetim edhe një here, në mënyrë të përmbledhur, disa fakte e rrethana të renditura në mënyrë kronologjike, të cilat sjellin në kujtesë zhvillimet në vend dhe veprimtarinë antikushtetuese të Kuvendit të Shqipërisë përgjatë kësaj legjislature, duke filluar me lindjen e krizës së rëndë politike, kushtetuese, institucionale që ka përfshirë vendin prej shumë kohësh, si dhe veprimtarinë e shumicës qeverisëse parlamentare që ka patur ndikim dukshëm në përkeqësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Evidentimi i këtyre fakteve tregon qartë se, gjithçka që është përmbyllur me miratimin e ndryshimeve të njëanshme në Kodin Zgjedhor në datë 5 tetor 2020, ka qenë një skenar i paramenduar me autor kryesor mazhorancën qeverisëse.

**1.** Në nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohej se Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëmemërore. Zona zgjedhore shumëmemërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial, ndërkohë që kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor proporcional, për caktimin e zonave zgjedhore dhe për numrin e mandateve për secilën zonë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

Bazuar në këto rregullime kushtetuese dhe ato të Kodit Zgjedhor, në datën **25 qershor 2017**, u zhvilluan zgjedhjet pararendëse për Kuvendin e Shqipërisë për Legjislaturën e tij të **IX (nëntë)**.


Rezultati përfundimtar i këtij procesi zgjedhor u shpall nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me **vendimin nr. 555, datë 26.07.2017**, duke miratuar dhe listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt dhe për çdo zonë zgjedhore. Nga tabela përmbledhëse, shpërndarja e mandateve në këtë proces zgjedhor, e miratuar nga KQZ<sup>2</sup>, ishte si më poshtë:

LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM LSI	19	mandate
PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË PS	74	mandate
PARTIA DEMOKRATIKE PD	43	mandate
PARTIA SOCIAL DEMOKRATE E SHQIPËRISË PSD	1	mandate
PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET PDIU	3	mandate

**Gjithësej 140 mandate/deputetë**

<sup>2</sup> <http://results2017.cec.org.al/Parliamentary/Results?cs=sq-AL&r=r&rd=r14>

Seancën e parë kjo legjislaturë e zhvilloi në datën 9 shtator 2017, ku sipas rezultatit zgjedhor të shpallur nga KQZ, në mënyrë grafike përbërja e saj pasqyrohet si më poshtë<sup>3</sup>.



2. Edhe ky proces zgjedhor për Kuvendin e Shqipërisë (2017), si gjithë proceset e tjera në Shqipëri, u monitorua nga misionet ndërkombëtare. OSBE/ODIHR në raportin e fundit për zgjedhjet e përgjithshme 2017, u shpreh se gjatë procesit zgjedhor ishin vërejtur me shqetësim fenomeni i shit-bletjes së votës, i presionit ndaj votuesve, si dhe abuzimi i burimeve shtetërore për të ndikuar në rezultatin zgjedhor.

3. Mazhoranca qeverisëse që prej fillimit të legjislaturës së IX në vitin 2017 ka treguar mungesë të vullnetit për të bashkëpunuar dhe dialoguar në mënyrë të sinqertë me opozitën, ndërkohë që përgjatë viteve 2018-2019, ka mbizotëzuar një polarizim i fortë politik. Mungesa e dialogut politik ndërmjet mazhorancës dhe opozitës thelluan ndasitë dhe rritën mosbesimin ndërmjet palëve.

4. Mazhoranca qeverisëse socialiste në dhjetor 2017, në kundërshtim me atë që parashikonte Kushtetuta dhe rekomandimet eksplicite të Komisionit të Venecias, si dhe në injorim të thirrjeve të përsëritura të Presidentit të Republikës për dialog, zgjodhi në mënyrë të njëanshme Prokurorin e Përgjithshëm të Përkohshëm<sup>4</sup> me 69 vota. Ky ishte hapi i parë, por jo i vetëm i mazhorancës që provon veprimet e njëanshme të saj. Për të shmangur rrezikun e kapjes politike të organeve të reja të drejtësisë, Komisioni i Venecias rekomandoi që zbatimi i reformës, ashtu si edhe miratimi i saj në Kuvend, të ruante frymën e konsensusit.

5. Komisioni i Venecias rekomandoi që:

<sup>3</sup> <https://www.parlament.al/Kuvendi/ZgjedhjetParlamentare>

<sup>4</sup> Prokurori i Përgjithshëm i Përkohshëm nuk ekziston si parashikim në Kushtetutë.

*“Deri në zgjedhjet parlamentare të qershorit 2017, (deri në 1 shtator 2017<sup>5</sup>) zgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm të bëhet me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit (94 vota), ndërsa pas datës 1 shtator 2017 zgjedhjet e tjera të Prokurorit të Përgjithshëm të bëhen me 3/5 e anëtarëve të Kuvendit, (84 vota)”.*

**6.** Zbatimi i njëanshëm dhe në kundërshtim me rekomandimet e qarta të Komisionit të Venecias dhe parashikimet kushtetuese të reformës në sistemin e drejtësisë, ishte një prej shkaqeve kryesore për lindjen dhe përshkallëzimin më pas të krizës.

**7.** Ndërkohë që rekomandimet e OSBE/ODIHR mbetën të patrajuara për shkak të mungesës së dialogut politik konstruktiv ndërmjet mazhorancës dhe opozitës, në media rrodhën të dhëna nga dosje zyrtare në posedim të prokurorisë që dëshmonin mbi krime zgjedhore gjatë zgjedhjeve të pjesshme vendore në Bashkinë Dibër (2016) dhe zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2017.

**8.** Tashmë provat për disa nga pretendimet e opozitës, të paqyruara edhe në raportin e OSBE/ODIHR, gjendeshin në dy dosje të administruara nga Prokuroria me numrat e procedimeve 184 dhe 339. Nga materialet e publikuara, në formën e informacioneve të rrjedhura në mediat shqiptare dhe ndërkombëtare, dilte në pah një skemë e mirë organizuar që lidhte zyrtarë të lartë të Partisë Socialiste, përfshirë ministra të kabinetit qeveritar, kryetarë bashkish, oficerë të lartë të Policisë së Shtetit dhe nëpunës të tjerë të lartë të administratës, të cilët ishin në kontakt me eksponentë kriminalë të dyshuar si pjesë e bandave kriminale (të përfshira në trafik ndërkombëtar droge) për manipulimin e rezultatit zgjedhor në favor të Partisë Socialiste.

**8.1** Këto të dhëna, edhe pse në dispozicion të Prokurorisë prej më shumë se dy vitesh, nuk i kishin vënë në lëvizje organet hetimore për të kryer veprime të mëtejshme ligjore. Asnjë prej autorëve realë të përfshirë në këto komunikime (eksponentë të lartë të mazhorancës socialiste) nuk u dërgua përpara përgjegjësisë penale. Personat e përfshirë në këtë skemë kriminale gëzonin si imunitet politik ashtu edhe pandëshkueshmëri ligjore<sup>6</sup>.

**8.2** Publikimi i këtyre skandaleve përforcoi pretendimet e opozitës dhe denoncimet e hershme të saj për bashkëpunimin mes mazhorancës socialiste me krimin e organizuar<sup>7</sup>, për të siguruar marrjen e pushtetit përmes manipulimit të votës.

---

<sup>5</sup> Mazhoranca e atëhershme në Kuvend (PS + LSI) në momentin e miratimit të reformës zotëronte mbi 84 vota, pra mbi 3/5 e anëtarëve të Kuvendit të Shqipërisë.

<sup>6</sup> Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR konstaton se: “[...] mungesa e efikasitetit të hetimeve penale kontribuon në perceptimin e pandëshkueshmërisë mbi krimet zgjedhore të kaluara, duke përfshirë blerjen e votës dhe presionin ndaj votuesve.”

<sup>7</sup> Opozita arriti të kalojë në parlament ligjin për “Dekriminalizimin”, që pamundësonte mbajtjen e ofiqeve publike të personave me precedent penalë. Si pasojë e zbatimit të këtij ligji, një numër i lartë zyrtarësh, përfshirë deputetë, anëtarë të Partisë Socialiste u detyruan të largohen nga funksionet publike për shkak të precedentëve penalë në të kaluarën.



**8.3** Opozita pretendoi se Parlamenti aktual i dalë nga zgjedhjet e vitit 2017 nuk përfaqësonte vullnetin e lirë të popullit shqiptar, duke shtuar se në kushtet e kapjes edhe të organeve të drejtësisë nga Kryeministri e mazhoranca e tij socialiste, ajo nuk kishte rrugëdalje tjetër veç ndërmarrjes së hapit **ekstrem të djegies së mandateve parlamentare**.

**8.4** Nga ana e saj, qeveria fillimisht mohonte ekzistencën e provave që implikonin zyrtarë të Partisë Socialiste në krime zgjedhore, dhe akuzonte opozitën se përpiqej të mbulonte dobësinë e saj politike me njollosje të imazhit të vendit dhe të zyrtarëve të lartë socialistë.

**8.5** Kryeministri dhe zyrtarë të tjerë të lartë të Partisë Socialiste paditën disa anëtarë të opozitës për shpifje. Kryeministri fillimisht u shpreh se do të ngrinte padi edhe ndaj gazetarit të të përditshmes gjermane “Bild”, e cila publikoi një pjesë të përgjimeve audio, pjesë e dosjeve të prokurorisë. Edhe pse ai formalizoi proceduralisht angazhimin e një studioje avoktore të huaj, më pas Kryeministri Rama u tërhoq nga ngritja dhe zhvillimi i një shqyrtimi gjyqësor kundër gazetarit të të përditshmes gjermane “Bild”.

**8.6** Ndërsa organi i prokurorisë reagoi ndaj këtyre skandaleve mediatike duke komunikuar publikisht se kishte nisur hetimet mbi “rrjedhjen e informacionit hetimor”, ndërkohë që nuk dha asnjë sqarim i plotë mbi fatin e të dhënave hetimore të dosjeve 184<sup>8</sup> dhe 339 në dispozicion të saj.

**8.7** Në këto kushte, opozita nisi organizimin e rregullt të protestave masive kombëtare duke kërkuar dorëheqjen e Kryeministrit dhe zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme të parakohshme.

Atmosfera u rëndua më tej me përdorimin e gjuhës armiqësore dhe përçarëse nga të dy kampet politike gjatë komunikimeve të tyre publike. Protestat u shoqëruan me akte dhune si dhe me reagim shproporcional nga ana e Policisë së Shtetit.

Protestat gjetën mbulim të gjerë mediatik kombëtar dhe ndërkombëtar, për shkak të intensifikimit të përplasjes mes protestuesve dhe policisë.

**8.8** Në fillim të muajit dhjetor 2018, i gjithë vendi u përfshi nga një valë protesash masive të studentëve të arsimit të lartë kundër qeverisë, duke e detyruar Kryeministrin që në fillim të muajit janar 2019 të rikompozojë shumicën e kabinetit qeveritar.

Protesta të tjera të bizneseve të vogla dhe të mesme, të fermerëve, mjekëve, artistëve etj., vijuan të përhapen në qytete të ndryshme të Shqipërisë, duke kulmuar me protestën e dhunshme mbi taksën e

---

<sup>8</sup> Në përfundim të afatit 3-vjeçar të regjistrimit të procedimit penal (gusht 2016), dosja penale 184 që i përket krimeve zgjedhore të kryera në Qarkun Dibër, u transferua nga Prokuroria e Krimeve të Rënda për kompetencë lëndore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër.

vendosur në “Rrugën e Kombit” shoqëruar me djegie dhe shkatërrim, dhe protestën e banorëve të “Unazës së Re” në Tiranë.

Qeveria reagoi ndaj protestës së dhunshme në “Rrugën e Kombit”, duke u tërhequr dhe rishikuar pasojat financiare mbi banorët e zonës së Kukësit.

Qeveria u tërhoq pjesërisht nga projekti i “Unazës së re”, duke pranuar falsifikimin e dokumenteve të firmës zbatuese të projektit. Por mosreagimi i organit të Prokurorisë dhe i strukturave të tjera ligjzbatuese në lidhje me hetimin e plotë dhe të të gjithë autorëve të këtij skandali, krijuan hije të forta dyshimi për ndikim në vendimet dhe veprimtarinë e organit të Prokurorisë nga ana e qeverisë.

Kjo çështje që mori dhe mbulim të gjerë mediatik, thelloi edhe më shumë kundërshtitë ndërmjet kampeve politike dhe forcoi pretendimet e opozitës për kapjen nga ana e mazhorancës të organeve të drejtësisë.

**8.9** Qëndrimet e kundërta u thelluan më tej kur opozita bojkotoi Parlamentin gjatë muajve shtator-dhjetor 2018, dhe paralajmëroi dorëzimin e mandateve parlamentare kur mazhoranca rrëzoi me votë në Kuvend nismën e saj për ndryshime kushtetuese për realizimin e procesit *vetting* në klasën politike.

**8.10** Më herët opozita pati ngritur shqetësimin për kufizimin dhe bllokimin e rolit të saj mbikëqyrës në Kuvend, përfshirë të drejtën e ngritjes së komisioneve hetimore dhe thirrjes për raportim përpara Kuvendit të anëtarëve të kabinetit qeveritar. Qeveria nga ana e saj pretendonte se i kishte ofruar opozitës kohë të mjaftueshme në foltoren e Kuvendit, por se opozita kërkonte ta shfrytëzonte parlamentin për të bllokuar reformat e qeverisë.

**8.11** Opozita pati denoncuar gjithashtu keqpërdorimin e veprimtarisë ligjbërëse të mazhorancës socialiste në Kuvend, e cila përmes ligjeve të posaçme antikushtetuese miratoi kontrata koncesionare që përbënin trajtim preferencial të subjekteve të caktuara, duke thelluar dyshimet për korrupsion.

**8.12** Mosbesimi i tejskajshëm dhe qëndresa në llogoret politike diametralisht të kundërta, përkeqësuan më tej klimën politike. Mungesa e plotë e dialogut politik dhe kokëfortësia e palëve për të vazhduar kursin e përplasjes, ndikuan në polarizimin e mëtejshëm të jetës shoqërore në vend.

**8.13** Nën presionin e shtuar të mbështetësve të tyre dhe të zërave publikë me peshë në opinionin vendas, **partitë opozitare deklaruan dorëzimin në bllok të dorëheqjes nga mandatet parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë.**

**8.14** Thirrjet publike të Presidentit të Republikës drejtuar të dy palëve për prapësim nga ky kurs përplasjeje dhe çdo përpjekje tjetër për të vendosur urgjent një kanal dialogimi mes palëve, për fat të keq, qenë të pasuksesshme.

**8.15** Opozita, në muajin shkurt 2019, dorëzoi në bllok **58 mandate** parlamentare (**182** mandate të dorëzuara dhe të refuzuara), ndërsa mazhoranca përshpejtoi procedurat e pranimit të dorëheqjeve dhe zëvendësimin e tyre<sup>9</sup> në shkelje të Kushtetutës, Kodit Zgjedhor dhe Rregullores së Kuvendit.

Mazhoranca nxitoi të kryente pa vonesë zëvendësimin e mandateve të **58 deputetëve të opozitës** së dorëhequr në bllok në muajin **shkurt-mars 2019**.

**8.16** Ky akt ekstrem i paprecedentë në historinë politike të demokracisë shqiptare i dha një përmasë të re krizës në vend, tashmë jo vetëm politike, kushtetuese dhe institucionale, por edhe të përfaqësimit.

**58 (pesëdhjetë e tetë) vakanca** u shfaqën brenda së njëjtës periudhë ku ish-deputetët përfaqësues të partive opozitare, kanë depozituar pranë Kuvendit të Shqipërisë aktet e dorëheqjeve të tyre nga mandati si deputetë në Kuvendin e Shqipërisë. Ky moment u shoqërua edhe me tubime masive pranë Kuvendit të Shqipërisë, ku bëhej e ditur botërisht dorëzimi i mandateve të deputetëve të opozitës.

Rezultoi se përveç 58 deputetëve opozitarë të dorëhequr, **124 kandidatë për deputetë** që gjendeshin në listat shumëmbrore të konkurrimit të secilës parti opozitare, nuk pranuan marrjen e mandatit, pas dorëheqjes së kolegëve të tyre. Ndërkohë që kanë pranuar marrjen e mandatit të ofruar nga KQZ, kandidatë që ndodheshin në vendet e fundit të listave shumëmbrore të konkurrimit. Në total, kanë refuzuar ushtrimin/marrjen e mandatit 182 deputetë dhe kandidatë për deputetë.

**8.17** Numri aktual i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë është **122**, ndërkohë që Kushtetuta përcakton se numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë **duhet të jetë 140**. Ndërkohë që **18 mandate** të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kanë mbetur të paplotësuara për shkak të shterimit të listave shumëmbrore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike dhe të gjithë partive të tjera opozitare.

---

<sup>9</sup> Në total, kanë refuzuar ushtrimin/marrjen e mandatit **182 deputetë dhe kandidatë për deputet**.

Kanë refuzuar marrjen e mandatit **124 kandidatë** për deputet nga lista shumëmbrore të opozitës.

Kanë dhënë dorëheqje në bllok nga mandatet **58 deputetë**.

Numri **aktual** i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë është **122**, ndërkohë që **Kushtetuta përcakton se numri i deputetëve në Kuvendin e Shqipërisë duhet të jetë 140**.

**18 mandate** të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë kanë mbetur të **paplotësuara** për shkak të shterimit të listave shumëmbrore të kandidatëve për deputet të Partisë Demokratike.

**8.17.1** Asnjë deputet që depozitoi dorëheqjen nuk u thirr përpara ndonjë Komisioni të Kuvendit të Shqipërisë për të deklaruar publikisht heqjen dorë nga mandati, sipas kërkesave të nenit 164, pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Kodi Zgjedhor në nenin **164 parashikonte** se:

*“Mandati i deputetit, i fituar sipas neneve 162 dhe 163 të këtij/Kodi, ndërpritet vetëm për shkaqet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës.*

*Nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të mandatit **marrëveshjet apo deklaratat paraprake individuale apo kolektive** për heqje dorë nga mandati. Në rastin e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 71 të Kushtetutës, deputeti deklaron në mënyrë publike **përpara komisionit përkatës të Kuvendit** refuzimin për të bërë betimin **ose heqjen dorë nga mandati**. Në këtë rast Kuvendi, jo më vonë se 30 ditë, njofton KQZ-në për krijimin e vakancës.”*

**Pra Kodi Zgjedhor e ndalonte dorëheqjen në bllok nga mandatet.**

**8.17.2** Ndërkohë që, asnjë deputet i dorëhequr nuk u thirr përpara **Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin** për t`u dëgjuar mbi arsyet e dorëheqjes dhe për të deklaruar publikisht heqjen dorë nga mandati, sipas kërkesave të nenit 164, pika 1, e Kodit Zgjedhor. **Kuvendi kishte 30-ditë kohë për secilin deputet për të realizuar këto procedura, por nuk e respektoi këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor, duke nxituar për t`i zëvendësuar mandatet përmes njoftimeve administrative të Sekretarit të Përgjithshëm.**

**8.17.3** Në zbatim të nenit 71/2 “b” dhe 75/2 të Kushtetutës, nenit 164/1 të Kodit Zgjedhor, si dhe nenit 13 e në vijim të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, **të gjitha veprimet procedurale, të vlerësimit dhe vendimmarrjes** mbi konstatimin e vakancave në Kuvendin e Shqipërisë dhe vërtetimit të kushteve të mbarimit të mandatit për çdo deputet të dorëhequr **duhet të ishin kryer fillimisht nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe më pas nga Kuvendi i Shqipërisë me vendim në seancë plenare.**

**8.17.4** Në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe Rregullores së Kuvendit, të gjitha veprimet, vlerësimet dhe njoftimet për secilën nga vakancat e shfaqura në Kuvendin e Shqipërisë, të lindura për shkak të dorëheqjes nga mandati i deputetit **rezultojnë të jenë kryer vetëm nga Sekretari i Përgjithshëm me shkresa administrative.**

**8.17.5 Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit**, jashtë kompetencave të tij dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar për çdo dorëheqje të dorëzuar, **menjëherë** (brenda një periudhe nga **1 deri nga 4 ditë nga dorëzimi i dorëheqjes**) ka kryer veprimin e konstatimit të vakancës dhe njoftimin e saj në KQZ. E gjithë veprimtaria dhe praktika administrative e ndjekur në këtë drejtim është në kundërshtim me kërkesat e ligjit dhe paraqet tërësisht elementë të **pavlefshmërisë absolute.**

**8.17.6** Nën këtë praktikë antikushtetuese dhe të paligjshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas njoftimit të krijimit të vakancës prej Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit, edhe pse është njohur me faktin se praktika shkresore nuk përmbante asnjë vendim të Kuvendit të Shqipërisë sipas ligjit, sërish **ka vijuar me ndjekjen e procedurave për plotësimin e menjëhershëm të vakancave, sipas rendit zbritës në listat shumëvjeçore, duke u bërë kështu pjesë e këtij procesi tërësisht të paligjshëm.**

**8.17.7** Formalisht, “opozita” aktuale parlamentare përbëhet më së shumti nga deputetë që kanë qënë në listat e partive opozitare që kanë braktisur Parlamentin, por në realitet, në Shqipëri, zgjedhësit votojnë sipas preferencave për Partitë politike apo/dhe kryetarët e tyre. Shumica e kandidatëve që kanë pranuar mandatet parlamentare në emër të opozitës, janë të panjohur për zgjedhësit, pasi ata renditeshin në pjesët fundore të listave të hartuara nga Kryetarët e Partive, dhe **vullneti i popullit i shprehur me votë** në zgjedhjet e 25 qershorit 2017, **nuk arriti deri tek emrat e tyre.**

**8.17.8** Këto janë arsyt kryesore që i bëjnë ato mandate opozitare të zëvendësuar jo legjitime dhe për të cilat vazhdimisht kam bërë publik qëndrimin tim se, Kuvendi **nuk ka legjitimitet për të realizuar reforma kushtetuese dhe aq më pak të ndryshimit të sistemit zgjedhor apo rregullave zgjedhore, pa konsensusin gjithëpërfshirës të opozitës reale që sot ndodhet jashtë Kuvendit të Shqipërisë.**

**9.** Mazhoranca përmes përfaqësuesve të saj në ish-Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, **pa pjesëmarrjen e opozitës, pa garë dhe pa konkurrencë,** dhe pa një datë zgjedhjesh të caktuar nga Presidenti i Republikës, zhvilloi e vetme në datën 30 qershor 2019, një proces farsë votimesh për pushtetin vendor.

**9.1** Opozita nuk u regjistrua në zgjedhjet për pushtetin vendor. Procesi i votimeve për pushtetin vendor, u zhvillua më 30 qershor 2019, pa pjesëmarrjen e opozitës, pa konkurrim, pa një datë për mbajtjen e zgjedhjeve të përcaktuar sipas ligjit nga Presidenti i Republikës. Kjo solli si rezultat që aktualisht, 61/61 bashkitë dhe këshillat bashkiakë të vendit, të drejtohen dhe përfaqësojnë vetëm Partinë Socialiste.

**9.2** Data 30 qershor 2019 nuk ekzistonte ligjërisht si datë zgjedhjesh për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, pasi Presidenti i Republikës kishte përcaktuar si datë për zhvillimin e zgjedhjeve datën 13 tetor 2019. Ky dekret i Presidentit dhe dekreti për shfuqizimin e datës 30 qershor 2019 si ditë zgjedhjesh për pushtetin vendor, nuk u zbatua nga ish-anëtarët e Partisë Socialiste në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe ky akt nuk u sfidua drejtpërdrejt përpara ndonjë gjykate.

**9.3** Zhvillimi i këtyre zgjedhjeve pa garë dhe pa alternativa konkurruese, në shkelje të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare, passolli që i gjithë sistemi i qeverisjes vendore të humbasë legjitimitetin

dhe përfaqësimin e larmishëm politik dhe të jetë në duart e një force të vetme politike (Partisë Socialiste).

**Aktualisht, në Gjykatën Kushtetuese është regjistruar të paktën një çështje në lidhje me antikushtetutshmërinë e këtyre zgjedhjeve, çështje kjo që konsolidon bindjen mbi vullnetin e mazhorancës qeverisëse për të vonuar apo dhe bllokuar plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese dhe kapjen politike të saj.**

\* \* \* \* \*

### III. Mungesa e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese prej 32 muajsh

Një situatë tjetër shumë problematike është dhe mos qënia funksionale e Gjykatës Kushtetuese prej më shumë se 32-muajsh dhe bllokimi i funksionimit të veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) nga mazhoranca, me qëllim që këto vende bosh në Gjykatën Kushtetuese të mos plotësoheshin, duke e nxjerrë praktikisht qeverinë dhe Kuvendin jashtë kontrollit kushtetues.

Dalja jashtë funksioni e Gjykatës Kushtetuese u shkaktua për shkak të dy rrethanave.

Ndërkohë që procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve (*vetting*- u) filloi të zbraste Gjykatën Kushtetuese, **mazhoranca socialiste bllokoi funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për të mos lejuar plotësimin e vendeve vakante<sup>10</sup>.**

Nëse KED nuk do të ishte bllokuar përgjatë viteve 2017- 2018, Gjykata Kushtetuese do të kishte vijuar funksionimin normal, pasi vakancat e krijuara do të ishin plotësuar rast pas rasti.

Presidenti i Republikës ka qenë i vetmi që ka bërë çdo përpjekje institucionale për funksionimin e KED-së. Fatkeqësisht, përpjekjet e tij të pandërprera u minuan nga mazhoranca socialiste me qëllim bllokimin e KED-së, duke sjellë si pasojë daljen jashtë funksioni të Gjykatës Kushtetuese.

Jo vetëm kaq, por mazhoranca qeverisëse, përmes funksionarëve politikë të qeverisë, institucioneve të administratës shtetërore nën kontroll apo varësi të saj, apo funksionarëve të sistemit të drejtësisë, ka bllokuar edhe dhënien në kohë të informacionit për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, apo e ka keqpërdorur misionin e këtij organi duke sjellë vonesa edhe më të mëdha dhe të pajustificuara e duke zgjatur e vonuar kështu plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese.

Mungesa e Gjykatës Kushtetuese ka bërë që veprimtaria e qeverisë dhe Kuvendit, që prej muajit mars 2018, të jetë jashtë kontrollit kushtetues.

**Nga ana tjetër, zgjedhja e njëanshme antikushtetuese e Prokurorit të Përgjithshëm të Përkohshëm në dhjetor 2017, nxorrën *de facto* edhe jashtë kontrollit dhe hetimit penal vendimmarrjet e qeverisë dhe të Kuvendit.**

---

<sup>10</sup> Shiko Draft Opinionet paraprake dhe Opinionin Final të Komisionit të Venecias nr. 978 të datës 19 qershor 2020. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)010-e)

**Nxjerrja jashtë funksioni e Gjykatës Kushtetuese tashmë prej 32 muajsh është një nga faktorët kryesorë që ndikuan në përshkallëzimin drejt kësaj krize të paprecedentë kushtetuese, institucionale dhe të përfaqësimit.**

Jo vetëm kaq, por mazhoranca përmes veprimeve të paligjshme të ish-Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ministrit të Drejtësisë, zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë, bënë të gjitha përpjekjet e mundshme për t'i rrëmbyer Presidentit të Republikës kompetencën e emërimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përpjekje kjo e cila rezultoi e pasuksesshme edhe pse në funksion të këtij qëllimi u vendos e gjithë administrata shtetërore, që nga Qendra e Botimeve Zyrtare, ministri i Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë, Kryetari i KED-së, etj.

Si rezultat i këtyre veprimeve të paligjshme, gjendja u rëndua edhe më shumë dhe siç dihet botërisht, çështja u mor në shqyrtim edhe nga Komisioni i Venecias, përmes një kërkesë që Kuvendi i Shqipërisë i drejtoi këtij organizmi në datën 30 dhjetor 2019.

Ky komision, në Opinionin e tij Final nr. 978/2020, datë 19.06.2020<sup>11</sup> “Për emërimet e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese”, por dhe në opinionet paraprake, evidentoi qartë gjithë problematikat e këtij procesi, vonesat, si dhe kush ishin autorët politikë dhe përfaqësuesit e mazhorancës socialiste që ndikuan në bllokimin e këtij procesi, ashtu si dhe autorët e shkaktarët e veprimeve të paligjshme.

Si rezultat i vonesave, vendi sot gjendet në një situatë ku është bërë e mundur që në Gjykatën e Lartë të emërohen vetëm tre gjyqtarë të rinj. Ndërkohë që Gjykata Kushtetuese ka në detyrë vetëm 4 anëtarë, duke mos qenë kështu në gjendje për të marrë vendime lidhur me kushtetutshmërinë e çështjeve të ndryshme, përfshirë çështje që lidhen me procesin votimeve të 30 qershorit 2019, vet ligjin nr. 118/2020, apo çështje të tjera që mund të lindin gjatë procesit zgjedhor të përcaktuar për t'u mbajtur në datë 25 prill 2021.

**Në mungesë të funksionimit të plotë të Gjykatës Kushtetuese, asnjë pretendim qoftë dhe për këtë ligj ndryshues të Kodit Zgjedhor, nuk mund të shqyrtohet për të marrë një përgjigje përfundimtare.**

**Referuar gjendjes aktuale ekziston rreziku që procesi zgjedhor i datës 25 prill 2021, të zhvillohet pa një Gjykatë Kushtetuese plotësisht funksionale me të 9 anëtarët e saj, ç'ka passjell rrezikun potencial që çështje të caktuara me sensitivitet dhe interes të lartë publik, të mos merren në shqyrtim prej saj me një vendim përfundimtar, duke e lënë situatën të nderë e të tensionuar.**

OSBE/ODIHR në Raportin Përfundimtar për votimet e 30 qershorit 2019, me të drejtë ka konstatuar se, “Vetting-u i gjyqtarëve dhe prokurorëve, i cili është pjesë e reformës në drejtësi që është në

<sup>11</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)010-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)010-e)



vazhdim e sipër, vlerëson integritetin, pasurinë dhe profesionalizmin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Vetting-u ka çuar në shumë shkarkime dhe dorëheqje, duke ndikuar kështu në funksionimin e shumë gjykatave dhe prokurorive, duke e lënë veçanërisht Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë pa kuorumin që u nevojitet për të qenë funksionale.”<sup>12</sup> Gjithashtu, ka konstatuar se “Kushtetuta i jep juridiksion Gjykatës Kushtetuese për shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese, por në praktikë, ky juridiksion nuk ushtrohet sa i përket të drejtave zgjedhore.”<sup>13</sup>

Pra OSBE/ODIHR me shqetësim konstaton pamundësinë e shqyrtimi të ankimeve për shkelje të drejtave themelore kushtetuese zgjedhore të zgjedhësve dhe të subjekteve zgjedhore në zgjedhjet e radhës.

Për këtë arsye, OSBE/ODIHR rekomandon si prioritet që: “**Të gjitha gjykatat që kanë kompetencë në fushën e zgjedhjeve duhet të jenë plotësisht funksionale gjatë periudhave zgjedhore. Duhet të garantohen pavarësia dhe paanshmëria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e gjyqësorit.**”

Kodi Zgjedhor përcakton vetëm një gjykatë me kompetencë në fushën e zgjedhjeve, Kolegjin Zgjedhor, i cili u zgjodh me short nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në datën 8 shtator 2020.

Ndërkohë që referimi i OSBE/ODIHR-it në rekomandimin e tij tek “gjykatat” lidhet drejtpërdrejt dhe me kompetencën që Kushtetuta i jep Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar çdo shkelje të të drejtave në nivel kushtetues, përfshirë ato zgjedhore.

Nga njëra anë, me ligjin nr. 118/2020, cenohet pavarësia e Kolegjit Zgjedhor, për shkak të ndryshimeve të nenit 149 të Kodit Zgjedhor dhe krijimit të mundësisë së rritjes në karrierë të gjyqtarit gjatë ushtrimit të funksionit prej tij si anëtar i Kolegjit Zgjedhor. Nga ana tjetër, edhe nëse Gjykata Kushtetuese përgjatë kësaj periudhe do të plotësohet me numrin prej 6 anëtarësh, numër ky minimal që kjo gjykatë të ulet në seancë plenare, **mos emërimi i 3 gjyqtarëve nga Gjykata e Lartë paraqet qartësisht rrezikun e mosfunksionimit normal në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese.**

Kjo sepse sipas ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, **një çështje në Gjykatën Kushtetuese mund të shqyrtohet dhe për të mund të merret një vendim përfundimtar, kur “pro” ose “kundër” votojnë 5 anëtarë të saj**<sup>14</sup>.

<sup>12</sup> Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore, i datës 5 shtator 2019, footnote nr. 86. Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un: <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/417425>

<sup>13</sup> Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore, i datës 5 shtator 2019, footnote nr. 87. Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un: <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/417425>

<sup>14</sup> Neni 72, pika 2, e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, parashikon se: **Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Abstenimi nuk lejohet.**

Ndaj është e pritshme që mazhoranca qeverisëse do të vijojë të gjitha përpjekjet përmes mekanizmave të saj për të penguar apo për të mos lejuar funksionimin normal të KLGJ-së dhe KED për të bërë të mundur bllokimin e emërimit e anëtarëve të tjerë në mënyrë që ky numër të mos arrihet dhe kjo përkthehet në rrëzimin e një kërkimi kushtetues, ende pa u shqyrtuar, sipas parashikimit të nenit 73, pika 4, e ligjit nr. 8577/2000, që sanksionon se:

***“Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.”***

\* \* \* \* \*

#### **IV. Kuvendi ka humbur tërësisht rolin e tij kushtetues të kontrollit të Qeverisë** **Veprimtaria antikushtetuese e Kuvendit në procesin ligjvënës gjatë kësaj legjislature**

Në vijimësi Presidenti i Republikës ka konstatuar një zbehje konstante të rolit mbikëqyrës të Kuvendit përkundrejt veprimtarisë së qeverisë. Aktualisht, pas dorëheqjes në bllok nga mandatet të opozitës duket qartë se Kuvendi ka humbur tërësisht rolin mbikëqyrës dhe kontrollues ndaj ekzekutivit. Ky pozicion dominues i qeverisë ndaj Kuvendit u theksua edhe më shumë pas procesi të votimeve për pushtetin vendor të 30 qershorit 2019.

Tashmë qeveria ushtron autoritetin kontrolli të plotë dhe ndaj pushtetit vendor, duke cenuar rëndë parimin e decentralizimit dhe autonomisë vendore. Edhe pushteti vendor qartësisht është një zgjatim i natyrshëm i ekzekutivit.

Ndërkohë që shumica qeverisëse ushtron kontroll të plotë edhe ndaj shumicës së institucioneve të tjera të pavarura.

Kuvendi i Shqipërisë, përgjatë kësaj gjithë kësaj legjislature, përveç ndryshimeve të fundit në Kodin Zgjedhor që janë dhe objekt shqyrtimi, ka miratuar një mori ligjesh me një nivel të lartë abuzivizmi, ligje këto të cilat bien në kundërshtim flagrant me dispozitat kushtetuese, aktet ndërkombëtare që Shqipëria ka ratifikuar dhe që cenojnë interesin publik dhe atë shtetëror. Ndër këto ligje do të përmendja:

- Ligjin nr. 111/2020 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar”;
- Ligjin nr. 102/2020 “Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”;
- Ligjin nr. 74/2020 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, të ndryshuar”;
- Ligjin nr. 66/2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, (*Bitcoin*- monedha dixhitale);
- Ligjin nr. 62/2020 “Për tregjet e Kapitalit”;
- Ligjin nr. 64/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; (TVSH e Jahteve)
- Ligjin nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”;
- Ligjin nr. 58/2020 “Për miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës ‘BOT’ (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës,

- miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërisë koncesionare ‘Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)’, të ndryshuar”;
- Ligjin nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
  - Ligjin nr. 18/2020 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, ‘Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”;
  - Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
  - Ligjin nr. 14/2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese’, të ndryshuar”;
  - Ligjin nr. 15/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, të ndryshuar”;
  - Ligjin nr. 91/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”; (pjesë e paketës “antishpifje”);
  - Ligjin nr. 92/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” (pjesë e paketës “antishpifje”);
  - Ligjin nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”;
  - Ligjin nr. 75/2019, “Për rininë”;
  - Ligjin nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”;
  - Ligjin nr. 52/2019, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldren”;
  - Ligjin nr. 51/2019, “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, dhe “Gjikuria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Rruga Orikum – Llogara”, sh.p.k., për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti i jahteve – By-Pass Orikum – Dukat (ura e Shën Elizës)”;
  - Ligjin nr. 50/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar”;
  - Ligjin nr. 44/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”;
  - Ligjin nr. 42/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”;
  - Ligjin nr.38/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
  - Ligjin nr. 37/2019, “Për disa shtesa në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe

institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr. 3/2015”;

- Ligjin nr. 36/2019, “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”;
- Ligjin nr. 20/2019, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”;
- Ligjin nr. 111/2018, “Për Kadastrën”;
- Ligjin nr. 94/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”;
- Ligjin nr. 37/2018, datë 20.09.2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar”;
- Ligjin nr. 39/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”;
- Ligjin nr. 98/2017, “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.

Një pjesë e mirë e këtyre ligjeve kanë karakter favorizues dhe preferencial për një pjesë të caktuar të bizneseve. Kuvendi, përmes miratimit me ligj, është përpjekur që të sigurojë mbrojtje ligjore për të gjithë subjektet që kanë konsumuar veprime të paligjshme.

Përmes këtyre ligjeve, Kuvendi i Shqipërisë ka shkelur hapur Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe ka sjellë pasoja të rënda duke cenuar lirinë e veprimtarisë ekonomike, barazinë para ligjit, të drejtën e pronës private, shfrytëzimit racional të pasurisë publike, mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, apo zhvillimit të qëndrueshëm, duke dëmtuar buxhetin dhe financat e shtetit, pronën publike, dhe cenuar direkt të drejtat dhe liri themelore të qytetarëve dhe për pasojë, interesin publik.

Përmes miratimit të këtyre ligjeve mazhoranca qeverisëse,

- ka përmbysur hierarkinë e normave në Republikën e Shqipërisë;
- ka realizuar qëllimet politike për trajtimin preferencial të disa subjekteve tregtare në dëm të interesave dhe financave të shtetit;
- ka cenuar të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të informimit;
- ka cenuar parimin e decentralizimit dhe autonomisë së pushtetit vendor;
- ka shkelur parimin e trajtimit të barabartë dhe ka stimuluar trajtimin preferencial me ligj;
- ka dhunuar disa herë parimin e sigurisë juridike dhe shtetit të së drejtës;
- ka tentuar të kufizojë kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës;
- ka krijuar konflikt institucional kushtetues me institucionet e tjera;

- ka cenuar të drejtat civile dhe politike të qytetarëve;
- ka cenuar të drejtën e qytetarëve për t'iu drejtuar një gjykate të caktuar me ligj;
- ka cenuar respektimin e jetës private;
- ka keqpërdorur financat dhe pasurinë pronë publike;
- ka cenuar trashëgiminë kulturore dhe identitetin kombëtar; apo të drejta të tjera të njohura nga Kushtetuta dhe aktet ndërkombëtare që janë pjesë e legjislacionit të brendshëm të detyrueshme për zbatim.

Përmes këtyre ligjeve dhe veprimtarisë së Kuvendit është shkelur hapur dhe në mënyrë të përsëritur edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e së cilës janë të detyrueshme për zbatim si për pjesën e dispozitivit, ashtu dhe për pjesën arsyetuese të tyre.

E gjithë kjo veprimtari antikushtetuese dhe kundër interesave të qytetarëve të vendit nuk është pranuar nga Presidenti i Republikës dhe përmes dekreteve këto ligje janë kthyer për rishqyrtim në Kuvend. Ky i fundit, për fat të keq, nuk ka reflektuar për rishikimin e tyre.

Mospatja e një Gjykate Kushtetuese funksionale përgjatë gjithë kësaj legjislature ka bërë të pamundur dhe pezullimin e efekteve të zbatimit të këtyre ligjeve, duke sjellë kështu pasoja të rënda të pariparueshme ekonomike, sociale, shoqërore, për të gjithë qytetarët e vendit.

I gjithë ky aktivitet antikushtetues i mazhorancës u evidentua qartë edhe në veprimtarinë e Kuvendit përgjatë muajve tetor 2019 e në vijim, që nxirrte në pah jo vetëm synimin e bllokimit të funksionimit të Gjykatës Kushtetuese për dy vite radhazi (2017-2018), por tanimë dhe rrëmbimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim kontrollin e përbërjes së saj për të siguruar më pas një vendimmarrje të kësaj gjykate në mbështetje të qeverisë dhe të shumicës parlamentare një partiake.

Në finalizim të të gjithë kësaj veprimtarie antikushtetuese që nuk ka të ndalur, Kuvendi i Shqipërisë përmes ndryshimeve të njëanshme në Kodin Zgjedhor, të realizuara pa konsensus me ligjin nr. 118/2020, po tenton që të instalojë një vijimësi të qëndrimit në pushtet përmes një procesi zgjedhor ku rregullat e garës elektrorale i cakton në mënyrë të njëanshme ai që qeveris, duke tentuar që të zvogëlojë fuqinë e mbështetjes popullore të forcave politike kundërshtarë opozitare.

\* \* \* \* \*

## V. Kushtet (15) e vendosura nga Këshilli European

Kjo krizë e rëndë dhe e paprecedentë politike, institucionale dhe kushtetuese, u thellua më tej për shkak të zhvillimit të votimeve një-partiake në nivel lokal, në kundërshtim me dekretin e Presidentit të Republikës, pa mundësi zgjedhjeje ndërmjet alternativash dhe pa pjesëmarrjen e opozitës.

Në këto kushte, përfshirë asgjësimin e çdo mekanizmi kushtetues llogaridhënës për qeverisjen, Bashkimi European vendosi 15 kushte të reja eksplicite për Shqipërinë, në mbledhjen e Këshillit European të 25 marsit 2020.

Këshilli European rikonfirmoi mbështetjen politike dhe strategjike për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European, dhe evidentoi se përgjegjësia për nisjen e negociatave i takon autoriteteve shqiptare me plotësimin e **6 kushteve** përpara zhvillimit të Konferencës së Parë Ndërqeveritare me BE, **dhe 9 të tjerave** të cilat do të duhet të reflektohen në Kuadrin Negociator.

Këshilli European i kërkoi Komisionit raportimin e hollësishëm për përparimin në secilin kusht, ndërkohë që metodologjia e re në fuqi, parashikon edhe misionet monitoruese *ad hoc* nga vendet anëtare për të kontrolluar në terren përparimin e pretenduar.

Si rregull, Komisioni European do të duhej të kishte paraqitur raportin e progresit përpara mbledhjes së Këshillit European të qershorit 2020. Megjithatë, për t'u dhënë edhe një mundësi gjatë Presidencës gjermane të BE-së, u vendos që ky raport të publikohej në vjeshtë, përpara Këshillit European të nëntorit, kur do të vendoset mbi ecurinë e procesit për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Vendimi për nisjen e negociatave do të merret nëse:

“Shqipëria përpara mbledhjes së parë të Konferencës Ndërqeveritare:

- 1. Do të miratojë reformën zgjedhore, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, përfshirë sigurimin e transparencës për financimin të fushatave zgjedhore dhe të partive politike;**
- 2. Do të sigurojë vazhdimësinë e reformës në drejtësi – Përfshirë sigurimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën ndërkombëtare përkatëse përfshirë opinionet e Komisionit të Venecias;**
- 3. Do të përfundojë ndërtimin e strukturave të specializuara që luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK dhe BKH);**

4. Do të forcojë luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë përmes bashkëpunimit me vendet anëtare të BE dhe përmes një plan-veprimi për zbatimin e rekomandimeve të FATF (Financial Action Task Force);
5. Do të trajtojë fenomenin e azilkërkuesve dhe të sigurojë riatdhesimin e tyre;
6. Do të amendojë ligjin e medias sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias; Komisioni do të hartojë një raport mbi këto çështje duke përfshirë dhe përparimin mbi një bazë të gjurmueshme të dhënash kur të prezantohet kuadri negociator. Kuadri negociator do të miratohet nga Këshilli dhe duhet të reflektojë që Shqipëria ka trajtuar me sukses prioritetet kyçe;
7. Nisjen e procedimeve penale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për vepra penale gjatë procesit të vetingut;
- 8. Nisjen e procedimeve kundër personave të akuzuar për blerjen e votës;**
9. Të ketë një bazë të gjurmueshme të dhënash solide për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet, përfshirë nisjen dhe përfundimin e procedimeve të para kundër zyrtarëve të lartë dhe politikanëve;
10. Përparim të mirëfilltë në reformën e administratës publike;
- 11. Zbatimi i reformës zgjedhore;**
- 12. Një vendim përfundimtar mbi ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019;**
13. Përparim të mëtijshëm në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit kuadër për mbrojtjen e minoriteteve të vitit 2017;
14. Miratimin e ligjit për regjistrimin e popullatës sipas rekomandimeve të Këshillit të Europës;
15. Përparimin e procesit të regjistrimit të pronës<sup>15</sup>.

\* \* \* \* \*

---

<sup>15</sup>Konkluzionet e Këshillit të 25 marsit 2020: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf>



## VI. Rifillim i dialogut politik dhe konstituimi i Këshillit Politik si instrument i besueshëm dhe i pranueshëm nga aktorët vendas dhe institucionet ndërkombëtare

1. Pas një kohe të gjatë që palët politike nuk reflektonin vullnet për t'u ulur e dialoguar me njëri-tjetrin, një zhvillim pozitiv u shënuar përgjatë **muajit janar 2020**.

Midis forcave politike u arrit një Marrëveshje në datën **14 Janar 2020**, përmes së cilës formësohet Kuadri i Bashkëpunimit midis të gjitha palëve për Reformën Zgjedhore. (Konstituohet **Këshilli Politik**).

Ky ishte një hap i parë për t'u përshëndetur drejt një konsensusi gjithëpërfshirës në kushtet kur vet përbërja e Kuvendit të Shqipërisë nuk përfaqësonte realisht vullnetin e një pjese të popullit dhe vullnetin e forcave kryesore opozitare në vend, të cilat ishin larguar nga Kuvendi që prej muajit shkurt 2019.

Ky proces u mbështet dhe u përshëndet nga gjithë aktorët vendas dhe ndërkombëtarë të Bashkimit Europian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

2. Edhe pas konstituimit të **Këshillit Politik** është evidentuar qartë se mazhoranca/Kryeministri vijoi të provokojë opozitën me veprime të cilat në thelb kishin për qëllim të nxisnin opozitën për të mos marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Politik, duke synuar kështu një argument për ta bërë opozitën përgjegjëse për mosrealizimin e reformës zgjedhore në sytë e opinionit vendas dhe të partnerëve ndërkombëtarë.

3. Një fakt shumë domethënës është vendimmarrja e Kryeministrit për shembjen e Godinave të Teatrit Kombëtar vetëm pak ditë pas rifillimit të vepimtarisë së Këshillit Politik pas përfundimit të periudhës së ndalimit të aktiviteteve publike dhe lëvizjes për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia. Përmes një vendimi të Këshillit të Ministrave të papajtueshëm me Kushtetutën, qeveria shprehu vullnetin se, me kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të "Teatrit Kombëtar", kjo Bashki duhet të vijonte procedurat për shembjen e godinave të Teatrit dhe ndërtimin e godinave të reja.

Duke evidentuar antikushtetutshmërinë e këtij vendimi dhe në vijim të një kërkesë të mëparshme të paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, Presidenti i Republikës në datë 14 maj 2020 **depozitoi në Gjykatën Kushtetuese** kërkesën tjetër (kërkesë e dytë) për shfuqizimin e Vendimit nr. 377, datë 8.5.2020, të Këshillit të Ministrave "*Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të pasurisë nr.1/241, me emërtimin "Teatri Kombëtar", në zonën kadastrale 8150, Tiranë*", si të papajtueshëm me

Kushtetutën, duke kërkuar si në rrugë zyrtare ashtu dhe publikisht, ndërprerjen dhe pezullimin e çdo veprimi të autoriteteve në këtë drejtim.

Por përkundrajt thirrjeve të shoqërisë civile, aktorëve, opozitës, Presidentit të Republikës, dhe përfaqësuesve të lartë në Bashkimin Evropian, përgjatë periudhës që vendi ndodhej nën efektin e zbatimit të masave të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, qeveria dhe Bashkia Tiranë, në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin, pa asnjë shkak të ligjshëm, pa asnjë motiv të justifikuar si juridik ashtu dhe teknik, **në datën 17 maj 2020**, në orët e para të mëngjesit, ndërhyne me forca të shumta policore dhe shembën godinat e Teatrit Kombëtar.

Përmes këtij akti, shqiptarët humbën një pasuri publike me interes të lartë kombëtar. Me prishjen e tij, trashëgimia kulturore, identiteti kombëtar që mishërohej në ato godina, dhe memorja jonë e përbashkët kolektive, u dëmtuan rëndë.

Ky akt i paprecedentë i qeverisë në dëm të interesave publike dhe kombëtare, jo vetëm që vendosi në rrezik jetën dhe shëndetin e artistëve, shoqërisë civile, gazetarëve e forcave policore për shkak të nxitjes drejt një përballjeje fizike dhe riskut të përhapjes edhe më shumë të sëmundjes infektive për shkak të virusit Covid-19, **por ishte një tjetër akt që synonte brenda vetes nxitjen e opozitës për të mos marrë pjesë në tryezën e Këshillit Politik, pasi mbrojtja me çdo kusht e Teatrit Kombëtar ishte bërë tashmë edhe një nga tezat politike të opozitës jashtëparlamentare.**

**Edhe data 17 maj 2020**, e zgjedhur nga Kryeministri për të ndërhyrë për prishjen e godinave të Teatrit Kombëtar ishte një mesazh politik për opozitën e cila 3-vjet më parë (2017), përmes liderit të Partisë Demokratike, në po të njëjtën datë kishte arritur një marrëveshje politike për hyrjen në procesin zgjedhor të zhvilluar në qershor 2017.

**4.** Përpos shumë veprimeve provokuese të mazhorancës, opozita tregoi maturi dhe vijoi me prezencën e saj aktive në Këshillin Politik. Si rezultat i kontributit të palëve në datë **5 Qershor 2020, Këshilli Politik**, dakordësoi një marrëveshje në frymën e bashkëpunimit dhe kontributit të përbashkët e gjithëpërfshirës të të gjitha forcave politike në ecurinë e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

**5.** Për arritjen e kësaj marrëveshjeje gjatë procesit të negocimit dhe diskutimeve maratonë midis palëve në Këshillin Politik, u investua drejtpërdrejt edhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës<sup>16</sup> në Tiranë, Kreu i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, dhe përfaqësues të lartë

---

<sup>16</sup> Deklaratën e Ambasadës Amerikane, **31 maj 2020**, mund ta konsultoni dhe në link-un:

<https://www.facebook.com/usembassytirana/posts/10157423302025838>

Deklaratën e Ambasadorit të SHBA në Tiranë, **3 qershor 2020**, mund ta konsultoni dhe në link-un:

<https://www.syri.net/politike/344547/yuri-kim-topi-eshte-ne-fushen-e-bashes-mazhoranca-ka-leshuar/>

Në deklaratë thuhet: “*Ne kemi atë që mund të jetë një marrëveshje shumë e mirë. Është një marrëveshje e cila do ta vendosi Shqipërisë në mënyrë të patundur drejt anëtarësimit të saj në vend. Përmban masa që janë adresuar nga ODIHR.*”

të Bashkimit Europian. U arrit deri aty sa dhe vet kjo marrëveshje u hartua dhe nënshkrua në gjuhën angleze dhe palët u mblodhën nga Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë në disa takime radhazi në rezidencën e Ambasadës Amerikane në Tiranë.

**6. Në 5 qershor 2020** midis përfaqësuesve të palëve politike në Këshillin Politik u arrit një Marrëveshje e cila si rrallë ndonjëherë u përshëndet njëzëri nga **Sekretari Amerikan i Shtetit, zoti Mike Pompeo**<sup>17</sup>, përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Europian, z. Joseph Borrel, dhe Komisioneri për Zgjerimin, z. Oliver Varhelyi. Gjithashtu, Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, në një deklaratë për shtyp në datën 5 qershor 2020, citon shprehimisht<sup>18</sup>:

*“Mirëpresim marrëveshjen ndërpartiake për reformën zgjedhore në Shqipëri, e cila forcon garancitë për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe e çon Shqipërinë përpara në rrugën e saj evropiane. Kjo marrëveshje është rezultat i orëve të gjata, diskutimeve të ndezura, si dhe vendimeve të vështira nga anëtarët e Këshillit Politik Oerd Bylykbashi, Damian Gjijnuri, Rudina Hajdari dhe Petrit Vasili. Të gjitha palëve iu desh të bënin lëshime në mënyrë që populli shqiptar të mund të përfitojë garanci të reja, të tilla si identifikimi elektronik i votuesve, i cili mbron integritetin e kutisë së votimit. Marrëveshja po ashtu ndërmerr hapa për të depolitizuar administrimin zgjedhor në Shqipëri, duke siguruar më shumë transparencë dhe pavarësi më të madhe të personelit të zgjedhjeve. Disa masa depolitizimi do të hyjnë në fuqi menjëherë, ndërsa disa masa shtesë do të hyjnë në fuqi menjëherë më pas. Së fundi, kjo marrëveshje duhet t’iu japë shqiptarëve më shumë besim në mbikqyrjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përfshirjes së gjyqtarëve që kanë kaluar vetingun. Kjo piketë e rëndësishme u arrit sepse udhëheqësit e Shqipërisë lanë mënjanë mosmarrëveshjet dhe punuan për të prodhuar një rezultat të prekshëm për popullin shqiptar. Përgëzojmë Kryeministrin Rama dhe Kryetarin e Partisë Demokratike Basha për udhëheqësinë e tyre. Shprehim vlerësim për zërin e rëndësishëm të Presidentit Meta, i cili i nxiti të gjitha palët që të arrinin konsensus. Udhëheqësia e tyre, përkrah asaj të Kryetarit të Kuvendit Ruçi, do të jenë me rëndësi teksa reforma e dakordësuar miratohet nga Kuvendi dhe vihet në zbatim. Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë t’i mbështesin fort këto përpjekje. Do të vazhdojmë ta mbështesim fort aspiratën e Shqipërisë për të qenë anëtare e plotë e familjes evropiane”.*

---

Përmban gjithashtu disa hapa domethënëse të cilat nuk janë rekomanduar nga ODIHR por gjithashtu do të shiheshin si një hap i rëndësishëm përpara për Shqipërisë. **Ka ardhur koha për opozitën, për Partinë Demokratike, për mikun tim Luli Basha, që të barazpeshojë të gjithë faktorët dhe të thotë ‘Po’ për popullin shqiptar dhe të thonë ‘Po’ për Shqipërinë në Europë. Topi është në fushën e tij, e ardhmja është në fushën e tij. Faleminderit”.**

<sup>17</sup> Deklarata e Sekretarit të Shtetit Mike Pompeo, të cilën mund ta konsultoni dhe në link-un:

<https://www.youtube.com/watch?v=LY9eLjU3d8>

*“Mirëpres marrëveshjen ndër-partiake në Shqipëri për Reformën Zgjedhore, e cila do të forcojë demokracinë e saj dhe do të forcojë më tej të ardhmen evropiane të Shqipërisë. Ne inkurajojmë të gjithë palët e interesuara të kodifikojnë këtë marrëveshje politike”.*

<sup>18</sup> Mund ta konsultoni në link-un: <https://www.facebook.com/usembassytirana/posts/10157436399205838>

7. Përmbyllja e Reformës Zgjedhore me konsensus dhe gjithëpërfshirje, do të mund të konsiderohej nga Bashkimi European si një kusht i përmbushur nga Shqipëria.

8. Një draft konsensual që kodifikonte ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor u dakordësua nga Këshilli Politik në **30 qershor 2020**. Kjo marrëveshje e kodifikuar kaloi përmes procedurës parlamentare në Kuvendin e Shqipërisë **pa asnjë ndryshim**, i cili në datën **23 korrik 2020**, miratoi ligjin nr.101/2020 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar*”.

Miratimi i këtyre ndryshimeve në Kodin Zgjedhor u përshendet nga të gjitha palët politike në vend, pjesëmarrëse në Këshillin Politik dhe nga gjithë faktori ndërkombëtar prezent në Tiranë, apo përfaqësues të Bashkimit European.

9. Këto ndryshime në Kodin Zgjedhor, u përshëndetën dhe nga Presidenti i Republikës, i cili përmes **Dekretit nr. 11573, datë 31.07.2020**, i shpalli menjëherë këto ndryshime ligjore, të cilat më pas u publikuan në Fletoren Zyrtare nr. 143, datë 4.08.2020<sup>19</sup>, duke bërë që ndryshimet e miratuara me konsensus **të hynin në fuqi në datën 19 gusht 2020**.

\* \* \* \* \*

---

<sup>19</sup> Link-u ku gjendet version elektronik i kësaj Fletoreje Zyrtare:  
<https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/143/82f816ff-4638-446d-b3f6-c1125ecec32f>

## VII. Veprimet e Kryeministrit për prishjen e marrëveshjes së 5 qershorit

1. Edhe pas arritjes së Marrëveshjes në datën 5 qershor 2020, e mbi të gjitha kur ndërkohë vijonte puna e pandërprerë në Këshillin Politik për formalizimin dhe kodifikimin e saj në dispozita konkrete që do të përkonin me ndryshime në Kodin Zgjedhor, Kryeministri, vijoi të provokonte opozitën jashtëparlamentare duke nxitur në publik teza diskutimi nga më të ndryshmet për ndryshimin e sistemit zgjedhor, mënyrës së garimit, etj. Përmes deklaratave publike, në datë 18 qershor 2020, nga foltorja e Kuvendit, ai paralajmëroi prishjen e marrëveshjes, duke u shprehur se: “[...] **Por një fije peri e ndan realizimin deri në fund të asaj marrëveshjeje nga grisja e asaj marrëveshjeje. Prandaj këtë fije peri duhet ta ruajë mirë [...]**”<sup>20</sup>. Ky komunikim perceptohej si një sulm ndaj opozitës dhe aktorëve të tjerë të jetës publike në vend, **se ata ishin kundër listave të hapura në një garë konkurrimi politik, një tezë kjo e kërkuar nga shumë aktorë të shoqërisë civile**<sup>21</sup>.

2. Nga njëra anë, Kryeministri sulmonte bllokun e kampit opozitar jashtëparlamentar se nuk donte lista të hapura, nga ana tjetër, punonte në mënyrë të fshehur me ata deputetë që pretendonin se përfaqësonin grupin opozitar në Kuvend, duke i premtuar se nëse ata do të paraqisnin propozim për listat e hapura, Kryeministri do ta mbështeste propozimin e tyre në këmbim të mbështetjes për të dakordësuar dispozita që përjashtonin koalicionet parazgjedhore.

**Ky fakt u pohua publikisht nga deputeti Myslym Murrizi**<sup>22</sup>, i cili ishte dhe deputet propozues i ndryshimeve kushtetuese, kur në një emision televiziv pranoi se, heqja e koalicioneve parazgjedhore nuk ishte kërkesë e grupit që ai përfaqësonte, duke evidentuar kështu se ky ishte vullneti i Kryeministrit Rama.

3. Kjo u provua tërësisht kur Kryeministri, 10 ditë pasi ishte dakordësuar një marrëveshje në Këshillin Politik, në datë 15 qershor 2020, **pa konsensusin e Këshillit Politik**, duke përdorur vullnetin e deputetëve të rinj që kishin përfutur mandate nga dorëheqja e deputetëve të opozitës, **hodhi hapat e parë konkretë të prishjes së dakordësisë politike të arritur në 5 qershor 2020.**

<sup>20</sup> Shiko faqen 20-21, të Procesverbalit të Seancës Plenare të datës 18.06.2020. Për më shumë, konsultoni link-un: <https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20200626093446Proc.%20dt%2018.06.2020.pdf>

<sup>21</sup> Shiko faqen 20-21, të Procesverbalit të Seancës Plenare të datës 18.06.2020, ku është shprehur se: “Ndërkohë që, dua apo nuk dua unë personalisht, është fakt që shumica dërrmuese e shqiptarëve nuk e pëlqejnë atë marrëveshje dhe nuk i duan listat e mbyllura.”

Për më shumë, konsultoni link-un:

<https://www.parlament.al/Files/Procesverbale/20200626093446Proc.%20dt%2018.06.2020.pdf>

<sup>22</sup> <https://www.syri.net/politike/354701/video-myrri-ramen-zbuluar-ishte-ai-qe-kerkoi-heqjen-e-koalicioneve/>  
<https://lapsi.al/2020/07/15/edi-paloka-nxjerr-videon-myslym-murrizi-e-pranon-hapur-qe-kerkesa-per-heqjen-e-koalicioneve-ishte-e-edi-rames-video/>

4. Konkretisht, në datën 15 qershor 2020, një grup deputetësh të opozitës së re parlamentare paraqesin në Kuvend një propozim për ndryshimin e neneve 64 dhe 68 të Kushtetutës. Ky projektligj përbëhej nga 2 nene, ku në nenin 2, parashikohej se: *“Nuk lejohen koalicionet parazgjedhore”*. Përmes këtij propozimi, Kryeministri, përmes opozitës parlamentare, kishte mundur të fuste në procedurë parlamentare një projekt ndryshimi të Kushtetutës, nën ombrellën e tezës publike se propozimi vinte për të siguruar hapjen e listave të kandidatëve, ndërkohë që në realitet ai po përmbushte qëllimin politik të ndalimit të koalicioneve parazgjedhore. Ky qëllim ishte i qartë dhe i pafshehur edhe në praktikën parlamentare të shqyrtimit të nismës.

5. **Iniciativa për ndryshimin e Kushtetutës ishte në vetvete një procedurë antikushtetuese.** Procedura parlamentare e nismës për rishikimin e Kushtetutës u ndërмор në kundërshtim me nenin 170, pika 5, dhe 177, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe si e tillë ajo nuk duhej të ishte marrë për shqyrtim nga Kuvendi i Shqipërisë.

6. Nisma për rishikimin e Kushtetutës u propozua në Kuvend nga një grup deputetësh të opozitës të cilët jo vetëm që përfaqësoheshin dhe në Këshillin Politik që kishte nënshkruar një marrëveshje në 5 qershor 2020, por që shumica e tyre ka hyrë në sallën e Kuvendit dhe ka përfituar mandatin e deputetit në kundërshtim me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe Rregulloren e Kuvendit. Propozimi i tyre në Kuvend është paraqitur me shkresën me nr. 1561 prot., në datë 15.06.2020. Pikërisht në këtë datë, **15 qershor 2020**, Shqipëria ishte ligjërisht nën gjendjen e fatkeqësisë natyrore të shpallur nga vet Kuvendi i Shqipërisë me **Vendimin nr. 18/2020**, gjendje kjo e cila përfundonte sipas këtij vendimi më datë **23 qershor 2020**.

7. Në këto kushte, **“ndërmarrja e nismës”** së këtyre deputetëve për të rishikuar Kushtetutën, e frymëzuar nga Kryeministri Rama, ka lindur, formësuar dhe zhvilluar pikërisht brenda periudhës ku vendi i nënshtrohej zbatimit të masave të jashtëzakonshme.

8. Neni 177, pikat 2, e Kushtetutës, thotë:

*“[...] 2. Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme”.*

**Pra ndërmarrja e kësaj nisme**, nuk mund dhe nuk duhej të realizohej në momentin kur në vend ishin në fuqi masat kufizuese të jashtëzakonshme, si rezultat i gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

9. Ndryshimet që iu bënë në mënyrë të njëanshme Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në datë 30 korrik 2020, jo vetëm u depozituan dhe u shqyrtuan në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës, por edhe për nga përmbajtja, këto ndryshime bien ndesh brenda të njëjtës normë të ndryshuar apo me dispozita të tjera të tekstit kushtetues.

**10.** Megjithatë mazhoranca, në përmbushje të qëllimeve politike dhe pa dakordësi të Këshillit Politik, vijoi diskutimin e kësaj nisme për ndryshimin e Kushtetutës dhe **në datën 30 korrik 2020**, (7-ditë pas miratimit me konsensus të kodifikimit të marrëveshjes së 5-qershorit), pa dakordësinë e forcave politike pjesëmarrëse në Këshillin Politik, që sot nuk është prezent në parlament, miratoi në mënyrë të njëanshme ligjin **nr. 115/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, me këtë përmbajtje:**

#### **“Neni 1**

*Neni 64 ndryshohet si më poshtë:*

#### **“Neni 64**

- 1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhesh proporcional me konkurrin rajonal dhe prag kombëtar.*
- 2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar.*
- 3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor”.*

#### **Neni 2**

*Pika 1 e nenit 68 ndryshohet si më poshtë:*

**“1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.”.**

#### **Neni 3**

#### **Hyrja në fuqi**

*Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.”*

**11.** Për efekt krahasimor, ndryshimet kushtetuese pasqyrohen më poshtë:

**Neni 64 i Kushtetutës ISHTE:**

#### **Neni 64**

*(Ndryshuar me ligjin nr.9904, datë 21.4.2008)*

- 1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur me sistem proporcional me zona zgjedhore shumemërore.*

2. Zona zgjedhore shumemërore përputhet me ndarjen administrative të një prej niveleve të organizimit administrativo-territorial.
3. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor proporcional, për caktimin e zonave zgjedhore dhe për numrin e mandateve për secilën zonë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

**Neni 64 i Kushtetutës BËHET:**

Neni 64

(Ndryshuar me ligjin nr.118/2020, datë 5.10.2020)

1. Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë, të zgjedhur sipas një sistemi zgjedhesh proporcional me konkurrim rajonal dhe prag kombëtar.
2. Në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragun kombëtar.
3. Zgjedhësit gëzojnë të drejtën për të dhënë votë parapëlqyese për kandidatët e listave shumemërore. Kriteret dhe rregullat për zbatimin e sistemit zgjedhor, për caktimin e zonave zgjedhore, pragun kombëtar, numrin e mandateve për secilën zonë, shpërndarjen e mandateve dhe masën e shtrirjes së votimit parapëlqyes përcaktohen në ligjin për zgjedhjet. Ligji për zgjedhjet garanton që votimit parapëlqyes t'i nënshtrohen jo më pak se dy të tretat e listës shumemërore dhe të sigurojë përfaqësim gjinor.

**Pika 1, e nenit 68 të Kushtetutës ISHTE:**

Neni 68

(Ndryshuar me ligjin nr.9904, datë 21.4.2008)

1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike, koalicionet zgjedhore të partive politike, si dhe nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Renditja e kandidatëve për deputetë në listat shumemërore nuk mund të ndryshohet pas paraqitjes së listës në komisionin zgjedhor përkatës. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

**Pika 1, e nenit 68 të Kushtetutës BËHET:**

Neni 68

(Ndryshuar me ligjin 118/2020, datë 5.10.2020)

1. Kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit. Një kandidat mund të paraqitet vetëm për një nga subjektet propozuese, sipas kësaj pike. Rregullat për regjistrimin e kandidatëve për deputetë përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

12. Nga kuptimi i dispozitave të neneve 64, 68 pika 1 të Kushtetutës, ishte krejtësisht e qartë se mazhoranca përmes ndryshimeve kushtetuese po krijonte hapësirën të shkonte drejt një detajimi



rregullash në Kodin Zgjedhor ku për fitimin e mandatit të deputetit konkurrimi kryhet në baza rajonale, ndërsa pragu elektoral do të **përllogaritej në rang kombëtar, ndërkohë që synohej qartë heqja e së drejtës së partive pjesëmarrëse në koalicione parazgjedhore të propozonin kandidatët për deputetë në listat e tyre.**

**13.** Gjithashtu, ishte e kuptueshme që një prag i ri elektoral do të vendosej në Kodin Zgjedhor dhe se listat e kandidatëve nuk do të ishin krejtësisht të hapura, ndërkohë që duke i bërë publicitet mediatik listave të hapura (vota parapëlqyese), po synohej haptazi që përmes ndryshimeve në nenin 68 të Kushtetutës, të realizohej vullneti i Partisë Socialiste për përjashtimin e koalicioneve parazgjedhore.

Qartësisht i gjithë ky angazhim po realizohej nga mazhoranca socialiste me qëllim dobësimin e peshës së votës që do të mund të marrin forcat politike të rreshtuara në opozitë me mazhorancën (PS) apo zhvleftësimin krejtësisht të tyre për shkak të pragut zgjedhor, për forcimin e pozitës garuese të kësaj të fundit në zgjedhje. Ndërhyrjet synonin qartazi të ndryshoheshin rregullat që përcaktojnë mënyrën e mbledhjes së votave nga subjektet zgjedhore dhe transformimin e tyre në mandate, pra e thënë thjeshtë, të ndikonte rezultatin e zgjedhjeve.

**14.** Këto ndryshime të njëanshme në Kushtetutë pa konsensusin e Këshillit Politik ishin të **papranueshme për Presidentin e Republikës.** Nën kontekstin aktual në të cilin ndodhej/et vendi, ku mungon përfaqësimi real e dinjitoz i qytetarëve shqiptarë në institucionet përfaqësuese, si në nivel qendror dhe vendor, **dakordësia unanime e palëve në Këshillin Politik për reforma të rëndësishme ligjore, ishte dhe mbetet thelbësore.**

Ligji nr. 115/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, u përcoll për shpallje pranë Presidentit të Republikës në datën 30 korrik 2020. Duke mos qenë dakord me këto ndryshime kushtetuese dhe referuar nenit 177, paragrafi 6<sup>23</sup>, të Kushtetutës, Presidenti i Republikës nuk u shpreh me dekret mbi to.

---

<sup>23</sup> **Neni 177**

1. Nisma për rishikimin e Kushtetutës mund të ndërmerret nga jo më pak se një e pesta e anëtarëve të Kuvendit.
2. Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme.
3. Projekti miratohet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
4. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projektamendamentet kushtetuese të votohen me referendum. Projektligji për 59 rishikimin e Kushtetutës hyn në fuqi pas ratifikimit me referendum, i cili bëhet jo më vonë se 60 ditë nga miratimi i tij në Kuvend.
5. **Amendamenti kushtetues i miratuar i nënshtrohet referendumit, kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.**
6. **Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin e Kushtetutës.**
7. Ligji i miratuar në referendum shpallet nga Presidenti i Republikës dhe hyn në fuqi në datën e parashikuar në këtë ligj.
8. Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se të ketë kaluar një vit nga dita e rrëzimit të projektligjit në Kuvend dhe jo më përpara se të kenë kaluar 3 vjet nga dita e rrëzimit të tij në referendum.

Në këtë mënyrë, këto ndryshime Kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 115/2020, u botuan në Fletoren Zyrtare nr. 153, datë 24.08.2020<sup>24</sup> dhe kanë hyrë në fuqi më datë **8 shtator 2020**.

**Ndërkohë që 2 ditë para hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11700, datë 6.09.2020 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”, caktoi datën e zgjedhjeve për Kuvendin, në 25 prill 2021, ditë e dielë.**

Eshtë për t'u ritheskuar se, vetë marrëveshja e 14 janarit 2020 përmbante parashikimin specifik:

*“-Palët e përfshira angazhohen të adresojnë me konsensus të gjitha çështjet e administrimit të zgjedhjeve objekt i punës së Komisionit të Reformës Zgjedhore, përfshirë rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe për çështjet të cilat nuk gjendet dakordësi do të kërkohet mendim dhe asistencë nga ekspertiza ndërkombëtare e OSBE/ODIHR me qëllim gjetjen e një zgjidhje të pranueshme.*

*- Për të ndihmuar në këtë proces Komisioni i Reformës Zgjedhore do të kërkojë zyrtarisht asistencën e OSBE/ODIHR, përfshirë dhe dërgimin e ekspertëve nëse kjo është e mundur, që do të bashkëpunojnë me përfaqësuesit politikë dhe ekspertet e përcaktuar në paragrafin e parë të kësaj pike, me qëllim për të lehtësuar procesin e diskutimit dhe hartimit të projekt-propozimeve përkatëse”.*

Pra, vetë marrëveshja e Janarit 2020, që u vlerësua dhe u përshëndet nga të gjithë aktorët vendas dhe partnerët ndërkombëtarë si një instrument politik për të zhbllokuar ngërçin me reformën zgjedhore e për të kapërcyer në emër të interesit kombëtar për integrimin europian, situatën faktike të mungesës së legjitimitetit të plotë të Parlamentit, e që do të shërbente si platformë për neutralizimin e debatit politik, parashikonte ndër të tjera dhe marrjen e mendimit dhe asistencës së vazhduar nga OSBE/ODIHR.

Nga informacioni i bërë publik në median e shkruar, elektronike dhe audiovizive, Opozita e Bashkuar në vijmësi prezantoi në Këshillin Politik kërkesën për t'iu drejtuar OSBE/ODIHR<sup>25</sup>, në lidhje me çështjet që nuk kishin dakordësi. Gjë e cila u refuzua në mënyrë permanente nga përfaqësuesi i mazhorancës në Këshillin Politik.

Në datën 22 shtator 2020, opozita jashtëparlamentare prezantoi në Këshillin Politik një draft kërkesë për t'iu përcjellë OSBE/ODIHR, shoqëruar me pyetjet kryesore që kërkonin një mendim ekspertize.

<sup>24</sup> <https://qbz.gov.al/eli/fz/2020/153/67ec863a-085a-4ded-af3a-a9c36ffe2508>

<sup>25</sup> <https://euronews.al/al/politike/2020/09/18/opozita-ne-keshillin-politik-dorezon-kerkesen-per-te-marre-ekspertizen-e-osbe-odihr-per-ceshtjet-e-pazgjidhura>  
<https://a2news.com/2020/09/14/ngerci-per-koalicionet-opozita-kerkon-mendimin-e-osbe-odihr-ps-nuk-e-mirepret/>  
<https://tvklan.al/mosdakordesite-ne-keshill-opozita-propozon-te-merret-mendimi-i-osbe-odihr/>  
<https://abcnews.al/bylykbashi-opozita-propozoi-te-merret-mendimi-i-osbe-odihr-per-koalicionet-ps-kunder/>

Përfaqësuesi i PS-së në Këshillin Politik, refuzoi<sup>26</sup> angazhimin e ODBE/ODIHR për kërkesat e opozitës.

Në datën 27 shtator 2020, opozita dorëzoi për diskutim në Këshillin Politik një draft me ndryshime që ruante modelin e koalicioneve parazgjedhore siç ishin miratuar në vitin 2003 dhe që ishin rikonfirmuar me dakordësinë e dhënë në marrëveshjen e 23 korrikut 2020 (miratuar me ligjin nr. 101/2020).

Me dorëzimin e këtij drafti për diskutim në Këshillin Politik, opozita propozoi, madje kërkoi që të dyja draftet të përcilleshin për një mendim pranë OSBE/ODIHR, mbi përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare. Ndërkohë që, po sipas këtyre informacioneve dhe deklaratave të bëra publike në media, mazhoranca refuzoi<sup>27</sup> të dërgojë kërkesën për të marrë mendimin e OSBE/ODIHR, përmes Këshillit Politik.

Në këtë mënyrë, pa arritur në një dakordësi, mazhoranca vijoi me miratimin në mënyrë të njëanshme në Kuvend të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në datën 5 tetor 2020.

**Referuar sa më sipër, këto ndryshime të Kushtetutës dhe çdo ndryshim tjetër në vijim të tyre i Kodit Zgjedhor në 5 tetor 2020, i bërë në mënyrë të njëanshme dhe pa konsensus gjithëpërfshirës, pasi Presidenti i Republikës kishte caktuar datën e zgjedhjeve, përbën një ndryshim të rregullave të konkurrimit zgjedhor që cenon çdo parim demokratik mbi zhvillimin e proceseve zgjedhore.**

\* \* \* \* \*

---

<sup>26</sup> <https://exit.al/gjikhuri-e-guan-leter-politike-kerkesen-e-opozites-per-opinion-nga-osbe-ja/>

<sup>27</sup> <https://www.zeriamerikes.com/a/5604915.html>

## VIII. Caktimi i datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë dhe rregullat zgjedhore të aplikueshme

Presidenti i Republikës, pasi kishin hyrë në fuqi ndryshimet në Kodin Zgjedhor të miratuara në 23 Korrik 2020 që kishin kodifikuar marrëveshjen gjithëpërfshirëse të 5 qershorit, realizoi një proces konsultimi me palët politike me qëllim caktimin e datës së zgjedhjeve. Presidenti priti në takim Kryeministrin dhe Kryetarin e Partisë Socialiste, liderin e opozitës, si dhe drejtues të partive të tjera parlamentare opozitare të dala nga zgjedhjet e vitit 2017.

Pas konsultimit me palët, Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 11700, datë 06 shtator 2020, në mbështetje të nenit 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 8, 9, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, **dekretoi datën e zgjedhjeve për Kuvendin duke caktuar se ato do të zhvillohen ditën e diel, më datë 25 prill 2021.**

**Në datën 6 shtator 2020, moment ky kur Presidenti i Republikës miratoi këtë dekret, ende nuk kishin hyrë në fuqi as ndryshimet e njëanshme kushtetuese dhe as ishte miratuar ndonjë ndryshim tjetër në Kodin Zgjedhor.**

**Në këtë mënyrë, në momentin e caktimit të datës së zgjedhjeve, rregullat zgjedhore në fuqi mbi të cilat palët kishin rënë dakord dhe do të duhet të garojnë në zgjedhjet e 25 prillit 2021, ishin ndryshimet e Kodit Zgjedhor të datës 23 korrik 2020, të dakordësuara unanimit në Këshillin Politik dhe të kodifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.**

Referuar praktikave të mira dhe rekomandimeve të miratuara ndër vite nga OSBE/ODIHR, Komisioni i Venecias, etj., (të cilat do të citohen në vijim), çdo ndryshim tjetër që do të pasonte mbi këto rregulla si në Kushtetutë apo dhe në Kodin Zgjedhor, **minimalisht nuk duhet të përdoret për zgjedhjet tashmë të caktuara për t'u mbajtur në datën 25 prill 2021. Në të kundërt kjo duhet të kishte dakordësinë e të gjithë palëve të përfaqësuara në Këshillin Politik.**

Duke vërejtur sjelljen permanente të mazhorancës dhe pikërisht për të shmangur këtë gjendje antikushtetutshmërie dhe një mbivendosje a ndryshim të rregullave për procesin e ardhshëm zgjedhor, Presidenti i Republikës realizoi një proces konsultimi me forcat politike dhe në datë 6 shtator 2020, miratoi dekretin për caktimin e datës 25 prill 2021 si ditë e zhvillimit të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, përpara se të hynin në fuqi ndryshimet e njëanshme Kushtetuese.

Parashikimi i nenit 68 të Kushtetutës, që u ndryshua në mënyrë të njëanshme, duke u mbështetur dhe me justifikimin absurd se ka qënë një ndryshim i bërë në vitin 2008 në nxitim e sipër dhe se koalicionet mund dhe duhet të parashikoheshin vetëm në Kodin Zgjedhor dhe jo në Kushtetutë, **bie poshtë, në raport me parashikimin e nenit 96, pika 1, të Kushtetutës, që nuk është ndryshuar asnjëherë ndër vite dhe që njih qartë organizimin e partive politike në koalicione. Kjo dispozitë kushtetuese parashikon se:**

*“Presidenti i Republikës, në fillim të legjislaturës, si dhe kur vendi i Kryeministrit mbetet vakant, emëron Kryeministrin me propozim të partisë ose koalicionit të partive, që ka shumicën e vendeve në Kuvend.”*

Kushtetuta është ligji themeltar i shtetit dhe nuk mund të trajtohet si dokument pa vlerë, që mund të ndryshohet në mënyrë të njëanshme dhe pa diskutim gjithëpërfshirës, për arritjen e objektivave të ngushta të momentit të një force politike. Një sjellje e tillë e njëanshme, siç e treguan dhe zhvillimet më pas, kanë thelluar konfliktin politik në vend dhe kanë shkatërruar sërish besimin jo vetëm të opozitës, por të të gjithë qytetarëve dhe aktorëve vendas dhe ndërkombëtarë tek Kryeministri dhe forca politike që ai udhëheq.

Me njëanshmërinë e realizimit të këtyre ndryshimeve, tashmë është e qartë dhe të gjithë e kanë kuptuar se qëllimi është, ndër të tjera, dhe nxjerrja nga skena e disa forcave politike si nga e majta apo e djathta, të cilat ndër vite kanë një numër stabil votuesish dhe mbështetësish që përmes koalicioneve parazgjedhore kanë mundur të përfaqësohen në Kuvend, me mandat palamentar.

Me rritjen e pragut elektoral dhe vështirësitë e krijuara me këtë ligj për bashkim në koalicione parazgjedhore me listë unike konkurrimi, kryetarët e këtyre partive tashmë do të jenë të detyruar që të negociojnë me forcat kryesore politike për të përfshirë kandidatët e tyre brenda listës së një subjekti zgjedhor, duke sjellë kështu rrezikun e asfikisimit të këtyre forcave politike dhe nivelit të përfaqësimit të tyre në Kuvend, pavarësisht votave që ata mund të marrin në nivel rajonal.

**Këto ndryshime do të fshehin partitë politike pas siglës së një koalicioni dhe do t'i pamundësojnë zgjedhësve të zgjedhin partinë e koalicionit që duan si dhe të jenë zgjedhësit ata që përcaktojnë drejtpërdrejtë, me votë, fuqinë elektorale të secilës parti. Pasoja e këtij ndryshimi do të jetë reduktimi i pluralizmit politik parlamentar.**

Nëse këto ndryshime do të ishin të konsultuara dhe dakordësuara nga forcat politike në Shqipëri, apo do t'i nënshtroheshin vullnetit të sovranit përmes referendumit, mund të ishin të pranueshme. **Por në kushtet kur Kryetari i Partisë Socialiste përmes forcës dhe keqpërdorimit të veprimtarisë së Kuvendit përpiqet të vendosë se kush forcë politike duhet të ekzistojë e kush jo, kjo është antidemokratike dhe shenjë e qartë se vendi po rrëshket në autoritarizëm.**

Në një sistem demokratik, nëse një prej kryetarëve të forcave politike gëzon një pozitë momentale të pamërituar që mund të vendosë përmes ndryshimeve kushtetuese a ligjore për ekzistencën ose jo të forcave të tjera politike, atëherë praktikisht demokracia përfaqësuese nuk funksionon, dhe vendi *de facto* po i nënshtrohet një sistemi autoritar.

Këto situata që përkojnë me ndryshime kushtetuese e ligjore të njëanshme, pa konsensus dhe me efekte negative për forca të ndryshme politike, janë në kundërshtim jo vetëm me parimet e të drejtat themelore kushtetuese, por njëkohësisht dhe me parimet e standardet e vendosura nga Komisioni i Venecias të parashikuara në *Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore*<sup>28</sup>.

Ky dokument që është dhe udhërrëfyes për vendet e Këshillit të Europës për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, në përmbledhje **përcakton se,**

- **rregullat thelbësore zgjedhore duhet të nisin të paktën 1 vit para periudhës zgjedhore dhe nuk duhet të ndryshohen gjatë periudhës menjëherë para zgjedhjeve, nëse nuk është absolutisht e nevojshme për ta bërë këtë dhe nëse nuk ekziston një konsensus i fuqishëm/gjithëpërsfshirës në mbështetje të tyre.**

Dekreti i Presidentit të Republikës, i datës 6 shtator 2020, i nxjerrë mbështetur edhe në parashikimet e Kodit Zgjedhor të sapo hyra në fuqi (19 gusht 2020, pas miratimit me dakordësin e Këshillit Politik), bëri që të nisë zyrtarisht nga kjo datë (6 shtator 2020) procesi elektoral (parazgjedhor).

Nga dita e nxjerrjes së këtij Dekreti për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, ishin të zbatueshme rregullat në fuqi për regjistrimin e votuesve dhe të subjekteve zgjedhore (partitë politike, koalicionet dhe/apo kandidatët e pavarur), sipas marrëveshjes së 5 qershorit, kodifikuar në 23 korrik 2020.

Partitë mund të vijonin procedurat e regjistrimit në KQZ dhe të regjistronin madje dhe koalicionet mbështetur në modelin që njih Kodi Zgjedhor në fuqi, konfirmuar me ndryshimet e bëra në të në datën 23 korrik 2020.

**Ndaj çdo ndryshim i mëpasshëm përbën një cenim direkt të parimit të sigurisë juridike, për një proces që ka nisur tashmë mbi bazën e disa rregullave të mirëpërcaktuara.**

\* \* \* \* \*

---

<sup>28</sup> Shiko Kapitullin XI të këtij arsyetimi.

**IX. Ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor shkelin Marrëveshjen Politike të arritur. Këshilli Politik dhe rëndësia e dakordësisë që mori emrin “Marrëveshja e 5 Qershorit për Reformën Zgjedhore”.**

Në marrëveshjen e 14 Janarit ku u formalizua formimi i Këshillit Politik me përfaqësues të opozitës, drejtues të komisionit të Reformës Zgjedhore dhe përfaqësues të Grupeve Parlamentare, Këshilli Politik vijoi punën dhe si rezultat i konsensusit të arritur në datë 5 qershor 2020, me ligjin nr. 101/2020, në datën 23 korrik 2020, u miratuan ndryshimet në Kodin Zgjedhor, duke kodifikuar produktin e marrëveshjes politike.

Mazhoranca vijoi në drejtim të arritjes së qëllimit të saj politik dhe në datën 5 tetor 2020, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin **nr. 118/2020** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

**Përmes këtij ligji, veç të tjerash, u ndryshuan dhe disa nene që ishin miratuar në Kuvend në datën 23 korrik 2020, si rezultat i kodifikimit të marrëveshjes politike të 5 qershor 2020.**

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dispozitave të ndryshuara rezulton se, ato janë ndërhyrje themelore në rregullat zgjedhore, ndërkohë që realizohen 1 muaj pasi Presidenti i Republikës ka caktuar datën e zhvillimit të zgjedhjeve dhe kur kanë ngelur më pak se 5-muaj që palët t’i drejtohen fushatës së tyre elektorale duke ndërtuar strategjitë elektorale të konkurrimit. Këto ndryshime të njëanshme dhe të padakordësuara në Këshillin Politik, përmbajnë gjithsej 26 nene.

Nga shqyrtimi i krahasuar i përmbajtjes së dy ligjeve përmes të cilave Kuvendi i Shqipërisë ka ndërhyrë në ligjin zgjedhor, rezulton se, përmes ligjit nr. 118/2020, janë prekur gjithsej 25 nene të Kodit Zgjedhor në fuqi.

Konkretisht, përmes ligjit nr. 118/2020, datë 05 tetor 2020, është ndërhyrë në këto dispozita: Neni 2, 6, 10, 12, 51, 65, 67, 68, 88, 90, 98, 101, 103, 105, 106, 117, 118, 147, 149, 162, 163, 164, 165, 166, 179/1.

Nga studimi i dispozitave të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor midis atyre të miratuara përmes ligjit konsensual **nr. 101/2020, datë 23 korrik 2020** dhe atyre të miratuara në mënyrë të njëanshme përmes ligjit **nr. 118/2020, datë 5 tetor 2020**, rezulton se **janë prekur dhe disa dispozita të rëndësishme të neneve të dakordësuara me marrëveshje.**

Konkretisht, nga nenet e Kodit Zgjedhor të miratuara me ligjin e mëparshëm nr. 101/2020, janë prekur disa nene kryesore që lidhen posaçërisht me dakordësinë e marrëveshjes së arritur në 5 qershor 2020: nenet **12, 67, 88, 90, 149, 163, 164**.

Ndërmarrja e iniciativës për ndryshime të tjera në Kodin Zgjedhor, pas atyre të dakordësuara të datës **23 korrik 2020**, dhe të bëra fakt në mënyrë të njëanshme me votimin e 5 tetorit, **shkelin besimin reciprok midis forcave politike dhe kushteve të dakordësuara në Marrëveshjen e 5 qershorit për Reformën Zgjedhore**.

Në nenin 10 të kësaj marrëveshje palët janë shprehur se:

*“Miratimi*

*Të gjitha propozimet e rëna dakord do të hartohen si ndryshime ligjore që do të shqyrtohen dhe kontrollohen nga Këshilli Politik për të pasqyruar siç duhet **marrëveshjen PARA se të cohen në Parlament, PA bërë asnjë ndryshim dhe pa ndryshime të tjera**. Në rast të ndonjë korrigjimi teknik ligjor të propozuar në tekstin e këtyre ndryshimeve nga organet parlamentare, ato DUHET të aprovohen nga Këshilli Politik PARA votimit.”*

Ky parashikim i qartë reflekton kërkesën e palëve se çdo ndryshim në Kodin Zgjedhor, nuk mund të dërgohej në Kuvend për miratim, pa u vlerësuar propozimi nga Këshilli Politik. Kjo do të thotë që, jo vetëm përsa u ra dakord dhe u kodifikua në Kuvend në 23 korrik përmes ligjit, por edhe për çdo ndryshim tjetër që lidhej apo prekte atë që kishin rënë dakord, nuk mund dhe nuk duhej të kalonte pa marrë sërish miratimin e Këshillit Politik.

Pas Marrëveshjes së 5 qershorit, **dy dispozita kryesore të Kodit Zgjedhor (neni 67, 164) që u hartuan në mënyrë konsensuale në 30 qershor dhe më pas u votuan nga parlamenti në 23 korrik 2020, ishin:**

1) Dispozita që ndryshonte pikën 5 të nenit 67, të Kodit Zgjedhor, me këtë përmbajtje të dakordësuara:

*“5. Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. **Për partitë pjesëtare të koalicionit, që garojnë me lista shumemërore të vecanta**, numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se gjysma e numrit të mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast numri i kandidatëve në listën shumemërore të partisë duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre.*



2) Dispozita që ndryshonte pikën 5, të nenit 164, të Kodit Zgjedhor, me këtë përmbajtje të dakordësuar:

*“5. Në rastin kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike, **anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë**”.*

Këto dy dispozita u miratuan me këtë përmbajtje në **23 korrik 2020**, përmes **ligjit nr. 101/2020**, dhe i referohen specifikisht ruajtjes së rregullave ekzistuese në lidhje me lejin e konkurimit me **koalicionet parazgjedhore ku secila parti pjesëmarrëse në koalicion mund të garantojë me lista të veçanta të kandidatëve të saj dhe shndërrimin e votave të partive pjesëmarrëse në koalicion në mandate.**

Ndërkohë që, me votimin e **5 tetorit 2020** dhe miratimin e ligjit nr. **118/2020** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, të dy këto nene themelore, të miratuara në 23 korrik, që rregullojnë mënyrën se si mund të garohet në koalicionet dhe si përlogaritet vota e partive politike pjesëmarrëse në një koalicion parazgjedhor, **ndryshohen në mënyrë të njëanshme dhe menjëherë kandidimi me lista të veçanta i partive pjesëmarrëse në koalicionet parazgjedhore, ndalohet!!**

**Kjo nuk është gjë tjetër veç një shkelje e drejtpërdrejtë e marrëveshjes së 5 qershorit dhe kodifikimit të saj dhe jo “një masë shtesë” sikundër është artikuluar nga mazhoranca.**

Përmes nenit 7 të ligjit nr. 118/2020, pikat 1-5 të nenit 67, ndryshojnë tërësisht, me këtë përmbajtje:

“Neni 7

Në nenin 67, pikat 1 deri në 5 ndryshohen si më poshtë:

**1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të tij për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.**

*Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.*

**2. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 të këtij neni, lista e subjektit depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme.**

**3. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, ose kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. Bën përjashtim nga ky rregull kryetari i partisë apo i partisë udhëheqëse të koalicionit, i cili në zgjedhjet për Kuvendin mund të regjistrohet deri në**

katër zona zgjedhore. Pas shpërndarjes së mandateve sipas këtij ligji, ai nuk mund të zotërojë më shumë se një mandat, të cilin e zgjedh me vullnetin e tij të lirë.

4. **Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor** paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati.

5. Subjekti zgjedhor nuk mund të ndryshojë renditjen e kandidatëve të listës pas regjistrimit të saj. Kandidatët rirenditen vetëm në zbatim të procedurave të këtij ligji për përlllogaritjen e mandateve fituese në bazë të votimit parapëlqyes dhe të plotësimit të kushtit ligjor për kuotën gjinore.”.

Ndërkohë që, përmes nenit 22 të ligjit nr. 118/2020, të datës 5 tetor, pika 5 e nenit 164, e miratuar në 23 korrik 2020, **shfuqizohet**.

**Në këtë mënyrë, sipas ndryshimeve, marrëveshjet e koalicionit parazgjedhor lejohen, por këto forma bashkëpunimi parazgjedhore pranohen vetëm për konkurrim duke u paraqitur në një listë shumemërore unike të paraqitur nga subjekti zgjedhor (koalicioni).**

**Ndërkohë që sipas marrëveshjes së 5 qershorit, të kodifikuar në 23 korrik 2020, ishte dakordësuar që partitë politike pjesëmarrëse në një koalicion parazgjedhor mund të kishin mundësinë e koalicionit parazgjedhor, por ndërkohë duke ruajtur të drejtën e regjistrimit si subjekt zgjedhor konkurrent më vehte për të kandiduar me listën shumemërore të partisë së tyre.**

Duke e hequr këtë të drejtë të dakordësuar dhe kodifikuar, rezulton tashmë e provuar dhe askush nuk mund ta kundërshtojë se marrëveshja e 5 qershorit 2020, jo vetëm që u shkel, por u hodh poshtë nga Partia Socialiste, duke ndryshuar kështu në mënyrë të njëanshme rregullat themelore të konkurimit politik për zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Rikujtojmë këtu se, **Komisioni i Venecias**, me Opinionin që ka dhënë për Shqipërinë në vitin 2011, përveç nevojës së qëndrueshmërisë së legjislacionit zgjedhor, ka theksuar se:

*“Një proces publik, me përfshirjen e të gjithë aktorëve, është një instrument për të inkurajuar besimin në rezultatin zgjedhor. Të gjitha partitë, si në qeveri ashtu dhe në opozitë, kanë përgjegjësi në këtë drejtim. Për këtë arsye, **procesi i rishikimit të legjislacionit zgjedhor duhet të jetë gjithëpërfshirës. Gjithashtu, duhet të përmbyllet shumë kohë para zgjedhjeve të ardhshme.**”<sup>29</sup>*

<sup>29</sup> Opinion no. 641/2011 (CDL-AD(2011)042), “Joint Opinion on the Electoral Law and the electoral practice of Albania”, paragrafi 136, shprehimisht citon: “136. A public process, with the inclusion of all stakeholders, is

Futja e votimit preferencial me anë të të cilit zgjedhësi duhet të votojë për kandidatin që preferon në një listë shumë-mërore, ka ndryshuar thelbësisht rregullat e garës zgjedhore.

Tashmë çdo kandidat i një liste ka të drejtë të garojë për të mbledhur vota dhe për t'u shpallur fitues. Për këtë, çdo kandidati i duhen siguruar kushte të barabarta garimi, të njëjta me çdo subjekt zgjedhor, në mënyrë të veçantë me kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Kështu, një kandidat i një liste partie apo koalicioni duhet të ketë të drejtë të bëjë fushatë me mjete grafike si postera, etj; duhet të ketë të drejtë për akses në media; të krijojë burime financiare dhe të shpenzojë; e të gjitha këto mbi bazën parimit të barazisë si brenda subjektit ku garon, edhe kundrejt subjekteve konkurruese.

Kandidatit i lind e drejta të ankohet në rast se numërimi, hartimi i rezultatit, përlllogaritja e herësit, apo shpërndarja e mandatit janë të gabuara.

**Kodi Zgjedhor i mohon këtë të drejtë kushtetuese ankimi kandidatëve individualë të listave shumë-mërore të partive në koalicion. Në rast se partia e kandidatit ankues nuk bën ankim në emër të kandidatit, këtij të fundit nuk i sigurohet akses në procedurat e ankimit. Për rrjedhojë, kjo sjell rrezikun e deformimit të rezultatit nëpërmjet mohimit të një të drejte kushtetuese të kandidatëve.**

Kodi Zgjedhor duhej gjithashtu të parashikonte rregulla të qarta për hartimin e një flete të qartë votimi në mënyrë që votuesit të mos ngatërrohen dhe vota e tyre, si një e drejtë kushtetuese, të mos shpallet e pavlefshme nga moskuptimi i mënyrës së votimit.

Po kështu, duhen rishikuar në mënyrë të detajuar procedurat e numërimit, kontestimit dhe hartimit të tabelave të rezultateve për të garantuar saktësinë e rezultatit, transparencën e tij dhe reduktimin e ankimeve.

**Të gjitha këto rekomandime dhe kërkesa për garantimin e parimit të zgjedhjeve të lira e të ndershme sipas standardeve demokratike europiane dhe ndërkombëtare, janë injoruar me miratimin e njëanshëm e të pakonsultuar të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor me ligjin nr. 118/2020, të datës 5 tetor.**

\* \* \* \* \*

---

*instrumental in encouraging trust and confidence in electoral outcomes. All parties, both in the government and the opposition, have a responsibility in this regard. The process for revision of the electoral legislation should therefore be inclusive. It should also be finalised well in advance of the next elections."*

Mund ta konsultoni në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2011\)042-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2011)042-e)

## X. Reagimet pas ndryshimeve të njëanshme të 5 tetorit 2020 në Kodin Zgjedhor.

Pas miratimit nga Kuvendi të ligjit nr. **118/2020** “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, autoritete të organizatave ndërkombëtare apo dhe përfaqësues të trupit diplomatik këtu në Tiranë, kanë bërë reagimet e tyre.

- **Z. Michael Gahler**<sup>30</sup>, depuetet dhe zëdhënës i grupit parlamentar të Partive Popullore Europiane në Parlamentin Europian, përmes një statusi publik të bërë po në datën **5 Tetor 2020**, fill pas votimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, është shprehur se:

*“Duke votuar sot për të shkelur marrëveshjen e ndërmjetësuar të BE-së në 5 qershor me opozitën, Kryeministri shqiptar Edi Rama hodhi një hije të errët mbi zgjedhjet e përgjithshme të Prillit të ardhshëm të cilat supozojë të ishin të lira dhe të drejta dhe më të mira se ato të mëparshme. Duke e bërë këtë Rama qartë pengon integrimin e Shqipërisë në BE. Më saktësisht shkelja e marrëveshjes së 5 qershorit mund të shtyjë shumë mirë Konferencën e parë Ndërqeveritare si hapin e parë për fillimin e negociatave reale të pranimit në BE.*

*Shqipëria meriton shumë më mirë se kaq.*

*Ne i bëjmë thirrje Presidentit shqiptar të kthejë ligjet e sotme në Parlament. Ne i bëjmë thirrje Kryeministrit Rama të rishikojë pozicionin e tij për hir të së ardhmes evropiane të popullit shqiptar.”*

Mjafton kjo thirrje e grupit të partive kryesore të Parlamentit Evropian, për të kuptuar se sa i rëndësishëm është dialogu, bashkëpunimi, gjithëpërfshirja dhe konsensusi në përcaktimin e rregullave zgjedhore, dhe se çdo hap i njëanshëm i Kryeministrit Edi Rama do të ketë qartësisht një kosto të madhe që nuk do të penalizojë vetëm atë personalisht dhe partinë që ai drejton, **por kjo do të bjerë në dëm të popullit shqiptar, duke e shtyrë hapjen e negociatave me Bashkimin Europian pikërisht për shkak të shkeljes së këtyre standarteve që BE-ja, i ka përkthyer në dy kushte të detyrueshme për plotësim.**

---

<sup>30</sup> **Z. Michael Gahler**, përmes një statusi publik të bërë po në datën **5 Tetor 2020**, fill pas votimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, është shprehur se: “By voting today to breach the EU brokered 5 June agreement with the opposition, the Albanian Prime Minister Edi Rama cast a dark shadow over next April’s general election which were supposed to be free and fair and better than the previous ones. By doing so Rama clearly hinders Albania’s EU integration. More precisely the breach of the 5 June agreement may very well postpone the first Intergovernmental Conference as the first step for the beginning of the real EU accession negotiations.

*Albania deserves much better than that. We call on the Albanian President to send back today’s laws to Parliament. We call on PM Rama to reconsider his position for the sake of the European future of the Albanian people.”*

Ky status mund të gjendet në link-un:

<https://www.facebook.com/100007343383150/posts/2720338128220940/?extid=0&d=n>

- Edhe Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri ka reaguar për këto ndryshime në Kodin Zgjedhor. Përmes një statusi publik në **datën 5 Tetor 2020**, fill pas votimit të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, delegacioni shprehet<sup>31</sup>se:

*“Morëm njoftim mbi miratimin nga Parlamenti të ndryshimeve të tjera në Kodin Zgjedhor. **Kujtojmë se këto nuk kanë lidhje me zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it mbi reformën zgjedhore siç referohet në Konkluzionet e Këshillit të marsit.** Shprehim keqardhjen që nuk u arrit asnjë kompromis në Këshillin Politik para se ndryshimet të votoheshin në Parlament. Me gjithë rezultatin pozitiv të marrëveshjes mbi rekomandimet e OSBE / ODIHR-it të arritur më 5 qershor 2020, dialogu politik në vend duhet të përmirësohet. Ne inkurajojmë të gjithë palët e interesuara të mbajnë fokusin te zbatimi i reformave të nevojshme për vendin për të përparuar në rrugën e integritetit në BE, **përfshirë reformat e parashikuara në marrëveshjen e 5 qershorit.** Kjo do të sillte standarde më të larta të integritetit dhe transparencës në procesin zgjedhor, çka është thelbësore për të ardhmen politike të vendit”.*

- Një tjetër reagim që ka ardhur mbi këto ndryshime dhe që vlerësohet se duhet eividentuar edhe në këtë proces rivlerësimi të ligjit, është reagimi i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë. Përmes një statusi publik<sup>32</sup> në **datën 5 Tetor 2020**, shprehet se:

<sup>31</sup>Statusi mund të konsultohet dhe në link-un:

<https://www.facebook.com/304579276278549/posts/3293685364034577/>

**Statusi në gjuhën angleze:** *“We take note of the Parliament’s adoption of further amendments to the electoral code. We recall that these are unrelated to the implementation of the OSCE/ODIHR recommendations on electoral reform as referred to in the March Council Conclusions.*

*We regret that no compromise could be reached in the Political Council before the amendments were voted on in the Parliament.*

*Despite the positive outcome of the agreement on OSCE/ODIHR recommendations reached on 5 June 2020, the political dialogue in the country needs to be improved.*

*We encourage all stakeholders to maintain the focus on implementing the reforms needed for the country to advance on the EU integration path, including the reforms foreseen in the 5 June agreement. This will introduce higher integrity and transparency standards into the electoral process, which is crucial to the political future of the country”*

[European Commission](#)

[EU Neighbourhood & Enlargement](#)

[European External Action Service – EEAS”](#)

<sup>32</sup>Statusi mund të konsultohet dhe në link-un:

<https://www.facebook.com/74591195837/posts/10157741842170838/>

**Statusi në gjuhën angleze:** *“The United States has long pressed for Albania’s leaders – inside and outside Parliament – to engage each other in a transparent and inclusive manner on issues of national importance. This kind of positive engagement produced the June 5 agreement on electoral reform. We have made clear since then that the June 5 agreement should be honored and that any additional measures should be considered and adopted in similar transparent and inclusive manner using the Political Council. Today, the ruling party terminated discussions at the Political Council and voted to adopt significant changes to the rules that will govern the April 25 elections. While it was within Parliament’s competency to adopt these changes, and while these changes are in addition to – not in violation of – the June 5 agreement, it is regrettable that the majority failed to honor its own stated commitment to seek common ground in the Political Council. Albania is a member of NATO, an aspirant for membership in the European Union, and*

*“Shtetet e Bashkuara i kanë shtyrë udhëheqësit e Shqipërisë-brenda dhe jashtë parlamentit – për t’u angazhuar me njëri tjetrin në mënyrë transparente dhe përfshirëse për çështje me rëndësi kombëtare. Ky lloj angazhimi pozitiv prodhoi marrëveshjen e 5 qershorit për reformën zgjedhore. Nga ajo kohë, kemi bërë të qartë që marrëveshja e 5 qershorit duhet të respektohet dhe se çfarëdo masash shtesë duhen shqyrtuar dhe miratuar në mënyrë të ngjashme transparente dhe përfshirëse në Këshillin Politik. Sot, partia qeverisëse ndaloi diskutimet në Këshillin Politik dhe votoi për të miratuar ndryshime domethënëse të rregullave që do të qeverisin zgjedhjet e 25 prillit. Ndërkohë që ishte brenda kompetencave të parlamentit për t’i miratuar këto ndryshime, dhe ndërkohë që këto ndryshime janë shtesë – dhe jo shkelje – të marrëveshjes së 5 qershorit, është për të ardhur keq që shumica dështoi të respektonte përkushtimin e deklaruar prej vetë asaj për të kërkuar emërues të përbashkët në Këshillin Politik. Shqipëria është anëtare e NATO-s, aspiruese për anëtarësim në Bashkimin Europian, dhe Kryesuese e radhës e OSBE-së. Është detyrë e udhëheqësve të Shqipërisë – duke filluar por jo vetëm ata në pushtet – për të kërkuar nga vetja një standard më të lartë dhe për të siguruar lirinë dhe ndershmërinë e zgjedhjeve të ardhshme. Këtë pritshmëri e kemi ashtu si populli shqiptar”.*

Presidenti i Republikës, vlerëson t’i pasqyrojë në këtë arsyetim qëndrimet e përfaqësuesve të partnerëve tanë strategjikë BE dhe SHBA, për t’ia risjellë në kujtesë të gjitha palëve për rritje të ndërgjegjësimit publik, ndërkohë që shqyrtimi aktual i kësaj nisme ligjore, në zbatim të nenit 85, pika 1, të Kushtetutës, është në kompetencë vetëm të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

**Nëse Kuvendi i Shqipërisë nuk reflekton për rishikimin e këtij ligji pas kthimit të tij nga Presidenti i Republikës, vlerësimi përfundimtar mbi papajtueshmërinë e ligjit nr. 118/2020, me Kushtetutën e rrjedhimisht me Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe standartet ndërkombëtare është atribut vendimmarrës i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për fat të keq ende jo funksionale.**

Është pikërisht mungesa e Gjykatës Kushtetuese ajo që e bën edhe më të dyshimtë ndërmarrjen dhe miratimin e kësaj nisme ligjore, ç’ka bën që të konsolidohet edhe më tej bindja se mungesa e kësaj gjykate dhe bllokimi i ripërtëritjes së saj është produkt origjinal i kësaj mazhorance qeverisëse, e cila prej **32 muaj** është mësuar pa kontroll kushtetues të akteve të saj dhe dëshiron ta ruajë këtë gjendje të pandryshuar, edhe për disa kohë, deri pas realizimit të procesit zgjedhor të 25 prillit 2021.

\* \* \* \* \*

---

*Chairman-in-Office of the OSCE. It is incumbent upon Albania’s leaders – beginning with but not limited to those in power – to hold themselves to a higher standard and to ensure the freedom and fairness of the upcoming elections. We stand with the Albanian people in this expectation.”*

**XI. Ndryshimet e njëanshme të 5 Tetorit 2020 në Kodin Zgjedhor bien ndesh me parimet dhe standardet ndërkombëtare të miratuara ndër vite nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias dhe nuk respektojnë kërkesat e plotësimit të kushteve të Bashkimit European dhe Buntestagut Gjerman.**

Përmes miratimit ligjit nr. 118/2020, janë shkelur parimet themelore dhe standartet evropiane të OSBE/ODIHR, Këshillit të Europës (Komisionit të Venecias), si dhe është injoruar përmbushja e kushteve të vendosura nga Bundestagu dhe Këshilli European për hapjen e negociatave.

Parimet, standardet themelore dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR dhe Këshillit të Europës e Komisionit të Venecias, kërkojnë ndër të tjera që: **Të mos bëhet ndryshim i rregullave themelore zgjedhore ku hyjnë, si mënyra e konkurrimit, dhe shndërrimi i votave në mandate, 1-vit para zgjedhjeve e në veçanti pa konsensus gjithëpërfshirës. Ndërkohë që në realitetin tonë tashmë ka filluar dhe procesi i parapërgatitjes së garës elektorale.**

Dokumentet e miratuara nga organizmat ndërkombëtar si OSBE/ODIHR, Komisioni i Venecias, etj, janë të detyrueshme për njohje e zbatim dhe një udhërrëfyes në veprimtarinë e shteteve anëtare në këto organizma. Këto dokumente që pasqyrojnë Standardet Evropiane Zgjedhore janë të detyrueshme edhe për Shqipërinë.

Në të gjitha këto dokumente vihet theksi tek fakti dhe nevoja se çdo shtet, **ndryshimet e rregullave zgjedhore, duhet domosdoshmërisht t'i realizojë përmes konsensusit gjithëpërfshirës dhe në interes të votuesit të tyre.**

Konkretisht:

**❖ Rekomandimet e OSBE/ODIHR**

1. Në dokumentin “Zotimet ekzistuese për zgjedhje demokratike në shtetet pjesëmarrëse në OSBE”<sup>33</sup>, në pikën 2.5, përcaktohet se:

“ Një kornizë e qartë dhe e hollësishme ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve duhet të përcaktohet përmes ligjit obligues, ose me një kod gjithëpërfshirës, ose nëpërmjet një vargu të ligjeve që veprojnë së bashku në mënyrë konzistente dhe pa paqartësi ose gabime. Përveç në raste të jashtëzakonshme - në të cilin janë zbuluar mangësi serioze në legjislacionin ose zbatimin e tij dhe kur ekziston një konsensus efektiv politik dhe publik mbi nevojën për të korigjuar ato - **ndryshimet në ligj nuk duhet të bëhen gjatë periudhës menjëherë para zgjedhjeve**, sidomos në qoftë se mund të jetë e shkelur aftësia e votuesve, **partive politike**, ose kandidatëve për të luajtur rolin e tyre në zgjedhjet.”

<sup>33</sup> Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un: <https://www.osce.org/odihr/elections/13957>

Këtë qëndrim e mbështet në CDL Udhëzimet, II, 2.b, ku është parashikuar se: *“elementet themelore të së drejtës zgjedhore ... nuk duhet të jetë i hapur për ndryshim më pak se një vit para zgjedhjeve.”*

Paragrafi 2.5 thekson se duhet të ekzistojë një kornizë e qartë për zgjedhjet në të drejtën statusore. Aspektet e kornizës legjislative mund të jenë të parashikuara në Kushtetutë ose mund të adresohen përmes veprimit rregullues ose administrativ, nën drejtimin e duhur ligjor. [...] Ky paragraf parashikon gjithashtu se ligjet e lidhura me zgjedhjet **nuk duhet të ndryshohen gjatë periudhës menjëherë para zgjedhjeve, nëse nuk është absolutisht e nevojshme për ta bërë këtë; nëse nuk ekziston një konsensus i fuqishëm në mbështetje, dhe ndryshimet nuk do të zvogëlojnë aftësinë e pjesëmarrësve të zgjedhjeve për të përmbushur rolin e tyre në proces.** Nuk u vlerësua si e rekomandueshme të përmendet ndonjë periudhë e caktuar kohore ose rrethanat e tjera në lidhje me ndryshimet ligjore, të tilla si të propozuar nga Komisioni i Venecias, pasi arsyet për të propozuar ndryshime në ligjet zgjedhore në afatin e fundit ndryshojnë shumë<sup>34</sup>.

2. Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve Vendore, i datës 5 shtator 2019<sup>35</sup>, në Rekomandimin nr. 1, është shprehur qartësisht se:

*“Me qëllim forcimin e demokracisë pluraliste, rikonfirmimin e të drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në qeverisje dhe demonstrimin e përgjegjësisë së përbashkët për integritetin e procesit zgjedhor, partitë politike dhe aktorët e tjerë zgjedhorë duhet të angazhohen në një dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës dhe të lehtësojnë reformën zgjedhore për adresimin e rekomandimeve që përmban ky raport dhe raportet e mëparshme të ODIHR-it.”*

❖ **Këshilli i Europës - Komisioni European për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), jep këto udhëzime për çështjet zgjedhore**

**Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore**<sup>36</sup>, një dokument i miratuar nga Komisioni European për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), më 18-19 Tetor 2002 (Opinion nr. 190/2002, CDL-AD (2002)23rev2-cor), përmban udhëzime dhe raport shpjegues mbi çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

<sup>34</sup> OSBE, “Zotimet ekzistuese për zgjedhje demokratike në shtetet pjesëmarrëse në OSBE”, faqe 32. <https://www.osce.org/odihr/elections/13957>

<sup>35</sup> Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un: <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/417425>

<sup>36</sup> Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDCD-AD\(2002\)023rev2-cor-alb](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDCD-AD(2002)023rev2-cor-alb)



Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore është miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës në sesionin e saj të parë të vitit 2003 dhe nga Kongresi i pushteteve lokale dhe vendore të Europës në sesionin e tij të pranverës 2003<sup>37</sup>.

1. Ky Kod<sup>38</sup>, në Kreun II, pika 2, mbi “**Nivelet normative dhe qëndrueshmërinë e të drejtës zgjedhore**”, përcakton se:

*“a. Përveç rregullave teknike dhe atyre për hollësira – të cilat mund të nxirren si rregullore prej ekzekutivit-rregullat e se drejtes zgjedhore, duhet të nxirren të paktën në nivelin e ligjit.*

*b. **Elementët themelore të se drejtes zgjedhore**, dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, dhe hartimit të kufijve të zonave zgjedhore, **nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve**, ose duhet të shkruhen në Kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm.”*

2. Ndërsa në paragrafët 63 deri në 66, të këtij dokumenti, ku evidentohen rregullat dhe standardet europiane mbi “**Nivelet normative dhe qëndrueshmërinë e ligjit zgjedhor**”, përcaktohet se:

*“63. **Qëndrueshmëria e ligjit ka rëndësi kritike për besueshmërinë e procesit zgjedhor**, i cili është, me rëndësi jetike për konsolidimin e demokracisë. Rregulla, të cilat ndryshojnë shpesh – dhe veçanërisht rregulla të cilat janë të ndërlikuara – mund të shkaktojnë **konfuzion tek votuesit**. Mbi të gjitha votuesit mund të arrijnë në konkluzionin, me të drejtë apo jo, se **ligji elektorale është një mjet në duart e të fuqishmeve**, dhe se votat e tyre **nuk kanë shumë peshë në përcaktimin e rezultateve të zgjedhjeve**.*

*64. Megjithatë, praktikisht nuk ka shumë nevojë për mbrojtjen e parimeve bazë (ka pak të ngjarë që të ketë diskutime për to), por qëndrueshmëria e disa rregullave specifike të ligjit elektorale, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vetë sistemin elektorale, përbërjen e komisioneve elektorale dhe hartimin e kufijve të zonave zgjedhore. Këto tri faktorë konsiderohen, me të drejtë apo pa, si faktorë vendimtarë për rezultatet e zgjedhjeve, dhe duhet të tregohet kujdes jo vetëm për shmangien e manipulimeve në favor të partisë në pushtet, por edhe çdo tentativë, sado e vogël, për manipulim.*

*65. Problemi nuk konsiston në ndryshimin e sistemeve zgjedhore – ato gjithmonë mund të ndryshojnë duke u përmirësuar – por rishikimi i tyre i shpeshtë ose përpara (brenda një viti) zgjedhjeve. Edhe sikur qëllimi të mos jetë manipulimi, përsëri do të duket sikur ndryshimet janë diktuar nga interesat konjunkturale politike.*

<sup>37</sup> Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, faqe 2.

<sup>38</sup> Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, <https://rm.coe.int/090000168092af01>.

Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev2-cor-alb](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev2-cor-alb)

66. Një mënyrë për të shmangur manipulimin është përkufizimi në Kushtetutë ose në një ligj me hierarki më të lartë se sa legjislacioni i zakonshemi elementëve që janë më të rëndësishëm (sistemi elektoral, anëtarët e komisioneve elektorale, zonat zgjedhore ose rregullat për hartimin e kufijve të zonave zgjedhore). Një zgjidhje tjetër më fleksibël do të ishte të theksohej në Kushtetutë se, nëqoftëse do të ndryshohet ligji elektoral, për zgjedhjet e ardhshme do të aplikohet sistemi i vjetër – të paktën nëqoftëse këto zgjedhje do të zhvillohen brenda vitit të ardhshëm – dhe pas kësaj do të hyjë në fuqi sistemi i ri.”

**3. Deklarata Interpretuese mbi Qëndrueshmërinë e Ligjit Zgjedhor**, miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në 15 Dhjetor 2005 dhe nga Komisioni i Venecias në 16 -17 Dhjetor 2005 (Studimi nr. 348/2005, CDL-AD(2005)043), shprehet se<sup>39</sup>:

“I. Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore (CDL-AD (2002) 023rev, pika II.2.B), shprehet se: “Elementët themelore të drejtës zgjedhore, dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, dhe hartimit të kufijve të zonave zgjedhore, nuk duhet të ndryshohen **më pak se një vit përpara zgjedhjeve**, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm. ”

II. Komisioni i Venecias e interpreton këtë tekst si më poshtë:

1. Parimi sipas të cilit elementët themelorë të ligjit zgjedhor **nuk duhet të jenë të hapur për ndryshim më pak se një vit para zgjedhjeve**, nuk ka përparësi ndaj parimeve të tjera të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore.

2. Nuk duhet të thirret për të ruajtur një situatë në kundërshtim me standardet e trashëguara zgjedhore europiane, ose për të parandaluar zbatimin e rekomandimeve nga organizatat ndërkombëtare.

3. Ky parim ka të bëjë vetëm me rregullat themelore të ligjit zgjedhor, kur ato paraqiten në ligje me shumicë të tjeshtë.

4. Në veçanti, konsiderohen rregulla themelore këto si më poshtë:

- sistemin zgjedhor në vetvete, për shembull: **rregullat në lidhje me shndërrimin e votave në mandate;**
- rregullat në lidhje me anëtarësinë e komisioneve zgjedhore ose një organi tjetër i cili organizon procesin zgjedhor;
- **hartimin e kufijve dhe rregullave në lidhje me shpërndarjen e mandateve midis zonave elektorale.**

<sup>39</sup> Mund ta konsultoni në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD\(2005\)043.aspx#](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD(2005)043.aspx#)

*5. Në përgjithësi çdo reformë e legjislacionit zgjedhor që do të zbatohet gjatë zgjedhjeve duhet të ndodhë mjaftueshëm herët që të jetë vërtet e zbatueshme për zgjedhjet.<sup>40</sup>”*

Referuar përmbajtjes së ndryshimeve të njëanshme në Kodin Zgjedhor të datës 5 tetor 2020, të krahasuara me standardet europiane mbi proceset zgjedhore të mirëpërcaktuara në udhërrëfyesin e OSBE/ODIHR, apo në opinionet e Komisionit të Venecias, rezulton se mazhoranca, **përmes ndryshimeve në Kuvendin e Shqipërisë ka shkelur hapur dhe me dashje çdo një prej këtyre dokumenteve.**

**Kjo provon qartësisht se, forca politike në pushtet, përmes dhunës dhe shpërdorimit të procesit ligjvënës:**

- **Dëshiron të manipulojë zgjedhjet e 25 prillit 2021 në favor të Partisë Socialiste, përmes ligjit, duke shfrytëzuar aktualisht edhe pozitën e Kryeministrit si kryesues i OSBE-së;**
- **Dëshiron të minimizojë fuqinë e shndërrimit të votës së qytetarëve opozitarë në mandate parlamentare;**
- **Dëshiron të krijojë avantazhe për partinë e tij në procesin zgjedhor të 25 prillit 2021;**
- **Dëshiron të ulë besimin e publikut në tërësi dhe votuesve tek ky proces zgjedhor, në mënyrë që të shmangë sa më shumë pjesëmarrjen në proces të votuesve opozitarë me qeverinë;**
- **Rrezikon që ta mbajë Shqipërinë jashtë Bashkimit Europian, duke shmangur çdo mundësi llogaridhënie dhe duke e ri-etiketuar vendin, si një shtet që nuk mund të realizojë edhe sot pas 30-vjetësh pluralizëm politik, zgjedhje të lira e të ndershme.**

#### ❖ **Qëndrimi i Bundestagut Gjerman**

Vendimi i Bundestagut Gjerman mbi Vendosjen e marrëveshjes së Bundestagut dhe Qeverisë Federale mbi aplikimin e Republikës së Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe mbi

<sup>40</sup> “I. The Code of good practice in electoral matters (CDL-AD(2002)023rev, item II.2.B) states:

“The fundamental elements of electoral law, in particular the electoral system proper, membership of electoral commissions and the drawing of constituency boundaries, should not be open to amendment less than one year before an election, or should be written in the constitution or at a level higher than ordinary law.”

II. The Venice Commission interprets this text as follows:

1. The principle according to which the fundamental elements of electoral law should not be open to amendment less than one year prior to an election does not take precedence over the other principles of the Code of Good Practice in Electoral Matters.

2. It should not be invoked to maintain a situation contrary to the standards of the European electoral heritage, or to prevent the implementation of recommendations by international organisations.

3. This principle only concerns the fundamental rules of electoral law, even they appear in ordinary law.

4. In particular, the following are considered fundamental rules :

- the electoral system proper, i.e. rules relating to the transformation of votes into seats;

- rules relating to the membership of electoral commissions or another body which organises the ballot;

- the drawing of constituency boundaries and rules relating to the distribution of seats between the constituencies.

5. In general any reform of electoral legislation to be applied during an election should occur early enough for it to be really applicable to the election.”

rekomandimin e bërë nga Komisioni European dhe Përfaqësuesi i Lartë në 29 maj 2019 që negociatat e anëtarësimit të hapen, shprehet se<sup>41</sup>:

*“Për më tepër, Bundestag i bën thirrje Qeverisë Federale:*

*1. të japë pëlqimin e tij në Këshillin European më 17 dhe 18 Tetor 2019 duke iu nënshtruar, si një çështje parimore, parakushteve vijuese:*

*[...] - ka miratuar reformat zgjedhore të vendit që përputhen plotësisht me rekomandimet e OSBE ODIHR, ka siguruar që financimi i partive politike dhe fushatave elektorale është transparent dhe ka vepruar sipas gjetjeve të komitetit ad hoc parlamentar për reformën zgjedhore; rishikimi i draftit të komitetit duhet të bëhet në një dialog të hapur dhe gjithëpërfshirës që përfshin të gjitha forcat politike, siç rekomandohet në raportin e ODIHR të 5 shtatorit 2019;”.*

## ❖ Bashkimi European

Në përfundimet e Këshillit të Bashkimit European mbi Procesin e Zgjerimit dhe Stabilizim-Asocimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë, të datës 25 mars 2020, është cituar shprehimisht se: *“Para Konferencës së parë Ndërqeveritare, Shqipëria duhet të miratojë reformën zgjedhore plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR [...]”<sup>42</sup>.*

Referuar të gjithë praktikave të mira, rekomandimeve, standarteve Europiane të vendosura nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias, **rezulton se ndryshimet në Kodin Zgjedhor bien hapur ndesh me këto dokumente**, edhe pse një sërë faktorët dhe drejtuesish të organizmave european i kanë bërë thirrje qeverisë për të tërhequr konsensus në çdo ndryshim që dëshiron të bëjë.

Jo vetëm kaq, por edhe kërkesës së shprehur të opozitës në Këshillin Politik, për të marrë një opinion në OSBE/ODIHR në lidhje me propozimet për ndryshime të mëtejshme në Kodin Zgjedhor, mazhoranca përmes përfaqësuesit të saj ju përgjigj me refuzim.

Është ironik dhe për të ardhur keq fakti se zoti Edi Rama, si Kryetari i radhës i OSBE-së, refuzon t'i drejtohet ekspertëve të një organizmi që po drejtohet aktualisht prej tij, për të marrë ekspertizën e OSBE/ODIHR dhe që shkel Marrëveshjet politike të ndërmjetësuara nga partnerët ndërkombëtarë.

Kryeministri i Shqipërisë është i vetmi Kryetar i OSBE-së që përpara marrjes dhe ushtrimit të kësaj detyre me rotacion, ka dhënë shembullin më të keq, duke kryer shkeljet më të rënda në vendin e tij, si në realizimin e procesit të votimeve për pushtetin lokal në vitin 2019, pa kandidatë rivalë dhe pa

<sup>41</sup> Faqe 4 e Vendimit, që mund ta konsultoni në link-un:

[https://www.bundestag.de/resource/blob/661474/a7dbc7059c21262d3053c2baa8704adb/decision\\_albania-data.pdf](https://www.bundestag.de/resource/blob/661474/a7dbc7059c21262d3053c2baa8704adb/decision_albania-data.pdf)

<sup>42</sup> Përfundimet e Këshillit të Bashkimit European mbi Procesin e Zgjerimit dhe Stabilizim-Asocimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Shqipërisë, faqe 5. Mund të konsultohet në link-un: <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdfENLARGEMENT>

garë, ashtu siç dhe po përpiqet me çdo kusht që përmes ndryshimet në Kodin Zgjedhor, të krijojë një ambjent ligjor që të favorizojë forcën e tij politike në pushtet dhe që dëmton çdo forcë opozitare me qeverinë.

Ky është rasti më i rëndë i korrupsionit legjislativ, ku përmes ndryshimit të rregullave zgjedhore, po tentohet marrja e një rezultati pozitiv në favor të Partisë Socialiste dhe dëmtimi i kundërshtarëve politikë. Një veprim i tillë cenon parimin e OSBE-së mbi “fushën e barabartë të lojës”.

**Të realizosh përmes votës në Kuvend, krijimin e hapësirave favorizuese për forcën politike që drejton në kushtet kur mban detyrën si Kryeministër i Shqipërisë dhe President i radhës i OSBE-së, është tregues i qartë se brenda këtij vullneti ligjbërës fshihen dhe realizohen qëllime që shkojnë përtej objektivave politike.**

Këto veprime do të duhet të hetohen edhe penalisht për të grumbulluar prova e fakte edhe më të detajuara se si po tentohet të manipulohet reforma zgjedhore dhe gara elektorale në dëm të interesave të shqiptarëve.

Nëse mazhoranca nuk reflekton, si Presidenti i Republikës, ndihem i detyruar të ndërmarr të gjitha veprimet kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të vlerave dhe parimeve të demokracisë për të mos lejuar shtrembërimin e vullnetit të popullit, ndërkohë që shpreh bindjen se kjo gjendje e rëndë paligjshmërie do të zgjidhet përmes reagimit popullor dhe zgjedhjes së drejtë të sovranit.

\* \* \* \* \*

**XII. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të realizuara në 5 tetor 2020, përmes Ligjit nr. 118/2020, bien ndesh me Kushtetutën, cenojnë parimin e sigurisë juridike dhe të procesit të rregullt ligjor, si dhe krijojnë diskriminim të theksuar në jetën politike**

**1. Ligji nr.118/2020, përkeqëson pozitën e partive të vogla dhe shkakton diskriminim. Ndryshimi i pragut elektoral dhe zbalancimi i konvertimit të votave në mandate përfaqësuese në Kuvend**

Një ndër ndryshimet thelbësore të bëra sa i takon mënyrës së përlllogaritjes dhe konvertimit të votave të qytetarëve të vendit në mandate që do t'i përfaqësojnë, është ai i bërë në dispozitën e nenit 162 të Kodit Zgjedhor, dispozitë kjo që përcakton mënyrën e përlllogartijes së mandateve të subjekteve zgjedhore.

Neni 162, pika 1 e Kodit Zgjedhor, **para** ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 118/2020, përcaktonte se:

*“Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Për zgjedhjet për Kuvendin, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike që konkurrojnë më vete dhe që kanë marrë më pak se 3 për qind dhe koalicionet që kanë marrë më pak se 5 për qind të votave të vlefshme në zonën zgjedhore përkatëse.”*

Me ligjin nr. 118/2020, kjo pikë e ndryshuar përmban këtë parashikim:

*“Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore apo pavlefshmërisë së zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.”*

Në leximin e parë duket sikur ky ndryshim sjell mbështetje për subjektet politike për t'u përfaqësuar në Kuvend, meqë në vlera shifrore, ulet përqindja e votave të nevojshme për t'u përfshirë në shpërndarjen e mandateve.

Në realitet, një ndryshim i tillë do të kuptohej pozitivisht vëtem nëse ulja e përqindjes së votave do të ishte bërë për një zonë zgjedhore, sic përcaktonte më parë dispozita.

Sistemi zgjedhor i aplikueshëm i parashikuar në Kushtetutë është **proporcional rajonal**, sipas nenit 64, paragrafi 1, ndërkohë që ndryshimi në Kushtetutë e më pas në Kodin Zgjedhor i një pragu prej **1 % në nivel kombëtar është shumë problematik për disa parti politike.**

Koncepti kushtetues i **pragut elektoral në rang kombëtar** nuk përputhet me konceptin tjetër që po Kushtetuta parashikon brenda të njëjtës normë, të sistemit zgjedhor **proporcional me konkurrim rajonal.**

Autorët e ndryshimit të njëanshëm kushtetues, brenda të njëjtit paragraf kushtetues (neni 64, paragrafi 1) kanë shkaktuar një kontradiktë/përplajse të theksuar të dispozitës. Kjo kontradiktë, e normuar edhe më tej me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 118/2020 në Kodin Zgjedhor, bën që norma e Kodit Zgjedhor të bjerë ndesh me njërin prej këtyre nocioneve të Kushtetutës, duke krijuar antikushtetushmëri, *ambiguitet* dhe paqartësi më tej në zbatim.

Me rishikimin e përqindjes së votave të nevojshme për shpërndarjen e mandatit, **nga 3 % në nivel qarku, në 1% në nivel kombëtar**, ka ndryshuar gjithashtu dhe përlllogaritja e pragut të kësaj përqindjeje **nga në shkallë zone zgjedhore, tashmë në shkallë vendi.**

Një ndryshim i tillë sjell **trajtim të pabarabartë, diskriminim të disa partive**, që në zona të caktuara zgjedhore përfaqësojnë më së tepërmi një kategori të caktuar zgjedhësish (në varësi të ndarjes së zonave zgjedhore e që përfshijnë natyrën historike, gjeografike, demografike etj.), **duke iu mohuar këtyre të fundit të drejtën për t' u ndjerë të përfaqësuar dhe duke zhvlerësuar votën e tyre në raport kombëtar.**

**Pra nëqoftëse deri më sot, brenda një zone zgjedhore zgjedhësit me votat mbështetëse që i jepnin një force politike të caktuar apo kandidatëve të tyre, kishin mundësi të përfaqësoheshin në Kuvendin e Shqipërisë për shkak të përlllogaritjes së numrit të votave në rang zone zgjedhore, me sistemin e ri të llogaritjes në rang kombëtar, vota e tyre rrezikon të zhvleftësohet dhe forca politike që ata dëshirojnë t' i përfaqësojë, të mos arrijë dot përqindjen e caktuar për një mandat parlamentar.**

***Për ilustrim: Nga 12 zonat zgjedhore, zgjidhen 140 deputetë.***

Në zgjedhjet e vitit 2017, votuan gjithësej **1.582.150 shtetas.**

Në Qarkun Dibër, në zgjedhjet e vitit 2017:

- Votuan: **73 702 zgjedhës**, të cilat u përkthyen në 6 mandate parlamentare.

Sipas rezultatit zgjedhor, përafërsisht **11 000 vota** prodhuan **1 mandat**. Kjo edhe për partitë e vogla, që kalonin prapun ligjor zgjedhor në nivel rajonal.

Ndërkohë që, me pragun ligjor zgjedhor kombëtar prej 1 %, të përcaktuar me ligjin nr. 118/2020, një subjekti zgjedhor do t'i duhen përafërsisht mbi **15 822 vota**.

**Pra, me ndryshimet e bëra, një parti në këtë qark, që do marrë edhe 15 821 vota, mund të mos arrijë dot të marrë asnjë mandat**, pasi duhet të arrijë përbushjen e pragut ligjor zgjedhor në nivel kombëtar, duke bërë që më së paku deri në **15 821** vota (pra një votë më pak se pragu ligjor zgjedhor) nga **73 000 votues** të atij qarku, të humbasin fuqinë e përfaqësimit në Kuvend.

**Kjo situatë mund të ndodhë në çdo qark, ku parti të ndryshme me karakteristika apo lidhje të veçanta me zonën/elektoratin përfaqësojnë dhe kanë mbështetje historike të votuesve.**

Madje, po të krahasohen të dhënat e rezultateve në rang vendi në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017, nga 18 parti politike që morën pjesë në zgjedhje, 13 prej tyre nuk kanë arritur të kapin përqindjen në rang vendi që synon të përcaktohet me ligjin nr. 118/2020. Më poshtë tabela përmbledhëse e rezultateve zgjedhore të vitit 2017, sipas KQZ-së:

**TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE NË RANG VENDI**

	Gjithsej	M	F
Numri i zgjedhësve në listë	3.452.324	1.743.761	1.708.563
Pjesmarrja (numër, %)	1.613.810	46,75%	809.668
Fletë votimi të papërdorura	1.831.846		
Fletë votimi të dëmtuara	5.815		
Fletë votimi të gjetura në kuti	1.614.051		
Vota të pavlefshme	31.898	1,98%	
Vota të vlefshme	1.582.150	98,02%	

(mungojnë të dhëna gjinore për pjesmarrjen për 302 QV)

Nr.	Partitë		Vota	%	Mandate
1	LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM	LSI	225.901	14,28%	19
2	PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË	PS	764.750	48,34%	74
3	PARTIA KRISTIAN DEMOKRATE E SHQIPËRISË	PKD	2.421	0,15%	0
4	SFIDA PER SHQIPERINE	SFIDA	3.546	0,22%	0
5	PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE	PR	3.225	0,20%	0
6	PARTIA DEMOKRATIKE	PD	456.413	28,85%	43
7	PARTIA BASHKIMI DEMOKRISTIAN SHQIPTAR	PBDKSH	924	0,06%	0
8	PARTIA ALEANCA DEMOKRISTIANE	ADK	767	0,05%	0
9	PARTIA SOCIAL DEMOKRATE E SHQIPËRISË	PSD	14.993	0,95%	1
10	ALEANCA DEMOKRATIKE	AD	547	0,03%	0
11	FRYMA E RE DEMOKRATIKE	FRD	5.146	0,33%	0
12	PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE	PDS	2.473	0,16%	0
13	PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET	PDIU	76.069	4,81%	3
14	ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE	AAK	351	0,02%	0
15	MINORITETI ETNIK GREK PËR TË ARDHMEN	MEGA	2.287	0,14%	0
16	PARTIA KOMUNISTE E SHQIPËRISË	PKSH	1.026	0,06%	0
17	ALEANCA POPULLORE PER DREJTESI	APD	1.505	0,10%	0
18	LISTA E BARABARTE	LIBRA	19.806	1,25%	0
	<b>Gjithsej</b>		<b>1.582.150</b>	<b>100,00%</b>	<b>140</b>

Por ka prej këtyre partive që kanë patur deri në 14 000 vota në rang vendi, e kanë marrë të paktën 1 mandat në një qark të caktuar. Ndërsa tanimë, me parashikimin e ri kushtetues dhe ligjor të miratuar me ligjin nr. 118/2020, nuk do arrijnë dot të marrin asnjë mandat. Ky prag i vendosur tashmë në rang kombëtar, rëndon pozitën e forcave politike për të siguruar mandat përfaqësues të votuesve të tyre në Kuvend.



Përmes kufizimit të mundësisë së mospërfaqësimit, shkaktohet një tjetër shkelje kushtetuese përmes diskriminimit, gjë e cila **bie ndesh me nenin 18, të Kushtetutës, që sanksionon se:**

*“[...] Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.”*

Ky ndryshim i njëanshëm në Kodin Zgjedhor, i padakordësuar dhe konsultuar me partitë politike në vend, në kundërshtim me parimet për zgjedhje demokratike, **duket se është marrë në mënyrë të mirëstudiuar nga Partia Socialiste, që tashmë synon të nxjerrë jashtë ndikimit politik peshën e disa partive, duke e monopolizuar arenën politike vetëm në dy blloqe kryesore.**

Duke qenë se ndërhyrjet bëhen në mënyrë të njëanshme e ku Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim dhe gjithë partitë e tjera opozitare e kundërshtojnë këtë zgjedhje, **atëherë i vetmi përfitues real i dukshëm është mazhoranca socialiste, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i kësaj force politike.**

Kjo vendimmarrje e Kuvendit, bie ndesh me parimet e shtetit të së drejtës dhe rendit shoqëror demokratik, që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, pjesë e së cilës është dhe e drejta e votës dhe të qënurit të përfaqësuar, **parime këto që mbrohen nga nenet 2<sup>43</sup>, 3<sup>44</sup>, 15<sup>45</sup>, 18<sup>46</sup>, 45<sup>47</sup>, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

---

<sup>43</sup> Neni 2, paragrafi 2, i Kushtetutës përcakton se: “2. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti.”

<sup>44</sup> Neni 3, i Kushtetutës përcakton se: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, **pluralizmi**, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”

<sup>45</sup> Neni 15, i Kushtetutës sanksionon se:

“1. **Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.**

2. **Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”**

<sup>46</sup> Neni 18, i Kushtetutës përcakton se:

“1. **Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.**

2. Askush **nuk mund të diskriminohet padrejtësisht** për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, **bindjet politike**, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive.”

<sup>47</sup> Neni 45, i Kushtetutës sanksionon se:

“1. **Çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet.**

2. **Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht.**

3. **Përjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dëbuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.**

4. **Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”**

Ndryshimet e realizuara në 5 tetor 2020, respektivisht në nenin 21 të ligjit nr. 118/2020, parashikojnë shprehimisht se:

“Neni 21

Neni 163 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 163

*Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës*

1. *Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.*
2. *Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën e dorëzuar sipas nenit 67 të këtij Kodi, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat bazuar në procedurat dhe kriteret vijuese.*
3. *Në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti, sipas nenit 162 të këtij Kodi. **Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 000 vota.** Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.*
4. ***Kandidatët me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi, sipas pikës 3 të këtij neni, zëvendësojnë me radhë kandidatët në listë, që mund të kishin përfitur mandate, të cilët kanë numrin më të vogël të votave parapëlqyese.***
5. *Ky rregull nuk zbatohet nëse kandidati me më pak vota i përket gjinisë më pak të përfaqësuar. Në këtë rast zëvendësimi kalon te kandidati tjetër i renditur menjëherë më lart me numër votash deri në shterimin e listës sipas të njëjtave kritere. Kur kandidati me numër më të madh votash se herësi i përket të njëjtës gjini, zbatohen parashikimet e pikës 4 të këtij neni.*
6. *Pas shterimit të zëvendësimit të kandidatëve sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni, shpërndarja e mandateve vijon me kandidatët e mbetur sipas numrit rendor të listës.*
7. *Kandidatët e mbetur të listës, që nuk përfitojnë mandate sipas pikave 2 deri 6 të këtij neni, rirenditen në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi.*
8. *Përlllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi nxirret për çdo zonë zgjedhore më vite. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.”.*

Nëse kjo normë do të hyjë në fuqi, ky sistem bën që **vota të ketë peshë të ndryshme** si brenda të njëjtit subjekt zgjedhor (në rastin e disa partive që vendosin të konkurrojnë si koalicion parazgjedhor), ashtu dhe midis subjekteve zgjedhorë konkurrues.

Kandidati i njëjës parti mund të marrë shumë herë më shumë vota se kandidati i partisë tjetër, por kushtëzohet dhe i mohohet e drejta e mandatit pikërisht për shkak të mënyrës së përlogaritjes së herësit të subjektit zgjedhor në listën e të cilit është përfshirë për konkurrim.

E thënë më thjeshtë, sipas parashikimeve të nenit 163 të riformuluar me ligjin nr. 118/2020, shifra e herësit për një subjekt zgjedhor përlogaritet nga numri i votave të vlefshme të atij subjekti, pjesëtuar me numrin e mandateve të fituara në atë zonë zgjedhore. Kjo do të thotë që, çdo subjekt zgjedhor do të ketë shifër të ndryshme herësi, në varësi të votave të marra dhe mandateve të fituara. Ky numër i ndryshëm herësi bën që në vetvete, **pesha e votës të jetë e ndryshme, në varësi të subjektit zgjedhor, dhe jo e barabartë.**

Pra edhe në rastin kur dy kandidatë marrin të njëjtin numër votash, por herësi i listave respektive është i ndryshëm, këta **kandidatë nuk kanë mundësi të barabarta për t'u zgjedhur**, sepse duhet të sigurojnë një numër votash që tejkalon herësin e subjektit zgjedhor përkatës në të cilin konkurojnë. Kështu, kandidati i njërit subjekt që e ka herësin më të ulët arrin të fitojë mandate duke zëvendësuar një kandidat që ka më pak vota, ndërsa kandidati i listës rivale ku herësi është më i lartë, nuk arrin ta kapërcejë herësin edhe pse ka të njëjtin numër votash me kandidatin e listës tjetër që u shpall fitues.

***Shembull i formulës diskriminuese, gjatë zbatimit në praktikë:***

Në një zonë zgjedhore në të cilën shpërndahen në total 6 mandate:

**Subjekti zgjedhor A:** Ka herësin 9 000 vota

Arrin të sigurojë 3 mandate.

**Subjekti zgjedhor B:** Ka herësin 7 000 vota.

Arrin të sigurojë 3 mandatet e tjera.

**Kandidati X i subjektit zgjedhor A:** Është renditur i 4-ti në listë.

Merr **8 500 vota parapëlqyese.**

**Nuk arrin** dot të marrë një mandat.

**Kandidati Y i subjektit zgjedhor B:** Është renditur i 4-ti në listë.

Merr **8 500 vota parapëlqyese.**

**Arrin** të marrë mandate pasi sponon nga lista 1 prej 3 të parëve të renditur.

Pra, për të njëjtën zonë zgjedhore, pesha e 8500 votuesve në një listë, është më e vogël se pesha e 8500 votuesve në listën tjetër.

Kësisoj, ky është një **dhunim i parimit kushtetues të barazisë së votës dhe të mos diskriminimit të kandidatëve.** Gjithashtu, kjo pabarazi e peshës së votës, cenon edhe parimin e sigurisë juridike dhe e bën të vështirë për votuesit të kuptojnë nëse kanë **mundësi të barabarta me votuesit e tjerë për të zgjedhur një kandidat me votat e tyre.**

Shtesa e bërë në pikën 3, të nenit 88 të Kodit Zgjedhor, përmes nenit 9, të ligjit nr. 118/2020, krijon një raport diskriminues sa i takon të drejtave politike dhe elektorale të një partie pjesëmarrëse në votim si pjesë e një koalicioni. Kjo për arsye se, këto ndryshime parashikojnë që **për efekte financimi**, numri zyrtar i votave të marra nga një parti pjesë e një koalicioni *për llogaritjet duke mbledhur mesataren e votave për mandate për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre*. Shuma e këtyre rezultateve në secilën nga 12 zonat zgjedhore përbën numrin e përgjithshëm të votave të asaj partie në nivel kombëtar. Ky parashikim nuk përkon aspak me numrin e vërtetë të votave të marra nga kandidatë individualë të partisë pjesë e koalicionit, **pasi nuk faktorizon në rezultat votat parapëlqyese të marra nga kandidatët e asaj partie në listat e koalicionit**, por që nuk arrijnë dot të zgjidhen pikërisht për shkak të skemës.

Sipas parashikimeve të ligjit nr. 118/2020, dhe skemës që përcakton ky ligj objekt shqyrtimi, një parti pjesë e një koalicioni parazgjedhor, që ka arritur pragun e votave në nivel kombëtar, por që nuk ka arritur të marrë një mandat, do të llogaritet sikur nuk ka marrë vota dhe rrjedhimisht, nuk do të mund të përfitojë as financim. Mungesa e financimit, që në këtë rast lidhet kryesisht me partitë e vogla, dobëson në mënyrë diskriminuese peshën politike të saj, pa marrë aspak në konsideratë votat parapëlqyese që mund të kenë marrë kandidatët e kësaj partie. Kjo ndikon direkt si në mundësitë për të bërë fushatë, ashtu dhe për të qënë të pranishëm në jetën politike në vend.

## 2. Mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Ndryshimi i njëanshëm i Kushtetues dhe më pas edhe i Kodit Zgjedhor, cenon veçanërisht parimin **kushtetues të sigurisë juridike** dhe pritshmërive të ligjshme të individëve apo subjekteve të cilëve norma u drejtohet.

Siguria juridike, si koncept kushtetues i trajtuar disa herë nga praktika e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe **qëndrueshmërinë e sistemit normativ**<sup>48</sup>. Ky parim duhet veçanërisht të zbatohet kur ndërtohen rregulla zgjedhore që i adresohen, prekin dhe aplikohen nga e gjithë popullsia me të drejtë për t'u zgjedhur e për të zgjedhur.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Politike të 5 qershorit 2020, dhe Kodifikimit të dakordësuar të saj në 23 korrik 2020, përmes ligjit nr. 101/2020, mund të thuhet se efektivisht përmes ligjit tashmë të gjitha forcave politike pjesëmarrëse historikisht në garat elektorale zgjedhore, iu krijua një terren më i sigurtë mbi rregullat e konkurrimit në garën e ardhshme elektorale. Dhe referuar këtyre

<sup>48</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë: V-26/2005, V-34/2005, V-36/2007, etj

rregullave të dakordësuara, Presidenti i Republikës dekretoi datën për mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvend më 25 prill 2021.

**Bazuar në këto rregulla të dakordësuara, është e pritshme që partitë politike të ndërtonin strategjitë dhe programet e tyre elektorale duke vendosur për të garuar më vehte apo në koalicion e duke i bërë publike këto vendime, si dhe duke kryer njëkohësisht edhe informimin e publikut apo mbështetësve të tyre mbi mënyrën e re se si do të realizohej implementimi i kësaj reforme të dakordësuar dhe realizimi i procesit të votimit.**

Referuar pritshmërive të ligjshme që krijojnë si forcat politike, ashtu dhe strukturat, mbështetësit apo elektorati i tyre, përkeqësimi i pozitës ligjore nuk mund të mendohej prej tyre. **Ky terren ligjor tashmë i stabilizuar me konsensus nuk mund dhe nuk duhet të ndryshonte për asnjë arsye, përveç arsyeve madhore dhe të dakordësuara nga të gjithë.**

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka arsyetuar gjatë mbi respektimin e parimit të sigurisë juridike, si një nga shtyllat e respektimit të shtetit të së drejtës. Gjykata Kushtetuese citon në vendimet e saj se:

*“Siguria juridike parakupton, veç të tjerash, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi kushtetues i shtetit të së drejtës do të konsiderohet i dhunuar, nëse mohohen ose shkelen siguria juridike, stabiliteti ligjor dhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt këtë parim, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi. (shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese, etj ).”*

**Respektimi i parimi të sigurisë juridike është nga shtyllat kryesore të vlerësimit të një procesi zgjedhor.** Për këtë arsye OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias i ka kushtuar një rëndësi shumë të madhe në udhëzimet e tyre qëndrueshmërisë së ligjit zgjedhor. Referuar parimeve të këtyre organizmave është folur në mënyrë shteruese në Kapitullin XI të këtij arsyetimi, por mjafton që të përmendim faktin se Komisioni i Venecias në **Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore**<sup>49</sup>, miratuar më 18-19 Tetor 2002 në Kreun II, pika 2/b, mbi “Nivelet normative dhe qëndrueshmërinë e të drejtës zgjedhore”, përcakton se:

<sup>49</sup> Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un:

*“b. Elementët themelore të së drejtes zgjedhore, dhe, në veçanti, të sistemit zgjedhor, përbërjes së komisioneve elektorale, dhe hartimit të kufijve të zonave zgjedhore, **nuk duhet të ndryshohen më pak se një vit përpara zgjedhjeve, ose duhet të shkruhen në kushtetutë ose në një dokument ligjor të një niveli më të lartë se legjislacioni i zakonshëm.**”*

Gjithashtu, në paragrafët 63 deri në 66, të këtij dokumenti, ku pasqyrohen rregullat dhe standartet mbi **“Nivelet normative dhe qëndrueshmërinë e ligjit zgjedhor”**, përcaktohet se:

***“63. Qëndrueshmëria e ligjit ka rëndësi kritike për besueshmërinë e procesit zgjedhor, i cili është, me rëndësi jetike për konsolidimin e demokracisë. Rregulla, të cilat ndryshojnë shpesh – dhe veçanërisht rregulla të cilat janë të ndërlikuara – mund të shkaktajnë konfuzion tek votuesit. Mbi të gjitha votuesit mund të arrijnë në konkluzionin, me të drejtë apo jo, se ligji elektorale është një mjet në duart e të fuqishmeve, dhe se votat e tyre nuk kanë shumë peshë në përcaktimin e rezultateve të zgjedhjeve.***

*64. Megjithatë, praktikisht nuk ka shumë nevojë për mbrojtjen e parimeve bazë (ka pak të ngjarë që të ketë diskutime për to), **por qëndrueshmëria e disa rregullave specifike të ligjit elektorale, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me vetë sistemin elektorale, përbërjen e komisioneve elektorale dhe hartimin e kufijve të zonave zgjedhore. Këto tri faktorë konsiderohen, me të drejtë apo pa, si faktorë vendimtarë për rezultatet e zgjedhjeve, dhe duhet të tregohet kujdes jo vetëm për shmangien e manipulimeve në favor të partisë në pushtet, por edhe çdo tentativë, sado e vogël, për manipulim.***

*65. Problemi nuk konsiston në ndryshimin e sistemeve zgjedhore – ato gjithmonë mund të ndryshojnë duke u përmirësuar – por **rishikimi i tyre i shpeshtë ose përpara (brenda 1 -një viti) zgjedhjeve. Edhe sikur qëllimi të mos jetë manipulimi, përsëri do të duket sikur ndryshimet janë diktuar nga interesat konjunkturale politike.***

*66. Një mënyrë për të shmangur manipulimin është përkufizimi në Kushtetutë ose në një ligj me hierarki më të lartë se sa legjislacioni i zakonshëm elementëve që janë më të rëndësishëm (sistemi elektorale, anëtarët e komisioneve elektorale, zonat zgjedhore ose rregullat për hartimin e kufijve të zonave zgjedhore). **Një zgjidhje tjetër më fleksibël do të ishte të theksohej në Kushtetutë se, nëqoftëse do të ndryshohet ligji elektorale, për zgjedhjet e ardhshme do të aplikohet sistemi i vjetër – të paktën nëqoftëse këto zgjedhje do të zhvillohen brenda vitit të ardhshëm – dhe pas kësaj do të hyjë në fuqi sistemi i ri.***

Referuar standardeve europiane të OSBE/ODIHR, Komisionit të Venecias dhe Jurispudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e cila ka huazuar në vendimmarrjen e saj këto

standarde, ndryshimet e njëanshme të Kodit Zgjedhor në 5 tetor 2020, **krijojnë destabilizim të rendit juridik lidhur me procesin zgjedhor të 25 prillit, duke sjellë efekte të shumëfishta negative, qoftë në uljen e besimit reciprok tek palët politike, ashtu dhe në uljen e besimit të votuesit, si dhe të partnerët ndërkombëtarë, duke bërë në këtë mënyrë që të cenohet parimi i sigurisë juridike dhe besueshmëria tek procesi zgjedhor.**

Me ndërhyrjen që mazhoranca bëri e vetme fillimisht në Kushtetutë dhe më pas në 5 tetor 2020 edhe në Kodin Zgjedhor, cenoi sigurinë juridike dhe prishi besimin reciprok që palët kishin krijuar, pasi rregullat garuese themelore elektorale politike ndryshuan sërish, **por tanimë pa asnjë konsensus, fare pak kohë para zgjedhjeve, dhe në disfavor të dukshëm përkundrejt të gjithë votuesve.**

Vetë përfshirja nga mazhoranca *a priori*, me detyrim, nën një regjim të ri rregullash përmes ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, përbën në vetvete cenim të parimit të sigurisë juridike.

Kjo pasiguri buron nga fuqia e drejtpërdrejtë që ka Partia Socialiste në rolin e organizatorit të procesit zgjedhor në cilësinë e përgjegjësisë si parti që ushtron qeverisjen e vendit, por edhe në rolin e konkurrentes në zgjedhjet e ardhshme. Gjithë kjo për arsye se, kjo parti, përmes Kuvendit të Shqipërisë, me rregulla të reja të padakordësuara, detyron tashmë që i gjithë procesi zgjedhor të mos zhvillohet me rregullat e dakordësuara bashkarisht në mënyrë konsensuale dhe gjithëpërfshirëse, por me rregulla të reja të urdhëruara në mënyrë të njëanshme nga një forcë politike garuese në zgjedhje (Partia Socialiste).

Gjithashtu, në Opinion e Përbashkët mbi Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë të miratuar nga Komisioni i Vencias dhe OSBE/ODIHR më 13 mars 2009, në lidhje me Kodin Zgjedhor të miratuar në vitin 2008, në paragrafin final të konkluzioneve, Komisioni i Venecias dhe OSBE/ODIHR konkludojnë se:

*“96. Sidoqoftë duhet të kujtohet se qëndrueshmëria e legjislacionit zgjedhor është e rëndësishme për besimin e publikut në procesin zgjedhor. Prandaj, ndryshimet duhet të ndodhin në të ardhmen vetëm kur është e nevojshme për të përmirësuar konformitetin e kornizës legislative me standardet ndërkombëtare, përndryshe duhet të shmangen.”<sup>50</sup>*

---

<sup>50</sup> Opinion no. 513/2009 (CDL-AD(2009)005), “Joint opinion on the Electoral Code of the Republic of Albania”, pika 96, shprehimisht citon: “96. It has however to be reminded that the stability of the electoral legislation is important for the public’s confidence in the electoral process. Amendments should therefore take place in the future when necessary to improve the conformity of the legislative framework with international standards, but should otherwise be avoided in principle.”

Mund ta konsultoni në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2009\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2009)005-e)

### 3. Pengimi i koalicioneve parazgjedhore, duke imponuar listën shumemërore të përbashkët dhe deformimi i votës

**Me ligjin nr. 118/2020, të miratuar në 5 Tetor 2020 bëhen ndryshime thelbësore në sistemin zgjedhor, që deformat dhe synojnë të kufizojnë mundësitë e partive politike për të garuar në formën e një koalicioni, ashtu siç deformat edhe mundësinë e tyre për t'u paraqitur para zgjedhësve me listat e tyre të veçanta të kandidatëve.**

Ky ndryshim, përmes përfshirjes së listës unike shumemërore të një koalicioni, duke kufizuar mundësitë e partive politike **të kenë secila listën e tyre, kufizon:**

- të drejtën e këtyre partive për të kandiduar personat e tyre,
- kufizon mundësinë e zgjedhjes së qytetarëve të partive që preferojnë; dhe
- kufizon mundësinë e zgjedhjes së qytetarëve mes sa më shumë kandidatëve.

Koncepti i koalicionit parazgjedhor të partive politike, me vullnet të shprehur për pjesëmarrje në zgjedhje, është formësuar nga populli në ligjin themeltar të shtetit - Kushtetutën, të cilin e ka miratuar përmes referendumit në vitin 1998. Në këtë proces referendar populli ka shprehur vullnetin e tij për mënyrën se si do të përfaqësohet e qeveriset, përmes votimit të një partie politike, pjesëmarrëse ose jo në një koalicion parazgjedhor.

Pra koncepti i koalicioneve parazgjedhore të partive politike ka lindur së bashku me lindjen e ligjit themeltar të shtetit. Ky koncept u shtjellua më tej në ligjin zgjedhor, ku pjesëmarrësi në koalicion parazgjedhor lejohet të konkurrojë me listat e partisë së tij në mënyrë të veçantë.

Partitë politike, në vitin 2003, kanë përcaktuar konceptin e listave shumemërore të cilat identifikojnë qartë vullnetin politik të secilës parti politike brenda një koalicioni. Ky është një model i njohur në doktrinën zgjedhore si “apparentement” dhe është përdorur dhe përdoret nga një numër vendesh europiane.

Në Dokumentin Parlamentar të datës 15.07.2020, “Raport për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, ku shpjegohet se relatorët mbështetën rekomandimet e ekspertëve konstitucionalistë<sup>51</sup>, faqe 11, citohet se: “[...] ***koalicioni parazgjedhor është mekanizëm apo teknikë elektorale*** atje ku është i parashikuar nga ligji, sikurse nuk ekziston atje ku nuk është i parashikuar nga ligji. Nëse bëjmë arsyetimin e kundërt: po të ishin pjesë e konceptit kushtetues të lirisë së organizimit, atëherë shtete demokratike që nuk i njohin dhe nuk i parshikojnë në legjislacionin e tyre zgjedhor [...], sot do

<sup>51</sup> Dokumenti Parlamentar të datës 15.07.2020, “Raport për projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, faqe 21. Mund të konsultohet në link-un: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200716145313Raport%20per%20ndryshimet%20Kushtetuese-16-7-2020.pdf>



*kishin një problem real me cenimin e lirive themelore. Në vlerësimin e ekspertit nuk ka asnjë cenim të të drejtave kushtetuese të partive politike, nëse preferohet që të mos ketë koalicione parazgjedhore.”*

**Kjo qasje nuk është aspak e vërtetë.** Koalicioni, në kuptim edhe të nenit 96, paragrafi 1, i Kushtetutës, është një koncept që është sanksionuar qartë në ligjin themeltar të shtetit. Dhe vetë Kushtetuta nuk ka si të parashikojë “taktika elektorale”, por vetëm parime, të drejta dhe liri themelore, për t`u organizuar sipas bindjes përkatëse në formacione politike dhe/apo për të garuar në zgjedhje. Çdo kufizim në këtë drejtim cenon direkt të drejtat dhe liritë politike, të njohura dhe të mbrojtura drejtpërdrejtë nga Kushtetuta.

Edhe pa marrë gjerësisht në analizë faktin e njohjes apo jo të “koalicioneve parazgjedhore” në nivel kushtetues, duhet theksuar se, liria e organizimit në vetvete, në funksion të një programi a zgjedhje politike për të qeverisur dhe për t`u qeverisur, është një e drejtë themelore e pamohueshme. Ashtu si partitë politike, koalicionet janë një formë organizimi e sistemit politik kushtetues në funksion të garimit demokratik në zgjedhje dhe të qeverisjes. Shtetasit shqiptarë kanë të drejtë të garojnë të vetëm, të organizohen në parti apo në kuadër të koalicioneve të partive.

Dy dispozitat më problematike të ligjit nr. 118/2020 lidhur me këtë kufizim, janë ato të **nenit 6** dhe të **nenit 7 të ligjit**, që bëjnë ndryshime përkatësisht në **nenet 65** dhe **67** të Kodit Zgjedhor.

#### **Konkretisht:**

- Në nenin 65, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

*“Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”*

- Në nenin 67, pikat 1 deri në 5, ndryshohen me këtë përmbajtje:

*“1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të tij për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendorë regjistrohen në KZAZ-në që mbulon*

*njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.*

*2. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 të këtij neni, lista e subjektit depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme.*

*3. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, ose kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. **Bën përjashtim nga ky rregull kryetari i partisë apo i partisë udhëheqëse të koalicionit, i cili në zgjedhjet për Kuvendin mund të regjistrohet deri në katër zona zgjedhore.** Pas shpërndarjes së mandateve sipas këtij ligji, ai nuk mund të zotërojë më shumë se një mandat, të cilin e zgjedh me vullnetin e tij të lirë.*

*4. **Emrat në listën shumemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një.** Numri i kandidatëve në listën shumemërore nuk mund të jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati.*

*5. Subjekti zgjedhor nuk mund të ndryshojë renditjen e kandidatëve të listës pas regjistrimit të saj. Kandidatët rirenditen vetëm në zbatim të procedurave të këtij ligji për përlllogaritjen e mandateve fituese **në bazë të votimit parapëlqyes dhe të plotësimin të kushtit ligjor për kuotën gjinore.***

Pra, këto ndryshime:

- 1) Qartazi synojnë të dobësojnë forcën e bashkimit të kampit opozitar, duke i kufizuar mundësitë të bashkëpunojnë dhe garojnë,** nën një program politik përballë qytetarëve, dhe me kandidatët respektivë të tyre. Kjo zgjedhje, veç të tjerave, duket se është bërë për të shkaktuar kundërvënie mes partive opozitare që duan të bëjnë koalicion parazgjedhor, pasi i kufizojnë ato duke i detyruar këto parti për të kandiduar me një numër të kufizuar të kandidatëve që duhet të propozojnë për listat zgjedhore brenda një liste të vetme të koalicionit. Ky lloj kufizimi, përkthehet në pakësim të mundësive që qytetarët të zgjedhin atë program politik të ofruar që mund të realizohet më mirë dhe më shpejtë nën një frymë bashkëpunimi mes partive.
- 2) Neni 65, pika 3,** e Kodit Zgjedhor, dispozitë kjo e ndryshuar me ligjin nr. 118/2020, që përcakton detyrimin për deklarimin e “**partisë udhëheqëse**”, përveçse një emërtim reminishencë e kohëve të shkuara fatkeqe të Shqipërisë, është një rregullim që bie në kundërshtim me Kushtetutën dhe nuk është në harmoni me ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar.

Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike. Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend.

Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta. **Ndaj detyrimi për të hequr dorë nga disa të drejta dhe detyrime, qoftë në marrëdhënie përfaqësimi, cenon hapur të drejtën e tyre jo vetëm për të përfaqësuar vullnetin e mbështetësve të tyre, por edhe mohon të drejtat dhe detyrimet e partisë pjesëtare në një koalicion për përmbushjen e të gjitha të drejtave që i garantohen nga parimi i zbatimit të një procesi të rregullt ligjor.**

Kjo do të thotë se, edhe në rast se një parti brenda koalicionit do të ketë pakënaqësi apo do të konstatojë shkelje në procesin elektoral të votimit apo numërimit, që mund të dëmtojnë interesat e saj, paraqitja e pretendimeve ankimore pranë KQZ-së apo Kolegjit Zgjedhor, **i mohohet dhe i lihet në dorë të vullnetit të “partisë udhëheqëse”, e cila mund të mos ketë interes në ndjekjen dhe shqyrtimin e këtyre pretendimeve.**

**Pikërisht kjo gjendje vret identifikimin politik të një partie, dhe nga ana tjetër, shuan të drejtën e partisë pjesë e koalicionit për t'u legjitimuar si palë iniciuese në një proces eventual ankimi administrativ apo gjyqësor ndaj veprimeve/vendimeve të administratës zgjedhore apo rezultatit të zgjedhjeve.**

- 3) Përfshirja e nocionit të “**votimit parapëlqyes**”, kombinuar enkas me disa ndryshime të tjera të paqarta të Kodit sa i takon mënyrës së numërimit të këtyre votave, sjell në vetvete **deformimin e votës së qytetarit.**

**Konkretisht**, ndërhyrjet e tjera në nenin 117 të Kodit Zgjedhor (përmes nenit 16 të ligjit nr. 118/2020), bën që nëse vota e votuesit të caktuar të jetë dhënë për njërin subjekt zgjedhor, por për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor, **vota të shpallet e pavlefshme.**

Vullneti i zgjedhësit nuk është gjithmonë i njëtrajtshëm si për kandidatin, ashtu dhe për forcën politike. Nëse vota është e lirë, është pikërisht tek fakti se ajo duhet të jetë e pandikuar, nga çdo lloj faktori.

Nëse me ligj urdhërohet se vota do të shpallet e pavlefshme nëse ajo nuk është unike si për forcën politike dhe për përkatësinë e kandidatit, atëherë këtu kemi të bëjmë me cenim të drejtpërdrejtë të lirisë së votës të mbrojtur nga neni 45 i Kushtetutës që parashikon se: *“Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”*

**Ky parashikim, së bashku me listat pjesërisht të hapura, bën që të ngurtësohen edhe më shumë mundësitë e zgjedhjes së votuesve, të cilët orientohen ndaj partive politike dhe kandidatëve të zgjedhur nga kryetari i partisë, dhe jo për kandidatët tek të cilët votuesi mund ta gjejë veten më mirë të përfaqësuar!**

**Një sistem i tillë përbën deformim të vullnetit të zgjedhësit dhe të parimeve demokratike të të qënurit i përfaqësuar.**

- 4) Ky qëllim del qartë edhe nga parashikimi i bërë në nenin 11, të ligjit nr. 118/2020, që përmes ndryshimeve në pikën 4, të nenit 98, të Kodit Zgjedhor, **imponon që në të njëjtën Fletë-Votimi, të gjendet hapësira si për subjektin zgjedhor, ashtu dhe për kandidatët.** Kjo për t'u siguruar që votat për subjektin zgjedhor/partinë, **të mos devijojnë edhe nga votat për kandidatët e po të njëjtit subjekt zgjedhor/partie.** Ndërkohë që hapësirë e panormuar dhe e gjerë mbi përcaktimin e mënyrës së votimit parapëlqyes, i lihet KQZ-së përmes kësaj dispozite.
- 5) Gjithashtu, kur partitë politike garojnë të vetme, nëse zgjedhësi zgjedh dy kandidatë në listën e partisë që konkuron pa koalicion, vota nuk vlen për asnjë prej kandidatëve por quhet e vlefshme për partinë. Ky rregull nuk parashikohet nëse partitë garojnë me listë të përbashkët. Nuk ka një parashikim se cilës parti të koalicionit do t'i njihet vota kur zgjedhësi ka votuar për dy kandidatë të listës së përbashkët, por që i përkasin partive të ndryshme.
- 6) Gjithashtu, rregulli i ri i parashikuar në nenin 67, pika 3, të Kodit Zgjedhor që përcakton se, **“kryetari i partisë apo i partisë udhëheqëse të koalicionit, i cili në zgjedhjet për Kuvendin mund të regjistrohet deri në katër zona zgjedhore”,** shkon në forcim të rolit të kryetarit të një partie, duke bërë që në të paktën 4 nga zonat zgjedhore ku do kandidojë ai, çdo votë e dhënë “pro” të konsiderohet si votë për kryetarin, duke sfumuar kështu tërësisht pozitën dhe forcën e kandidatëve të tjerë, që mund të jenë shumë herë më të pëlqyer nga votuesit.

Ky parashikim cenon parimin e barazisë dhe shkakton diskriminim, në shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 18 të Kushtetutës, pasi pozitës konkurrese të kryetarëve të partive i jepet një status *apriori* superior përkundrejt kandidatëve të tjerë.

**Kryetari i Partisë brenda një sistemi konkurrimi politik duhet të ketë të njëjta shanse dhe të njëjta mundësi për t'u përballur me kandidatët e tjerë. Krijimi i këtij favoriti për t'u shfaqur në listën e 4 (katër) zonave zgjedhore të ndryshme e bën atë më shumë të dallueshëm, dhe me status dominues përkundrejt kandidatëve të tjerëve, si konkurrentë ashtu dhe brenda forcës politike apo koalicionit që ai udhëheq, status ky të cilin Kuvendi ja jep me pa të drejtë me këto ndryshime në Kodin Zgjedhor.**

Ky rregull përjashtimor nuk gjen mbështetje në asnjë logjikë juridike, demokratike apo politike, dhe krijon një pozitë favorizuese për vetë kryetarin e mazhorancës.

Për më tepër, ky rregull **bie ndesh edhe me rekomandimet e Komisionit të Venecias**, që parashikime të tilla për pozitën e trajtimit preferencial të kryetarëve të partive, i ka quajtur që në vitin 2009, **si zhvillime negative në dhunim të parimeve të barazisë dhe mos diskriminimit.**

Komisioni i Venecias ka vlerësuar dhe rekomanduar se, **trajtimi i veçantë i kryetarëve të partive politike në ushtrimin e të drejtës së kandidimit** (si e drejta për të kandiduar njëkohësisht në më shumë se një zonë zgjedhore) **është në kundërshtim me standardet europiane dhe ndërkombëtare**<sup>52</sup>.

Për më tepër, shfaqja e kryetarit të partisë në listat e katër zonave zgjedhore njëkohësisht, jep më shumë fuqi politike qoftë për forcën politike, ashtu dhe për kandidatët e asaj partie politike në këto 4 zona zgjedhore.

Pas çdo diskriminimi “pozitiv” për kryetarët e partive, qëndron në anën tjetër një diskriminim negativ për anëtarët e forcës politike dhe për qytetarët që votën e tyre duhet t’ia japin subjektit/personit që besojnë dhe ndiejnë se i përfaqëson më mirë, dhe jo t’ia “dhurojnë” partisë që *“di gjithmonë kush është më e mira për ta”* e që abuzon me përfshirjen në lista të kandidatëve për deputetë, të cilëve **u falet/dhurohet kështu mandati nga Kryetari i Partisë në këmbim të bindjes vetëm ndaj vullnetit të tij.**

**Këta lloj deputetësh me mandate “të falur”, nuk do të kenë më, si gjithmonë, asnjë lidhje me elektoratin, qoftë ai elektorat i partisë. Dhe nuk kanë se si ta përfaqësojnë elektoratin në vendimmarrje përmes ngritjes së kartonave “pro” apo “kundër” në sallën e Parlamentit.**

Këto ndryshime deformatojnë sistemin e përfaqësimit të vullnetit të popullit. Janë në shkelje të **neneve 2, 3, 15, 18, 45, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi çojnë në mungesë llogaridhënie të deputetëve përballë qytetarëve votues.**

---

<sup>52</sup> Opinion no. 513/2009 (CDL-AD(2009)005), “Joint opinion on the Electoral Code of the Republic of Albania”, pika 18 dhe 19, shprehimisht citon:

***“Special Treatment for the Chairpersons of Political Parties***

*18. In a negative development, a new provision grants special candidacy rights to the chairpersons of political parties. To protect the candidacies of political party chairpersons, the Code allows the chairpersons of political parties – and chairpersons only – the right to run on the political party’s list in each of the twelve electoral zones for the National Assembly. This special treatment for the chairpersons of political parties violates the fundamental principle of equality and of non-discrimination.*

*19. The special treatment granted to the chairpersons of political parties in the exercise of candidacy rights appears to be contrary to international and European standards. The Venice Commission and the OSCE/ODIHR recommend that Article 67(3) of the Code be amended to respect the fundamental principles of equality and non-discrimination.”*

Mund ta konsultoni në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2009\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2009)005-e) ,

Pasojat e një mungese të tillë llogaridhënieje qytetarët shqiptarë po i ndiejnë edhe sot, në atë Kuvend të paplotë e të njëanshëm që ka ngritur 97 vota “pro” për të ndryshuar rregullat zgjedhore pa konsensus **vetëm 5 muaj përpara zhvillimit të fushatës zgjedhore, dhe që qartazi të favorizohen edhe ata deputetë ilegjitimë që mandatin po e shfrytëzojnë pa marrë ndonjëherë ndonjë votë “pro” nga ndonjë qytetar i këtij vendi, për atë që përfaqësojnë këta individë.**

**4. Ndryshimet e bëra përmes nenit 8 të ligjit nr. 118/2020, janë parashikime që favorizojnë deputetë aktualë ilegjitimë, për votën e tyre të dhënë në 5 tetor për forcimin e pozitës së mazhorancës aktuale, dhe krijojnë vështirësi të panevojshme për partitë e tjera politike**

**Ndryshimi i bërë përmes nenit 8, të ligjit nr. 118/2020, në nenin 68, të Kodit Zgjedhor, synon që pika 3 e këtij neni të lexohet dhe të zbatohet sipas kësaj përmbajtjeje:**

“Neni 68

***Listat mbështetëse të partive politike dhe koalicioneve***

*1. Listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten **nga jo më pak se 5 000 zgjedhës në shkallë kombëtare**. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se **7 000 zgjedhësve në shkallë kombëtare**. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.*

*2. Kandidatët për organet e njësisë së qeverisjes vendore, të paraqitur nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose në organet e njësisë përkatëse të qeverisjes vendore, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1 për qind e zgjedhësve të asaj njësie, por, në çdo rast, jo më shumë se 3 000 dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit, ose kur zotërojnë bashkërisht në këshillin përkatës një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.*

*3. Për qëllim të këtij neni, partia politike ose koalicioni paraqet **një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit** apo njësia e qeverisjes vendore, **ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës**”.*

Pra, me këtë ndryshim, është e qartë që jo vetëm favorizohen deputetët e “opozitës” që kanë marrë mandatet pa ndjekur procedurat përkatëse kushtetuese dhe ligjore pas dorëheqjes në bllok nga mandatet të deputetëve të opozitës, por një parashikim i tillë **përbën një pengesë serioze** jo vetëm për partitë opozitare që ndodhen jashtë parlamentit, që përbëjnë opozitën e vërtetë, por edhe për forcat e reja politike që dëshirojnë të hyjnë në jetën politike të vendit.

**Këto forca politike tashmë do të duhet të ndjekin në mënyrë arbitrare procedura për të vërtetuar se kanë mbështetjen e një numri të caktuar zgjedhësish në shkallë kombëtare, ndërkohë që këta deputetë që ndodhen aksidentalisht sot në Kuvend dhe që votuan pro ndryshimeve të njëanshme të 5 tetorit 2020, do të duhet të paraqesin vetëm një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit (pra nga Sekretari i Përgjithshëm), me praktikat e kundraligjshme të të cilit po këta shtetas u bënë deputetë në kundërshtim me Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe Rregulloren e Kuvendit.**

Pra ata deputetë që votuan ligjin nr. 118/2020, sipas vullnetit të qeverisë dhe Kryeministrit Kryetar Partie Edi Rama, e që realisht nuk kanë patur mbështetje direkte elektorati për një mandat deputeti, do të pajisen me një vërtetim Kuvendi, pasi të vetëdeklarohen në një parti politike, dhe do të mund të garojnë lirisht në zgjedhje.

**Ky moment i shkëmbimit të votës “pro” vullnetit të Kryeministrit, duke e shpërblyer me një kusht favorizues, mund të duket si një kompromis politik brenda procesit legjislativ, por në realitet është tregues se si procesi ligjvënës është prekur nga fenomeni i korrupsionit legjislativ. Ky është rasti tipik kur përmes parashikimeve ligjore synohet t`i hapet rruga përfitimeve për qëllime personale të njëanshme partiake. Raste të tilla duhet të hetohen penalisht.**

Kjo mënyrë e keqpërdorimit dhe shpërdorimit të një mandati të marrë në mënyrë antikushtetuese, është ngjarja më e shëmtuar në reformën zgjedhore.

**Ky parashikim, jo vetëm që përbën diskriminim dhe trajtim të pabarabartë për opozitën e vërtetë jashtëparlamentare, por edhe pengesë serioze për ta në procesin zgjedhor për Kuvendin, të planifikuar për t`u mbajtur në datë 25 prill 2021.**

**5. Trajtim i pabarabartë në mënyrën e deklarimit të trajtimit të dhurimeve, huave dhe kredive, si një pengesë më shumë për koalicionet parazgjedhore**

Neni 90 i Kodit Zgjedhor, ishte një ndër nenet që u ndryshua si pasojë e kodifikimit të Marrëveshjes së 5 Qershorit dhe u miratua përmbajtja e kësaj dakordësie me ligjin nr. 101/2020 në datën 23 Korrik 2020.

Ky nen përcaktoi qartë mënyrën e trajtimit të dhuratave, huave dhe kredive. Konkretisht, në pikën 2 të nenit 90, u përcaktua se:

*“2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, dhurimet në vlera monetare, në natyrë apo në formën e shërbimit që u jepen kandidatëve të subjekteve zgjedhore, si dhe huatë ose kredite e marra nga kandidatët për financimin e fushatës konsiderohen si kontribute për*

*partinë politike për të cilën ata kandidojnë. Për kandidatët e propozuar nga koalicionet, partitë politike pjesëmarrëse në koalicion përcaktojnë në marrëveshjen për krijimin e koalicionit se cila parti do të deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit.*

Tashmë bëhet një ndryshim tepër i paqartë në këtë dispozitë, përmes nenit 10 të ligjit nr. 118/2020, duke shfuqizuar fjalinë e dytë të pikës 2, të këtij neni. Kjo fjali që synohet të shfuqizohet, parashikonte se:

*“Për kandidatët e propozuar nga koalicionet, partitë politike pjesëmarrëse në koalicion përcaktojnë në marrëveshjen për krijimin e koalicionit se cila parti do të deklarojë të ardhurat dhe shpenzimet e kandidatit.”*

Pra, me shfuqizimin e këtij parashikimi, synohet të krijohet edhe një pengesë më shumë për krijimin e koalicioneve parazgjedhore, përmes nxitjes së mosmarrëveshjeve mes partive edhe për çështjet e koordinimit të informacionit nga kandidatët dhe ekspozimit të tyre ndaj penalteteve, për shkak të raportimeve të kandidatit të propozuar nga një prej partive pjesë e koalicionit.

Një parashikim i tillë nuk është në përputhje as me vetë dispozitat e ndryshuara e miratuara me ligjin nr. 118/2020, që në nenin 6 të tij, përmes pikës 3 që shton në nenin 65, sanksionon se:

*“[...] Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit.”*

Pra, duke harruar se çfarë është përcaktuar në dispozitat më sipër të ligjit, përmes ndërhyrjes që bëhet me nenin 10 të ligjit nr. 118/2020, evidentohet edhe një herë më shumë nevoja për të ndërhyrë e për të krijuar apo për t'i shtuar çdo pengesë të mundshme për mosfunksionimin e koalicioneve parazgjedhore.

Nëse të drejtat dhe detyrimet i mbart partia udhëheqëse e koalicionit, atëherë çdo lloj rregullimi brenda koalicionit në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisive, duhet të lihet në vullnetin e tyre të lirë, sipas marrëveshjeve përkatëse.

## **6. Synimi për të ndikuar në pavarësinë dhe paanësinë e Kolegjit Zgjedhor, për kapjen politike të tij**

Pjesë e Marrëveshjes së 5 qershorit, që u formalizua me ndryshimet e bëra në Kodin Zgjedhor në 23 korrik 2020, me ligjin nr. 101/2020, ishin dhe rregullimet mbi Kolegjin Zgjedhor. Në këtë marrëveshje, u arrit dakordësia e plotë për riformulimin tërësor të nenit 149 të Kodit Zgjedhor, që përmbante dispozitën e “Mbrotjtjes së gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor”.



Si mbrojtje e gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, është patjetër paprekshmëria e tyre gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor. Kjo dispozitë, parashikoi në funksion të këtij qëllimi, në pikën 1, të saj se:

*“1. Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor **nuk mund:***

*a) t'i nënshtrohet hetimit apo procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar Kolegji;*

*b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe disiplinore, **organizimi gjyqësor apo ngritje në detyrë;***

*c) të vlerësohet “i pamjaftueshëm” për aftësitë profesionale të gjyqtarit dhe etikën/ angazhimin ndaj vlerave profesionale të gjyqtarit.”*

Si formë presioni dhe ndikimi ndaj paanshmërisë, objektivitetit dhe pavarësisë së gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, është jo vetëm ndalimi i nënshtrimit të tyre ndaj hetimit a procedimit disiplinor, apo transferimi e vlerësimi i tyre negative në detyrë, **por një formë që mund të paraqesë rrezik për “kapjen” apo ushtrimin e ndikimit ndaj tyre, është dhe “ngritja në detyrë”.**

Ky parim kaq i rëndësishëm, i paanshmërisë dhe pavarësisë së anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor, parim i mbrojtur posaçërisht nga Zotimet ekzistuese për zgjedhje demokratike në shtetet pjesëmarrëse në OSBE, apo Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore<sup>53</sup>, cenohen rëndë përmes shfuqizimit të bërë në dispozitën e sipërcituar të togfjalëshit **“apo ngritje në detyrë”.**

Pra, nëse një ndikim direkt përmes masave penalizuese do të ishte shumë i zhurmshëm dhe i vështirë për t'u fshehur para opinionit publik, tashmë mazhoranca e vetme qeverisëse ka mundësuar një zgjidhje më të qetë e të lehtë: **atë të kapjes së gjyqtarëve të Kolegjit Zgjedhor, përmes propozimeve për ngritjen në detyrë.**

Rikujtojmë se, posaçërisht për këtë ndryshim, është **investuar vetë ministrja e Drejtësisë, që i është drejtuar Kuvendit pikërisht për të ndryshuar nenin 149 të Kodit Zgjedhor<sup>54</sup>, për të justifikuar shkeljen e parimit themelor për zgjedhje demokratike: atë të një sistemi të efektshëm ankimi.**

Zotimet ekzistuese për zgjedhje demokratike në shtetet pjesëmarrëse në OSBE<sup>55</sup>, në pikën 10.1, kanë përcaktuar se:

---

<sup>53</sup> Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un:

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2002\)023rev2-cor-alb](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2002)023rev2-cor-alb)

<sup>54</sup> Ky informacion është marrë nga mediat e shkruara dhe elektronike, ndërkohë që kërkesën zyrtare e administron vetë Kuvendi. Një ndër linq-et e lajmit: <https://gazetamapo.al/pengohet-procesi-i-gjykates-se-larte-gjonaj-kerkese-kuvendit-per-ndryshimin-e-nenin-149/>

<sup>55</sup> Mund ta konsultoni edhe në shqip në link-un: <https://www.osce.org/odihr/elections/13957>

*“10.1 Shtetet pjesëtare në OSBE “solemnisht deklarojnë se në mesin e atyre elementeve të drejtësisë që janë qenësore për shprehjen e plotë të dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë qenieve njerëzore janë si vijon: ... të gjithë do të kenë një mjet efektiv për t’u ankuar kundër vendimeve administrative, në mënyrë që të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe të sigurohet integriteti ligjor; vendimi administrativ kundër një personi duhet të jetë plotësisht i justifikuar dhe duhet si rregull të tregojë mjetet juridike të zakonshme në dispozicion; dhe **duhet të sigurohet pavarësia e gjyqtarëve dhe veprimeve të paanshme të shërbimit publik gjyqësor**”.*

Gjithashtu, Raporti Përfundimtar I OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e votimeve të 30 qershorit 2019, në rekomandimin prioritar nr. 5 shprehet:

*“Të gjitha gjykatat që kanë kompetencë në fushën e zgjedhjeve duhet të jenë plotësisht funksionale gjatë periudhave zgjedhore. **Duhet të garantohen pavarësia dhe paanshmëria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e gjyqësorit.**”*

Ndërkohë, në kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, sipas asaj që është bërë publike në media, ky ndryshim kërkohej pasi:

*“Këshilli i Lartë Gjyqësor është duke përmbyllur procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, nëpërmjet ngritjes në detyrë të gjyqtarëve që plotësojnë kushtet për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë. Një pjesë e kandidatëve që kanë paraqitur kërkesën për t’u ngritur në detyrë në këtë gjykatë janë zgjedhur, nëpërmjet shortit, si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor. Në këtë mënyrë, pavarësisht vullnetit të tyre, për shkak të parashikimit të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 149 të Kodit Zgjedhor, këtyre gjyqtarëve i ndalohej vijimi i procedurave për ngritjen në detyrë. Nga ana tjetër, për Këshillin e Lartë Gjyqësor krijohen vështirësi për përzgjedhjen e kandidatëve në Gjykatën e Lartë për shkak të uljes së numrit të kandidatëve që mund të aplikojnë për ngritjen në detyrë. [...]”*

Lidhur me këtë çështje, është për t’u evidentuar se, angazhimi dhe kërkesat zyrtare të Presidentit të Republikës në adresë të Këshillit të Lartë Gjyqësor për plotësimin sa më shpejt **me 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarë** të Gjykatës së Lartë kanë qenë të përsëritura dhe në mënyrë të vazhduar që prej muajit qershor 2019. Për të gjitha këto kërkesa të Presidentit të Republikës, janë informuar edhe partnerët ndërkombëtare. Ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor, edhe pse po mbush dy vite nga konstituimi i tij, me zvarritje të pajustificueshme, deri më tani ka propozuar për emërim në Gjykatën e Lartë vetëm **3 (tre) kandidatë** nga radhët e juristëve të spikatur në datën 5 mars 2020, të cilët u emëruan menjëherë nga Presidenti i Republikës në datën 10 mars 2020. E megjithë këtë situatë shqetësuese, **ky qëndrim i ministres së Drejtësisë, duket të jetë dhe reagimi i parë publik i një anëtari të kabinetit qeveritar për funksionimin e Gjykatës së Lartë.**

**Dhe ky reagim bëhet vetëm për efekt të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor.**

Nga ana tjetër, duhet theksuar se Këshilli i Ministrave, pjesë e të cilit është edhe ministrja e Drejtësisë, me vendimin nr. 563, datë 15.07.2020<sup>56</sup>, ka **dhënë mendim dhe ka votuar në favor të projektligjit për ndryshimet në Kodin Zgjedhor**, i cili përfshin edhe dakordësinë për dispozitat për Kolegjin Zgjedhor, të votuara në 23 korrik 2020. Në këtë moment, Këshilli i Ministrave dhe vetë ministrja e Drejtësisë, duket se nuk ka ngritur ndonjë shqetësim për parashikimin në projektligj të rregullit mbi ndalimin e ngritjes në detyrë të anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor. **Ky pëlqim është dhënë më pak se tre muaj para se ministrja e Drejtësisë të bënte këtë propozimin të ri, për shfuqizimin e këtij parashikimi.**

**Pra, qartësisht propozimi për ndryshimin e garancisë për pavarësinë e Kolegjit Zgjedhor, ka si qëllim mbajtjen nën trysni të anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor, dhe jo shqetësimin për plotësimin e Gjykatës së Lartë.**

KLJG-ja ende nuk ka përfunduar procedurat e verifikimit dhe vlerësimit për plotësimin e **15 anëtarëve të tjerë** të kësaj gjykate ku përfshihet dhe pozicioni i 4 (katërt) në Gjykatën e Lartë, që duhet të plotësohet nga radhët e juristëve të spikatur, procedurë kjo që po mbush 13 muaj dhe nuk është finalizuar ende.

Referuar kësaj gjendje dhe vonesave të pajustificuara të procedurave të ndjekura nga KLJG për plotësimin e vendeve vakant në Gjykatën e Lartë, parashikimi i ndryshimit të nenit 149 të Kodit Zgjedhor, që nga ana tjetër garanton procesin e zgjedhjeve të lira e demokratike, **nuk mund të konsiderohet si pengues në plotësimin e Gjykatës së Lartë.**

Edhe nëse fakti që disa aplikantë të zgjedhur me short si anëtarë të Kolegjit Zgjedhor, kanë aplikuar për t'u bërë anëtarë të Gjykatës së Lartë, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, atëherë Kuvendi duhet të sigurohet që përmes kësaj ndërhyrjeje të sigurojë zgjidhjen vetëm të kësaj pengese dhe përfundimin menjëherë të procedurave respektive nga KLJG, dhe jo të ndërmerre këtë nisëm shfuqizuese, **duke lënë kështu një shteg të hapur për aplikim në vijimësi të këtij rregulli që anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor, t'u ofrohet në vijimësi promovim në karrierë si shpërblim për qëndrimin që ata duhet të mbajnë.**

\* \* \* \* \*

---

<sup>56</sup><https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-08-korrik-2020-2/>

### **XIII. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor përmes Ligjit nr.118/2020, nuk realizojnë zhvillimin e një procesi zgjedhor përmes listave tërësisht të hapura siç u premtua**

Me ndërhyrjet e bëra dhe manipulimet e formulimeve të dispozitave konkrete, kryetari i mazhorancës ruan të njëjtën pozitë dominuese të përcaktimit të listave për kandidatë për deputetë dhe përzgjedhjes së të preferuarve prej tij.

Në këtë mënyrë, të gjitha ndryshimet e realizuara ruajnë pozitën kontrolluese të kryetarëve të partive, ç'ka tregon dhe një herë se kushti i vendosur nga ajo pjesë e opozitës parlamentare se dëshirojnë të realizojnë një proces zgjedhor, **ku deputetin e zgjedh populli dhe jo Kryetari i Partisë, nuk është realizuar.**

Vullneti i disa deputetëve opozitarë në Kuvend për implementimin e listave të hapura **u keqpërdor me dashje** nga Kryeministri Rama, për të tërhequr votën për ndryshimet Kushtetuese të 30 korrikut për përjashtimin nga konkurrimi të koalicioneve zgjedhore me listat e partive të tyre të partive opozitare, ndërkohë që “u ofroi” atyre (deputetëve opozitar në Kuvend) mbështetjen e propozimit për të siguruar një konkurim me lista të hapura.

Pra mundësia e konkurrimit me lista të hapura dhe votë parapëlqyese qytetare ekziston sot në Kushtetutë në nenin 64 sipas ndryshimeve të miratuara në 30 korrik 2020, ndërkohë që në Kodin Zgjedhor kjo e drejtë është manipuluar përmes dispozitave *ambigue* dhe jo lehtësisht të kuptueshme.

Diskutimi politik dhe publik për listat e hapura vjen si reflektim i nevojës së perceptuar nga publiku për ndryshimin e mënyrës së përzgjedhjes së kandidatëve nga kryetarët e partive politike.

Pavarësisht se pa konsensus politik, në datën 30 korrik 2020, u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë ndryshimi i pikës 3, të nenit 64 të Kushtetutës. U parashikua në këtë ndryshim që, listat të jenë të hapura në jo më pak se 2/3 e tyre. Kjo do të thotë që, në ligjin zgjedhor do të duhej të materializohej ky parashikim kushtetues në përputhje me paragrafin 3, të nenit 64 të Kushtetutës.

Pra, nga formulimi i fjalisë së fundit të paragrafit 3 të nenit 64, kërkohet që, për bërjen efektive të votës parapëlqyese, **së paku 2/3 e listës të zgjidhen direkt përmes shumatores së votave që merr një kandidat në atë listë, pa u kushtëzuar nga renditja e tij me rend shifror në atë listë.**

Ndërkohë që ky nocion kushtetues, është përmbysur në Kodin Zgjedhor me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 118/2020, që parashikon **një metodologji për votimin dhe shpërndarjen e mandateve brenda listës, njësoj si në rastin kur lista është e mbyllur.**

Nga interpretimi i nenit 64, paragrafi 3, i Kushtetutës, kërkohet që të paktën 2/3 e listës së kandidatëve për deputetë t'i nënshtrohen votimit parapëlqyes, por duke respektuar kuotën ligjore gjinore.

Në Kod nuk duhet të kishim rend shifror dhe orientimin e votës së votuesit drejt renditjes që i ka bërë kandidatëve kryetari i partisë. Kjo sepse rendi shifror, në traditën e deritanishme, ka qënë i përcaktuar nga vullneti i kryetarit të partisë, që krahasuar me numrin e votave në rang qarku, përcaktonte se deri në cilin numër të listës së kandidatëve, votat e siguruara do të përktheheshin në mandate deputeti në Kuvendin e Shqipërisë.

Vetë renditja me numër shifror, orienton votuesin se cili është kandidati më i rëndësishëm. Ndërsa metodologjia e shpërndarjes së votave në këtë mënyrë, është tregues i qartë i zhvlerësimit të votës, në raport me renditjen në listë.

Koncepti i **listave të hapura** (vota parapëlqyese si elementi i vetëm që kushtëzon renditjen e kandidatëve) nënkupton që shpërndarja e mandateve fillon nga kandidati që ka marrë më shumë vota.

Ndërsa sipas nenit 163, pika 2, e Kodit Zgjedhor (*edhe ky një nen i ndryshuar me ligjin nr. 118/2020*), renditja në listë është element kyç për të marrë një mandat, pavarësisht numrit të votave parapëlqyese.

Një mënyrë e tillë e shpërndarjes së mandateve, që nuk përputhet me numrin direkt të votave të marra nga një kandidat, bie ndesh me paragrafin 4, të nenit 45, të Kushtetutës, që sanksionon se: *“Vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”*

Kjo mënyrë e shpërndarjes së mandateve, bën që **vota të mos jetë më e barabartë** dhe të mos sigurojë përfaqësimin real të votuesve, që edhe pse mund të japin një numër të konsiderueshëm votash për një kandidat të caktuar, ky i fundit të mos arrijë dot të marrë një mandat, pikërisht për shkak të renditjes së tij në listë.

Pikërisht këtë shtrembërim dhe zhvlerësim të votës, por edhe të rregullit kushtetues, mazhoranca ka arritur ta realizojë përmes dispozitave shumë të paqarta të nenit 163, riformuluar me ligjin nr. 118/2020.

**Këto dispozita, në mënyrë të kamufluar e me mungesë të theksuar qartësie, kanë arritur të realizojnë qëllimin politik të vijimit të praktikës me lista pjesërisht të hapura, ku vullneti i kryetarit të partisë, kombinuar edhe me prezencën e tij për konkurrim në listat e 4 zonave zgjedhore njëherësh, është sërish përcaktues për fitimin e mandatit të deputetit.**

\* \* \* \* \*

#### **XIV. Konkluzione dhe përfundime**

Kushtetuta jonë parashikon qartë se e drejta themelore për të zgjedhur dhe respektimi i parimit të pluralizmit politik, janë bazat e funksionimit të shtetit tonë, dhe secili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë këto parime.

Sipas nenit 1, pika 3, e Kushtetutës, **“qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme e periodike”**.

Nga ana tjetër, neni 45 i Kushtetutës parashikon se: *“çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet”*.

Koncepti kushtetues “të zgjedhë” apo “të zgjidhet”, nuk duhet të shihet dhe nuk mund të konsiderohet i përmbushur vetëm në aspektin formal të mundësisë së pjesëmarrjes së qytetarëve në votime.

Koncepti kushtetues që çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë “të zgjedhë” apo “të zgjidhet” është i lidhur ngushtë me **mundësinë efektive të qytetarëve për të zgjedhur alternativën më të mirë që u ofrohet**.

Presidenti i Republikës, ka detyrimin që të mbrojë dhe respektojë pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës, ku sanksionohet se: *“organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*.

Në këto kushte, kur ndryshimet ligjore të njëanshme që tentojnë të ndryshojnë rregullat themelore zgjedhore kur ka filluar procesi parazgjedhor dhe na ndajnë 5 muaj nga zhvillimi i fushatës zgjedhore, e mund të bëhen shkak që të cenohet ushtrimi efektiv i të drejtave kushtetuese të qytetarëve, Presidenti i Republikës ka detyrimin kushtetues që të kontribuojë në rivendosjen dhe realizimin e këtyre të drejtave, duke ndërmarrë çdo akt, apo masë proporcionale për rregullimin e situatës së krijuar.

**Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndër të tjera, përcakton qartë detyrimin kushtetues për mbrojtjen e pluralizmit politik nga të gjithë. Kjo nënkupton jo vetëm ekzistencën e partive të ndryshme politike, por edhe mundësinë e tyre reale për të konkurruar, përfshirë partitë e vogla që duhet të kenë mundësi të barabarta për të përfaqësuar elektroatin që përfaqësojnë me programin e tyre politik.**

**Të gjitha forcat politike dhe partitë duhet të kenë mundësinë që të konkurrojnë dhe që vota e tyre të konvertohet objektivisht në mandate sipas votave të marra në kushte të barabarta dhe pa pengesa, në zgjedhje të lira dhe të ndershme, si mundësia e vetme për të respektuar të drejtën kushtetuese të qytetarëve shqiptarë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.**

Ndryshimi i njëanshëm i rregullave themelore për zgjedhjet, bën që të cenohen ndër të tjera, edhe parimi i konkurrimit të lirë, parim ky për të cilin Gjykata Kushtetuese ka bërë një arsyetim shterues në vendimin nr. 32/2010.

Kjo nënkupton se ato dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje, por me kushtin që të garantohet liria e të gjithë qytetarëve për të votuar të lirë, si dhe konkurrim i lirë i të gjitha forcave politike, në përputhje me parimet kushtetuese dhe rregullat e mirëpërcaktuara ligjore.

Është detyrë e të gjitha organeve shtetërore që ta mundësojnë këtë, në respekt të parimit të pluralizmit, me fokus të veçantë respektimin efektiv të së drejtës për të zgjedhur.

**Miratimi i këtyre ndryshimeve të njëanshme, pa dialog dhe konsensus, e mbi të gjitha duke ndryshuar rregullat pas përcaktimit të datës së zgjedhjeve, shumë afër kësaj date (25 prill 2021), do të jetë një shkak më shumë për bllokimin e procesit të integritetit të vendit në Bashkimin Europian, do të minonte çdo mundësi për çeljen e negociatave dhe përmbushjen e kriterit kryesor të Kopenhagës për zgjedhje të lira dhe të ndershme, si dhe do të dëmtonte imazhin e Republikës së Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe si kryesues i OSBE-së përgjatë vitit 2020, kur për vetë OSBE-në çështjet e standardeve zgjedhore janë thelbësore.**

Më duhet t'ju risjell për të disatën herë në vëmendje një prej angazhimeve themeltare që Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë në vitin 2006 me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, marrëveshje kjo e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, dhe ku përcaktohet qartë se për nënshkrimin e kësaj marrëveshje është mbajtur parasysh:

*“Angazhimi i palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumëpartiak me zgjedhje të lira e të ndershme”.*

Por përkundër këtij angazhimi për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, të cilat janë kriter kryesor i Kopenhagës, rezulton se në Shqipëri, nën kushtet aktuale, për mungesë përgjegjshmërie të Kryeministrit, dhe në thyerje të të gjitha standarteve europiane, **vendi po shkon drejt zgjedhjeve ku rregullat e konkurrimit favorizojnë partinë e tij në pushtet.**

Ndryshimet në sistemin zgjedhor në vitin 2008, që u bënë për interesa të partive të mëdha, sollën dobësimin e vazhdueshëm të rolit të qytetarëve në qeverisje. Ky ndryshim, edhe pse u bë pa dakordësinë e një numri të madh të partive politike, sërish nuk i ngjason aspak kësaj ndërhyrjeje që sot u bë në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor, ku Kryeministri shmangu tërësisht dialogun mes forcave politike opozitare dhe mazhorancës qeverisëse, dhe shkeli marrëveshjen e arritur midis tyre.

Në atë kohë, përzgjedhja e modelit spanjoll elektoral, proporcional rajonal, siç u përshtat në legjislacionin e brendshëm, nisi të jepte **goditjen e madhe për partitë e vogla**, duke i përjashtuar nga përfaqësimi në Parlament. Kjo, e kombinuar me fuqizimin e pozitës së kryetarëve të partive, tkurrjen e kompetencave të organeve kushtetuese apo të pavarura, si dhe kufizimin deri në **pamundësimin e aplikimit të referendumeve nga populli për çështje me rëndësi, ka sjellë mungesë përfaqësimi dhe një Parlament që sa vjen e dobësohet, e varet gjithnjë e më shumë nga ekzekutivi.**

**Ky nuk është vullneti i sovranit i shprehur me referendumin e vitit 1998. Pasi në të dyja herët, në vitin 2008 dhe 2020, Kushtetuta e Shqipërisë ndryshon jashtë vullnetit të drejtpërdrejtë të shprehur nga populli përmes referendumit.**

Ndërsa në dy ndryshimet e rregullave themelore zgjedhore, si në vitin 2008 dhe 2012, edhe pse kanë qënë ndryshime të bëra me dialog të pjesshëm, përsëri është kërkuar opinionin dhe certifikimi i këtyre ndryshimeve nga Komisioni i Venecias<sup>57</sup>. Ndërsa këtë herë, jo vetëm që nuk është kërkuar ky opinion, jo vetëm që janë bërë këto ndryshime të njëanshme në sistemin zgjedhor shumë vonë dhe shumë afër datës së zgjedhjes, por është refuzuar dhe kërkesa e opozitës për marrjen e mendimit dhe asistencës së OSBE/ODIHR.

Nëse mazhoranca qeverisëse do të kishte një vullnet të sinqertë për të realizuar një reformë zgjedhore sipas rekomandimeve të OSBE/ODIHR dhe standardeve ndërkombëtare, do të duhej që gjatë shqyrtimit në Komisionin e Reformës Zgjedhore, pse jo dhe pas konstituimit të Këshillit Politik, t'i ishte drejtuar si OSBE/ODIHR, ashtu dhe Komisionit të Venecias për marrjen e një opinionin për të gjithë masat shtesë që ajo (mazhoranca) dëshironte të realizonte në rregullat zgjedhore. **Ky veprim nuk u krye, duke mos respektuar as kërkesat e shprehura të Opozitës së Bashkuar.**

Pikërisht për këto arsye, që konstatojnë faktin se këto ndryshime të shpejta, të padialoguara dhe të pa dakordësuara, vetëm pak muaj para datës së zgjedhjeve, cenojnë jo një, por disa parime dhe të drejta kushtetuese, ashtu si dhe standardet, angazhimet dhe praktikën e mirë zgjedhore europiane; në mungesë të Gjykatës Kushtetuese funksionale; dhe në respektim të kërkesës zyrtare që më është paraqitur nga Kryetari i Opozitës së Bashkuar për marrjen e një opinionin pranë Komisionit të Venecias, **si President i Republikës, në datën 21 tetor 2020, i jam drejtuar me një kërkesë urgjente Komisionit European për Demokraci përmes Ligjit (Komisionit të Venecias) për një opinion të specializuar dhe objektiv mbi këtë proces.**

---

<sup>57</sup> Kujtojmë këtu dy Opinionet e Komisionit të Venecias:

1) Opinion no. 513/2009 (CDL-AD(2009)005), "Joint opinion on the Electoral Code of the Republic of Albania". Mund ta konsultoni në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2009\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2009)005-e)

2) Opinion no. 641/2011 (CDL-AD(2011)042), "Joint Opinion on the Electoral Law and the electoral practice of Albania". Mund ta konsultoni në link-un: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2011\)042-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2011)042-e)



Presidenti i Republikës vlerëson se, pas kthimit në Kuvend të ligjit nr. 118/2020, mazhoranca duhet të reflektojë duke rishikuar qëndrimin e saj mbi këto rregulla të reja, dhe të sigurojë opinionin final nga Komisioni i Venecias, duke thirrur njëkohësisht dialogun gjithëpërfshirës përmes Këshillit Politik.

Presidenti i Republikës ka bindjen se, me autoritetin e tij kushtetues, nëpërmjet këtij akti do të kontribuojë për ndërtimin e një shteti të së drejtës, demokratik e social për të garantuar një të drejtë themelore të njeriut, siç është e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Mbetem me besimin që, përmes këtij Dekreti, Presidenti i Republikës po krijon hapësirën e nevojshme kohore që mazhoranca qeverisëse të reflektojë dhe të vendos para interesave vetjake për mbajtjen e pushtetit, interesat e popullit shqiptar dhe të ardhmes europiane të tij.

Bazuar sa më sipër, në mbështetje të nenit 85, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kam vendosur kthimin për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë të ligjit nr. 118/2020 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.”*

**Sinqerisht,**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**Ilir META**